



Raporti i Stabilitetit Financiar

6MII-2024

Përmbajtja

Parathënie.....	3
Shënime.....	4
Deklarata e Stabilitetit Financiar për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2024.....	5
1. Zhvillimet makroekonomike	13
1.1 Harta e stabilitetit financiar.....	13
1.2 Mjedisi makroekonomik i jashtëm	15
1.3 Mjedisi makroekonomik në vend	20
2. Llogaritë financiare dhe pozicioni financiar i individëve dhe bizneseve	24
2.1 Pozicioni financiar i bizneseve	25
2.2 Përbalueshmëria e borxhit dhe pritjet e bizneseve për të ardhmen	29
2.3 Pozicioni financiar i individëve.....	30
2.4 Përbalueshmëria e borxhit dhe pritjet e individëve për të ardhmen.....	33
3. Tregjet dhe sistemet e pagesave	34
3.1 Tregjet e letrave me vlerë	34
3.2 Tregu ndërbankar i financimit.....	37
3.3 Tregu i këmbimit të monedhës	38
3.4 Tregu i pasurive të paluajtshme	38
3.5 Sistemet e pagesave	41
4. Sistemi financiar.....	43
4.1 Sektori bankar.....	43
4.1.1 Zhvillimet kryesore në sektorin bankar	43
4.1.2 Rreziqet e veprimtarisë së sektorit bankar	60
4.1.3 Rezistenca e sektorit bankar.....	68
4.2 Sektori jobankar.....	73
4.2.1 Ecuria e sektorit jobankar	73
4.2.1 Rreziqet dhe ekspozimet midis sektorit bankar dhe jobankar	76
5. Politika makroprudenciale dhe rreziqet sistemike	77

Parathënie

Raporti i Stabilitetit Financiar (më tej "raporti") publikohet dy herë në vit dhe ky është numri i 32-të i tij. Në hyrje të raportit është vendosur "Deklarata e Stabilitetit Financiar", e cila, sipas kërkesës së ligjit, duhet të publikohet çdo gjashtë muaj. Raporti paraqet një vlerësim të përgjithshëm të rreziqeve që mund të kërcënojnë stabilitetin e sistemit financiar të Republikës së Shqipërisë dhe infrastrukturën e tij, si dhe vlerëson aftësinë e sistemit financiar për t'i përthithur këto rreziqe. Dokumenti iu mundëson autoriteteve publike identifikimin në kohë të masave përkatëse për korrigjimet e nevojshme.

Për hartimin e raportit janë shfrytëzuar të dhënat zyrtare të Bankës së Shqipërisë, është shkëmbyer informacion me autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tregut financiar, si dhe janë shfrytëzuar analiza të institucioneve të vendit dhe të atyre financiare ndërkombëtare, publike dhe private. Analiza në vijim mbulon kryesisht zhvillimet gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024 (më tej, "periudha"). Nëse nuk përcaktohet ndryshe në raport, pritjet për zhvillimet e ardhshme ekonomike dhe financiare shtrihen për një periudhë kohe rreth 12 muaj.

Qëndrueshmëria e sistemit financiar është vlerësuar në bazë të ecurisë së veprimtarisë së tij dhe të rreziqeve që burojnë nga ndërveprimi i tij me mjedisin e përgjithshëm ekonomik të brendshëm dhe të jashtëm. Për të vlerësuar këto rreziqe, janë analizuar zhvillimet më të fundit në tregjet financiare ndërkombëtare dhe në ekonominë e vendeve të zhvilluara dhe ato të rajonit, si dhe është bërë një vlerësim mbi ndikimin e tyre në sistemin financiar të vendit dhe sektorin bankar. Zhvillimet dhe rreziqet e lidhura me ekonominë vendase janë analizuar në bazë të treguesve të rritjes ekonomike, bilancit të pagesave, nivelit të përgjithshëm të çmimeve, kursit të këmbimit, si dhe treguesve fiskalë. Gjithashtu, nëpërmjet një analize të situatës së punësimit, të ecurisë së të ardhurave dhe vrojtimeve të veçanta, është vlerësuar gjendja financiare e sektorit të bizneseve/ndërmarrjeve dhe të individëve/familjeve, si edhe ndikimi i saj mbi aftësinë paguese të kredimarrësve të sektorit bankar. Rezistenca e këtij sektori ndaj goditjeve të ndryshme makroekonomike është vlerësuar nëpërmjet ushtrimit të provës së rezistencës për mjaftueshmërinë e kapitalit.

Raporti i Stabilitetit Financiar përgatitet nga Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Shënime

Në fund të muajit dhjetor 2024, bankat në sektorin bankar shqiptar janë klasifikuar:

I. sipas kontributit marzhinal të secilit institucion në rrezikun sistemik në vend¹ duke u grupuar në:

✓ **Banka me rëndësi sistemike:** Banka Kombëtare Tregtare sh.a., Banka Credins sh.a., Banka Raiffeisen sh.a. dhe Banka OTP Albania sh.a. Këto banka zotërojnë rreth 65% të aktiveve të sektorit;

✓ **Banka të tjera:** Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a., Banka Procredit sh.a., Banka e Parë e Investimeve Albania sh.a., Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a., Banka Union sh.a., Banka Amerikane e Investimeve sh.a. dhe Banka Tirana sh.a. Këto banka zotërojnë rreth 35% të aktiveve të sektorit.

II. sipas origjinës së kapitalit, duke u grupuar në:

✓ **Banka me kapital të huaj²:** Banka Raiffeisen sh.a. (Austri); Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a. (Itali); Banka Kombëtare Tregtare sh.a. (Turqi); Banka OTP Albania sh.a. (Hungari); Banka Procredit sh.a. (Gjermani); Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a. (Bullgari). Këto banka zotërojnë 63% të aktiveve të sektorit;

✓ **Banka me kapital shqiptar:** Banka Credins sh.a., Banka Union sh.a., Banka Amerikane e Investimeve sh.a., Banka Tirana sh.a dhe Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a. Këto banka zotërojnë 37% të aktiveve të sektorit.

III. sipas shtrirjes gjeografike të rrjetit bankar. Shtrirje të rrjetit bankar jashtë vendit kanë: Banka Kombëtare Tregtare sh.a. dhe Banka Credins sh.a., me filialet përkatëse në Kosovë.

Për analizën e kryer në raport, duhet të merret në konsideratë që:

(1) termat "hua" dhe "kredi" kanë të njëjtin kuptim dhe mund të përdoren si zëvendësues të njëri-tjetrit. Në të njëjtën mënyrë përdoren edhe termat "ndërmarrje"/"biznese" dhe "individë"/"familje";

(2) termi "teprica e kredisë" i referohet gjendjes së llogarisë "marrëdhënie me klientët", siç është raportuar në bilancin e bankave në fund të periudhës që analizohet. Ajo përfshin tepricën e kredisë së dhënë nga sektori bankar për subjektet jofinanciare, private dhe publike, rezidente dhe jorezidente. Kjo tepricë ndikohet nga kreditë me probleme që janë larguar nga bilancet e bankave gjatë periudhës. Për këtë arsye, teprica e kredisë që analizohet në Raportin e Stabilitetit Financiar është një koncept i ndryshëm nga ai i "kredisë për ekonominë", që trajtohet në Raportet e Politikës Monetare. Në kredinë për ekonominë, krahas kredisë së dhënë nga bankat, përfshihet edhe kredia e dhënë nga institucionet financiare jobankare. Kredia për ekonominë përfshin vetëm kredinë për sektorin privat rezident dhe vlera e saj nuk ndikohet nga fshirja e kredive me probleme, duke qenë se këto kredi janë përfituar tashmë nga subjektet ekonomike dhe kanë ndikuar në vlerën e tyre ekonomike; fshirja e tyre e mëvonshme nga bilancet e bankave nuk e ndikon këtë fakt;

(3) dallimi në këto koncepte të kredisë, duhet pasur parasysh gjatë interpretimit të analizës përkatëse të treguesve të kredisë (normë rritjeje, raporte të cilësisë, shpërndarje sipas sektorëve, sipas monedhës etj.) në raportet e ndryshme të Bankës së Shqipërisë.

¹ Për më shumë informacion mbi indeksin dhe mbi përcaktimin e bankave me rëndësi sistemike (BARS), lutem konsultoni dokumentin "Metodologji "Për përcaktimin e bankave me rëndësi sistemike dhe shtesën përkatëse të kapitalit"" të publikuar në: https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Politika_makroprudenciale/Instrumentet_e_politikes_makroprudenciale/Akte_te_mi_ratuara/

² Një bankë klasifikohet si bankë me kapital të huaj, kur kapitali i huaj përbën më shumë se 50% të kapitalit të paguar të bankës.

Deklarata e Stabilitetit Financiar për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2024

Në mbështetje të kërkesës së nenit 69 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; dhe të nenit 8 të ligjit nr. 9962, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; për të informuar Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe Këshillin e Ministrave, si edhe për të tërhequr vëmendjen e institucioneve financiare dhe të publikut mbi gjendjen e sistemit financiar në vend dhe rreziqet potenciale që mund të kërcënojnë qëndrueshmërinë e tij, Banka e Shqipërisë (BSH) publikon këtë deklaratë periodike, që është pjesë përbërëse e Raportit të Stabilitetit Financiar për të njëjtën periudhë.

Në raportin e stabilitetit financiar dhe në këtë deklaratë që e paraprin, vlerësohet ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve që burojnë prej ndërveprimit të tij me ekonominë e jashtme dhe të brendshme, me agjentët e ekonomisë reale, me tregjet financiare në vend, si dhe ndaj rreziqeve që lidhen me mënyrën se si sektori bankar zhvillon veprimtarinë. Në vijim, këto rreziqe përballen me gjendjen financiare të sektorit bankar dhe stresohen nëpërmjet ushtrimit të provës së rezistencës, për të vlerësuar qëndrueshmërinë e sektorit bankar.

Banka e Shqipërisë vlerëson se, në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2024 (më tej, "periudha"), veprimtaria e sektorit u zhvillua në mënyrë të qëndrueshme. Depozitat dhe kreditë u zgjeruan pavarësisht efektit pakësues të mbiçmimit të kursit të këmbimit, kapitalizimi i veprimtarisë mbeti në nivele të mira, ndërsa fitimi u përmirësua në mënyrë të ndjeshme. Rreziqet e veprimtarisë vlerësohen në nivele të kontrolluara dhe, në tërësi, sektori bankar është i qëndrueshëm ndaj tyre. Megjithatë, sfidat për veprimtarinë bankare dhe financiare vlerësohen në rritje, ndaj performanca më e mirë financiare duhet të përdoret nga bankat për të përmirësuar infrastrukturën e administrimit të rreziqeve.

Zhvillimet ekonomike gjatë periudhës ishin pozitive, ndikuar nga ecuria e mirë e konsumit dhe investimeve, si edhe performanca e fortë e sektorit të turizmit. Rritja ekonomike u shoqërua me ulje të papunësisë dhe rritje të punësimit e të pagave. Politika fiskale ruajti një prioritet konsolidues gjatë pjesës më të madhe të vitit, në kushtet e rritjes së ndjeshme të të ardhurave fiskale. Presionet inflacioniste erdhën në rënie, ndaj Banka e Shqipërisë lehtësoi politikën e saj monetare. Rreziqet për zhvillimet ekonomike dhe financiare në vend mbeten të pranishme dhe lidhen kryesisht me pasigurinë dhe ndikimin që përcjellin zhvillimet ndërkombëtare. Në këto kushte, mbetet e rëndësishme që politikat ekonomike dhe financiare të autoriteteve publike dhe veprimet e pjesëmarrësve të tregjeve, të synojnë ruajtjen e rezervave financiare që mbështesin mirëfunksionimin e veprimtarisë së tyre.

Më konkretisht, zhvillimet e periudhës treguan që:

Aktiviteti ekonomik botëror u zgjerua gjatë periudhës, me një ritëm modest, por të qëndrueshëm.

Kjo ecuri u mbështet kryesisht nga ecuria e mirë në sektorët e shërbimeve, qëndrueshmëria e tregtisë dhe kushtet akomoduese të financimit në tregje. Presionet inflacioniste kanë vijuar të bien, por ato kanë mbetur në nivele relativisht të larta në sektorë dhe rajone të veçanta. Për këto arsye, veprimet e bankave qendrore drejt lehtësimit të politikës monetare, kanë qenë të kujdesshme. Rënia e inflacionit është shoqëruar me kushte financimi më të favorshme në tregjet financiare. Në fund të vitit, luhatshmëria në tregje u rrit, duke reflektuar ndryshimet në faktorët e kërkesës dhe ofertës, të ndikuar gjithashtu nga rezultati i zgjedhjeve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në tregjet e lëndëve të para, çmimet e naftës dhe të gazit u rritën, ndërsa ato të metaleve u shfaqën të qëndrueshëm. Çmimet e ushqimeve gjithashtu shfaqën një prioritet rritës, kryesisht për shkak të ndryshimeve të elementeve të ofertës.

Ekonomia e Eurozonës është ngadalësuar gjatë periudhës, për shkak të dobësisë së ekonomisë në vendet më të mëdha anëtare. Aktiviteti është mbështetur nga forcimi i konsumit, ndërkohë që rënia e investimeve

dhe ngadalësimi i eksporteve kanë pasur efekt frenues. Megjithë rënien e inflacionit në pjesën më të madhe të vitit, presionet inflacioniste kanë qenë të pranishme gjatë periudhës, ndikuar kryesisht nga tregu i shtrënguar i punës dhe rritja e çmimeve të energjisë. Banka Qendrore Evropiane ka ndërmarrë veprime drejt lehtësimit monetar, duke mbetur e fokusuar tek arritja e objektivit të inflacionit prej 2%. Tregjet financiare evropiane janë karakterizuar nga luhatshmëria, veçanërisht në afatet më të gjata. Rënia e normave të interesit është reflektuar në kushtet e kreditimit, por rritja e kredisë ka mbetur poshtë pritshmërive. Sipas të dhënave të tremujorit të tretë të vitit 2024, ekonomitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor vijuan të rriten pozitivisht, ndonëse në disa prej tyre ritmi i rritjes është ngadalësuar krahasuar me pjesën e parë të vitit. Kontributin kryesor në këtë rritje e ka dhënë konsumi i brendshëm, i mbështetur nga rritja e pagave dhe ecuria e mirë e eksportit të shërbimeve. Nga ana tjetër, eksportet e mallrave ishin përgjithësisht të dobëta dhe deficit i llogarisë korrente është zgjeruar në shumicën e vendeve. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik ka sjellë përmirësim të bilanceve fiskale dhe ulje të borxhit publik. Rënia e inflacionit ka qenë më e dukshme në disa prej vendeve të rajonit, ku bankat qendrore kanë lëvizur në drejtim të lehtësimit monetar. Kushtet e lehtësuara monetare kanë mbështetur ecurinë e kredisë që ka përshpejtuar ritmin e rritjes. Cilësia e kredisë në rajon ka mbetur e qëndrueshme dhe raportet e kredive me probleme raportohen në nivele relativisht të ulëta.

Ekonomia botërore pritet të vijojë të rritet në mënyrë të qëndrueshme, por të ngadaltë, gjatë periudhës 2025-2026, dhe rritja do të kryesohet nga rajonet në zhvillim. Normat e inflacionit në shkallë globale pritet të mbeten në trajektore rënëse. Rritja ekonomike e Eurozonës pritet të mbetet anemike gjatë këtij viti dhe të rigjallërohet gradualisht gjatë vitit të ardhshëm, e mbështetur nga konsumi dhe shërbimet. Megjithatë, rreziqet ndaj perspektivës së ekonomisë botërore vlerësohen në rritje, ndikuar kryesisht nga ecuria e tensioneve gjeopolitike dhe tregtare, dhe ndikimi i tyre në inflacion, norma interesi, konsum e investime.

Në terma vjetorë, ekonomia shqiptare u rrit me 4.1% deri në fund të tremujorit të tretë të vitit. Kjo rritje ka pasur një bazë të gjerë sipas sektorëve, dhe është mbështetur kryesisht nga kërkesa e brendshme, në formën e konsumit final dhe investimeve të sektorit privat. Tregu i punës u karakterizua nga zhvillime pozitive, në formën e rritjes së punësimit, uljes së normës së papunësisë dhe rritjes së pagave në sektorin shtetëror dhe atë privat. Periudha është karakterizuar nga përshpejtimi i rënies së normës së inflacionit, e ndikuar kryesisht nga ecuria e çmimit të ushqimeve. Kjo ecuri ka reflektuar qëndrimin e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë dhe mbiçmimin e monedhës vendase. Megjithatë, presionet inflacioniste nga ekonomia e brendshme janë shfaqur më të qëndrueshme në sajë të tregut të shtrënguar të punës dhe forcës së konsumit. Në muajt korrik dhe nëntor, Banka e Shqipërisë uli normën bazë të interesit me nga 25 pikë bazë, në nivelin 2.75%. Në pjesën më të madhe të periudhës, politika fiskale ka qenë në kahun konsolidues, me një tepricë pozitive buxhetore, dhe vetëm në fund të saj përmbushi vlerat e synuara të deficitit fiskal. Në raport me PBB-në, treguesit e qëndrueshmërisë fiskale, deficitit buxhetor dhe borxhi publik, janë përmirësuar, duke vijuar rënien. Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, në fund të vitit 2024, borxhi publik zbriti në nivelin 55%, më i ulëti që nga viti 2010. Në bilancin e pagesave me jashtë, deficit i llogarisë korrente u zgjerua në tremujorin e katërt të vitit. Në këtë rezultat, thellimi i deficitit në llogarinë e tregtisë së mallrave dhe kontributin kryesor, duke tejkaluar ndikimin pozitiv të zgjerimit të tepricës pozitive në llogarinë e shërbimeve, të rritjes së tepricës pozitive në llogarinë e të ardhurave parësore, për shkak të rritjes së dërgesave të emigraenteve dhe të uljes së deficitit të llogarisë së të ardhurave dytësore. Balancat e llogarisë kapitale dhe asaj financiare ishin pozitive, duke reflektuar rritjen e flukseve të njëanshme për sektorin privat dhe atë publik, rritjen e investimeve të huaja direkte dhe të investimeve të tjera, dhe tepricën negative në investimet e portofolit. Gjatë periudhës, mjetet e rezervës valutore vijuan të rriten, duke mbuluar

7 muaj importe, dhe gati 5.3 herë borxhin afatshkurtër. Pozicioni debitor në investimet ndërkombëtare të vendit, u ngushtua.

Gjendja financiare e bizneseve dhe e familjeve është paraqitur e qëndrueshme gjatë periudhës. Sipas të dhënave të llogarive financiare të vendit për fundin e vitit 2023, ekonomitë familjare (ose individët) dhe korporatat jofinanciare (ose bizneset) vijojnë të mbeten përkatësisht sektori më i madh kreditor dhe sektori më i madh debitor në ekonomi, ndërkohë që Shqipëria paraqitet si një vend me pozicion neto debitor ose huamarrës në raport me pjesën tjetër të botës. Pozicioni i bizneseve është debitor dhe ai është thelluar gjatë vitit 2024, kryesisht si pasojë e rritjes së detyrimeve ndaj jorezidentëve dhe thellimit të pozicionit debitor ndaj sektorit bankar. Në raport me jorezidentët, bizneset kanë shtuar në mënyrë të ndjeshme detyrimet në formën e investimeve të huaja direkte dhe në një masë të vogël detyrimet e tjera të borxhit. Detyrimet neto të bizneseve vijuan të rriten gjatë vitit 2024, ku rritja e kredisë bankare me gati 12%, ishte më e lartë se norma e rritjes së depozitave. Në rritjen e kredisë dhanë kontribut pozitiv Leku dhe Euro, duke përfutur edhe nga rënia e normave mesatare përkatëse të interesit. Rritja e kredisë përfshiu pothuajse të gjithë sektorët e prodhimit, ndërkohë që sipas qëllimit, ajo është përqendruar në blerjen dhe zhvillimin e pronave të paluajtshme nga ana e bizneseve. Gjatë periudhës, rritjes së kërkesës për kredi nga ana e bizneseve, bankat i janë përgjigjur me ulje të shkallës së refuzimit të aplikimeve. Performanca financiare e bizneseve ka qenë pozitive, ku shumica e bizneseve kanë operuar me fitim. Ecuria e shitjeve dhe e rezultatit financiar është rritur krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës. Sfidat e veprimtarisë lidhen me kushtet e konkurrencës dhe gjetjes së tregut, kostove ende të larta të financimit dhe gjetjes e ruajtjes së personelit të nevojshëm. Ngarkesa me borxh, në formën e raportit të huasë ndaj kapitalit, ka shënuar rritje gjatë periudhës, ndikuar nga treguesi për ndërmarrjet e mesme. Megjithë rritjen e shpenzimit për pagesën e huasë, raporti i këtij shpenzimi ndaj të ardhurave vlerësohet në rënie për pjesën më të madhe të ndërmarrjeve, krahasuar me gjashtëmujorin e mëparshëm. Bizneset presin që kërkesa e tyre për kredi të mbetet e pozitive dhe të tregojë rritje gjatë gjysmës së parë të vitit 2025.

Sipas të dhënave të llogarive financiare për fundin e vitit 2023, sektori i individëve përfaqëson sektorin rezident më të rëndësishëm në financimin e korporatave financiare dhe bizneseve. Format kryesore të financimit ishin përkatësisht ato të kapitalit të investuar në ndërmarrjet vendase dhe depozitat e vendosura në banka. Pozicioni kreditor i individëve rezidentë ndaj sektorit bankar u zgjerua lehtë gjatë periudhës, për shkak të rritjes më të madhe të depozitave në krahasim me kreditë. Në terma relativë, rritja e kredisë ishte më e lartë se ajo e depozitave. Kërkesa për kredi është drejtuar kryesisht për konsum dhe për blerje banesash. Ajo është mbështetur nga prija rënese e normave të interesit për kredinë e re dhe nga rritja e të ardhurave të familjeve. Në përgjithësi, kushtet dhe termat e kredisë së bankave për individët kanë mbetur të qëndrueshme. Për pjesën e parë të vitit 2025, kërkesa nga individët për kredi pritet të mbetet e qëndrueshme, dhe të orientohet përsëri drejt konsumit dhe blerjes së banesave. Rezultatet e vrojtimit të Bankës së Shqipërisë tregojnë se aftësia paguese e familjeve është përmirësuar në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Pritjet për aftësinë paguese në gjashtëmujorin e ardhshëm paraqiten disi më pesimiste. Edhe familjet presin që kërkesa e tyre për kredi të mbetet e qëndrueshme në pjesën e parë të vitit 2025.

Në tregjet financiare, përgjithësisht vëllimet e tregtimit janë pakësuar dhe normat e interesit kanë rënë. Në tregun parësor të titujve të borxhit të qeverisë, vëllimi i emetimeve shënoi rënie me rreth 43%, ndikuar nga emetimet më të ulëta për titujt afatshkurtër dhe ata afatgjatë. Pavarësisht rënies së vëllimit të emetimeve, norma mesatare e ponderuar e interesit ra me 0.3 pikë përqindjeje (p.p.), në nivelin 3.9%. Kjo rënie e *yield*-eve reflektoi edhe uljen e normës bazë të interesit nga Banka e Shqipërisë në muajt korrik dhe nëntor. Për titujt afatshkurtër, norma mesatare e interesit u ul me 0.5 p.p. në nivelin 3.0%, ndërsa për titujt afatgjatë ajo ra me 0.4 p.p., në 4.6%. Në përgjithësi, oferta e investitorëve ka qenë më e lartë dhe e ka

mbuluar më mirë nevojën e qeverisë për huamarrje. Preferenca e investitorëve ka qenë për titujt e borxhit afatgjatë. Jorezidentët kanë rritur më tej kërkesën për titujt e borxhit të Qeverisë Shqiptare në Lek. Në fund të periudhës, portofoli i tyre zinte 2% të titujve të borxhit të qeverisë në Lek. Edhe vëllimi i transaksioneve të financimit në tregun ndërbankar shënoi rënie. Kjo ecuri u diktua nga tkurrja e vëllimit të transaksioneve njëjavore, të cilat mbizotërojnë në vëllimet e transaksioneve në këtë treg. Interesat e aplikuara nga bankat për transaksionet e financimit në tregun ndërbankar, gjithashtu kanë rënë, duke ndjekur uljen e normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë. Gjatë periudhës, Banka e Shqipërisë ka injektuar rregullisht likuiditet në treg, nëpërmjet instrumentit kryesor të marrëveshjeve të riblerjes me maturim njëjavor. Kursi i këmbimit të Lekut ka vijuar të mbiçmohet ndaj valutave kryesore, por në masë dhe shpejtësi më të ulët. Banka e Shqipërisë ka zhvilluar ankandet e planifikuara për blerjen e Euros, duke i shërbyer objektivit për rritjen e rezervës valutore dhe duke kontribuar në qëndrueshmërinë e kursit të këmbimit.

Në tregun e pasurive të paluajtshme, zhvillimet kanë qenë të qëndrueshme dhe çmimet e pasurive të paluajtshme rezidenciale kanë shënuar rritje të ndjeshme. Sipas vërtimit të posaçëm të Bankës së Shqipërisë, kërkesa e përgjithshme për blerje në tregun e pasurive të paluajtshme rezidenciale gjatë periudhës ka qenë e qëndrueshme, ndërkohë që kërkesa nga jorezidentët ka rënë lehtë. Numri i pronave të pashitura ka vijuar të bjerë për disa gjashtëmujorë radhazi, dhe koha mesatare e shitjes është shkurtuar lehtë, për shkak të rënies së kohës së shitjes për pronat e shitura në kryeqytet. Rritja e kredisë bankare për blerje dhe zhvillim pasurish të paluajtshme ka mbështetur qëndrueshmërinë e kërkesës. Bankat kanë shtrënguar disi standardet për këtë lloj kredie dhënë individëve. Në tërësi, rritja e ofertës së njësive të banimit, sipas numrit të lejeve të ndërtimit, ishte më e ulët në krahasim me një vit më parë, por sipërfaqet për ndërtimet e reja paraqiten më të mëdha. Pësha e kredisë bankare për ndërtim nuk ka shënuar ndryshime gjatë periudhës. Kostot e ndërtimit janë rritur, kryesisht për shkak të rritjes në shpenzimet për paga, energji dhe transport. Pas rënies në periudhën e mëparshme, vërtimi tregon se Indeksi Fischer i çmimit të banesave në rang vendi u rrit me 23.6% në terma gjashtëmujorë, dhe me 44.5% ndaj një viti më parë. Rritja e vlerës së indeksit për Tiranën ishte gjithashtu e fortë. Po ashtu, edhe çmimet e qirasë janë rritur. Agjentët ruajnë një vlerësim pozitiv në lidhje me ecurinë e tregut të banesave në periudhën afatshkurtër, dhe mbeten optimistë për zhvillimet në një periudhë më afatgjatë.

Infrastruktura bazë për klerimin dhe shlyerjen e pagesave në monedhë vendase dhe në Euro, ka vijuar të funksionojë me siguri dhe efikasitet. Gjatë periudhës, është regjistruar rritje e vlerës dhe numrit të transaksioneve në sistemet e pagesave. Përdorimi i kartave për kryerjen e pagesave ka vijuar të rritet në mënyrë të ndjeshme dhe ato përfaqësojnë instrumentin me peshën kryesore në pagesat e kryera. Aderimi i Shqipërisë në Zonën e Përbashkët Evropiane të Pagesave (SEPA) më 21 nëntor 2024, shënoi një hap shumë të rëndësishëm në drejtim të sigurisë dhe modernizimit të sistemit të pagesave, si edhe uljes së kostove për shtetasit dhe bizneset shqiptare në kryerjen e pagesave ndërkufitare në Euro.

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2024, pësha e aktiveve të sistemit financiar³ ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) u rrit me 3 p.p., në nivelin 93.2%. Në terma vjetorë, ky tregues ra me rreth 1 p.p. pasi norma vjetore e rritjes së bilancit të sistemit financiar ishte më e ulët në krahasim me atë të rritjes së PBB-së. Në këtë rënie, sektori bankar ka kontribuar me 1.2 p.p. Brenda sistemit financiar, sektori bankar vijon të mbizotërojë me gati 90% të totalit të aktiveve. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar mbetet i ulët, dhe ka shënuar një rënie të lehtë për periudhën, ndërsa ndjeshmëria e sektorit jobankar ndaj

³ Sistemi financiar përbëhet nga sektori bankar dhe sektori jobankar. Baza e të dhënave për të gjitha subjektet e sistemit financiar i përket tremujorit të katërt të vitit 2024, me përjashtim të të dhënave për shoqëritë e sigurimit dhe PBB-së, të cilat i referohen tremujorit të tretë të vitit 2024.

veprimtarisë së sektorit bankar vijon të mbetet e lartë. Banka e Shqipërisë monitoron rregullisht treguesit e ndërlihdjes, në kuadër të vlerësimit periodik të rreziqeve sistematike.

Aktiviteti bankar u zgjerua gjatë periudhës me gati 5%, dhe në terma vjetorë me gati 7%. Kontributi pozitiv në këtë rritje erdhi nga investimet në tituj dhe kreditimi. Në krahun e pasivit, bankat raportuan rritje të depozitave dhe të kapitalit. Efekti statistikor negativ i mbiçmimit të Lekut ndaj monedhave të huaja mbi treguesit e bilancit të sektorit bankar, ishte më i zbutur në krahasim me gjashtëmujorët e mëparshëm. Pësha e aktiveve dhe detyrimeve në valutë ndaj totalit të bilancit ka mbetur e pandryshuar, në nivelin 50%. Pozicioni neto kreditor ndaj jorezidentëve u rrit lehtë, duke arritur në 19% të aktiveve të sektorit bankar. Gjatë periudhës, indeksi i shëndetit bankar mbeti i pandryshuar dhe tregon një gjendje të mirë financiare të sektorit bankar. Në periudhën 2014-2024, indeksi tregon përmirësimin e veprimtarisë së sektorit bankar në terma të cilësisë së aktiveve dhe nivelit të kapitalizimit.

Teprica e kredisë bankare u zgjerua gjatë periudhës me 5.4%, për t'u ngjitur në nivelin 830 miliardë lekë. Në terma vjetorë, rritja e kredisë ishte 12.8%. E korrigjuar për efektin e kursit të këmbimit, norma e rritjes vjetore të kredisë do të ishte 15.3%. Rritja është regjistruar në të gjithë sektorët dhe monedhat, dhe është përqendruar kryesisht në kreditë afatgjata. Ristrukturimet e kredive dhe largimet nga bilanci të kredive të humbura kanë vijuar. Vëllimet e ristrukturimeve ranë, ndërsa ato të fshirjeve ishin të krahasueshme me periudhën e kaluar. Teprica e kredisë së pambrojtur në valutë u rrit me 2.4% në terma gjashtëmujorë dhe me 1.5% në krahasim me një vit më parë. E korrigjuar për efektin e kursit të këmbimit, rritja e periudhës do të ishte 4.3%. Kontributin kryesor në këtë ecuri e ka dhënë zgjerimi i kredisë së pambrojtur në valutë për bizneset. Kredia e pambrojtur në valutë për individët është tkurrur lehtë. Kredia e re e dhënë gjatë periudhës ishte më e lartë se ajo e një viti më parë, me kontributin kryesor pozitiv nga kredia në Euro. Rritja e fluksit të kredisë së re gjatë periudhës lidhet thuhet tërësisht me kredinë e akorduar sektorit të bizneseve. Kjo kredi ka shkuar kryesisht për të përmbushur nevojat afatshkurtra të bizneseve për likuiditet. Edhe kredia e re për individët u rrit në terma vjetorë dhe gjashtëmujorë, por me ritme më të ngadalta. Ajo ka shkuar kryesisht për blerjen e pasurive të paluajtshme. Norma mesatare e interesit për kreditë e reja, rezultoi 6.6%, e pandryshuar gjatë periudhës. Për kreditë e reja në Lek, ky tregues ishte 6.9%, ndërsa për ato në Euro, ai rezultoi 6.1%. Sipas vrojtimit me bankat lidhur me aplikimet për kredi, rezulton një rritje e numrit të aplikimeve, e drejtuar kryesisht nga sektori i individëve dhe ai i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Gjithashtu, ecuria e treguesit të refuzimeve për aplikimet e kryera, sugjeron një qëndrim relativisht më përzgjedhës të bankave, veçanërisht në drejtim të kredihënies së individëve.

Depozitat pranë bankave, u rritën me 5% gjatë periudhës dhe në terma vjetorë, duke u ngjitur në 1,680 miliardë lekë. Rritja lidhet me zgjerimin e depozitave me afat dhe të llogarive rrjedhëse kryesisht të individëve, në monedhat kryesore. Sipas monedhës, depozitat në Lek u rriten me 7%, ndërsa ato në valutë me 3%. E korrigjuar për efektin e kursit të këmbimit, rritja vjetore e depozitave në valutë do të ishte 8%. Pavarësisht këtyre ndryshimeve, struktura e depozitave në terma të llojit dhe monedhës, përgjithësisht është ruajtur. Fluksitet e depozitave të reja të periudhës ishin më të larta se në gjashtëmujorin e parë të vitit, por në këtë ecuri ato reflektojnë një sjellje sezonale që është theksuar në vitet e fundit. Normat e interesit të depozitave janë luhatur lehtë, me pak ndryshime gjatë vitit. Sipas segmenteve të maturimit, bankat kanë rritur normat mesatare të interesit për depozitat e afatit më të gjatë, pavarësisht monedhës.

Sektori bankar e mbylli vitin 2024 me një nivel të mirë të kapitalizimit të veprimtarisë. Sipas raportimeve të bankave, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për sektorin bankar u rrit gjatë periudhës me 0.5pp, duke u ngjitur në nivelin 19.8%. Ky nivel është pothuaj i njëjtë me atë të një viti më parë. Në ecurinë e këtij treguesi kontributin pozitiv e ka dhënë rritja e kapitalit rregullator, pavarësisht rritjes paralele të aktiveve të ponderuara me rrezik. Në vijimësi, bankave iu kërkohet të përmbushin disa kërkesa për nivelet e kapitalit,

ku përfshihen shtesat makroprudenciale të kapitalit dhe ato për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar (MREL). Me qëllim plotësimin e këtyre kërkesave, gjatë periudhës, bankat kanë injektuar kapital, kanë rritur fitimet e pashpërndara dhe kanë shtuar përdorimin e borxhit të varur. Sektori bankar, në tërësi, arriti t'i përmbushë kërkesat rregullative për kapital në gjysmën e dytë të vitit 2024, duke regjistruar një tepricë kapitali pozitive në fund të periudhës. Megjithatë, vlerat e kësaj teprice kanë ardhur në rënie.

Rezultati neto dhe treguesit e përfitueshmërisë së sektorit bankar u përmirësuan në krahasim me një vit më parë, si pasojë e rritjes në të ardhurat neto nga interesat dhe nga veprimtaritë e tjera. Në fund të vitit 2024, fitimi i akumuluar i sektorit bankar shënoi vlerën 37.4 miliardë lekë, nga rreth 32 miliardë lekë një vit më parë. Rritja e fitimit është pasqyruar në tregues më të lartë mesatarë të rentabilitetit të sektorit bankar, ku kthimi nga aktivet (RoA) rezultoi 1.9% dhe kthimi nga kapitali (RoE) 18.2%, kundrejt përkatësisht niveleve 1.7% dhe 17% të një viti më parë. Rritja e të ardhurave neto nga interesat, reflektoi rritjen e të ardhurave nga interesat me një ritëm më të shpejtë se ai i shpenzimeve për interesa. Rritja në të ardhurat jo nga interesat lidhet me një performancë më të mirë të investimeve në instrumentet financiare dhe të ardhura më të larta nga komisionet. Në krahasim me një vit më parë, bankat kanë raportuar shpenzime disi më të larta të veprimtarisë dhe në ato për provigjione. Performanca shumë më e mirë e të ardhurave në krahasim me rritjen e shpenzimeve të veprimtarisë ka përmirësuar nivelin e mbulimit të këtyre të fundit. Rritja e fitimit të bankave përfaqëson një mundësi shumë të mirë për të përdorur pjesën më të madhe të tij për fuqizimin e pozicioneve të kapitalit në mënyrë që të sigurohet përmbushja e kërkesave rregullatore aktuale dhe të planifikuara për nivelet e kapitalizimit.

Në tërësi, ekonomia shqiptare dhe sistemi financiar në vend kanë treguar një qëndrueshmëri të mirë ndaj rreziqeve të periudhës, por sfidat janë rritur. Zhvillimet ekonomike kanë qenë të qëndrueshme, dhe treguesit makroekonomikë mbeten në nivele mjaft të mira. Këto zhvillime konfirmohen edhe nga treguesit e Hartës së Stabilitetit, e cila reflekton rreziqe më të ulëta dhe relativisht të kontrolluara në treguesit që lidhen me familjet, bizneset dhe qeverinë. Ndonëse zhvillimet e brendshme ekonomike shfaqen pozitive, pasiguria nga zhvillimet ndërkombëtare është rritur. Mbetet për t'u vlerësuar shkalla e ashpërsimit të tensioneve tregtare dhe ecuria e konflikteve ushtarake në Evropë dhe më gjerë, por duket sikur ndikimi i tyre në ecurinë ekonomike të kontinentit tonë do të jetë më i lartë se më parë. Nëse ato shoqërohen me rritje të presioneve inflacioniste, rënie të të ardhurave dhe rënie të konsumit në ekonominë evropiane, kjo ka mundësi të reflektohet edhe në ekonominë e vendit. Drejtimi kryesor mund të jetë në formën e rënies së konsumit të jorezidentëve në ekonominë shqiptare, i shfaqur në format e rënies së dërgesave të emigrantëve dhe të investimeve të huaja direkte, apo edhe rënies së eksportit të shërbimeve. Në vrojtimin periodik që kryhet me bankat, ky faktor është evidentuar prej tyre si burimi kryesor i rrezikut, i ndjekur prej ndjeshmërisë nga sulmet potenciale kibernetike. Si edhe më parë, sektori bankar duhet të ruajë një monitorim të kujdesshëm për ekspozimet e tij në tregun e pasurive të paluajtshme, për hendeqet në afatet e maturimit mes aktiveve dhe pasiveve, dhe për ndikimet nga lëvizjet në normën e interesit. Rritja e kredisë shfaqet e shpejtë dhe, ndonëse standardet e kreditimit mbeten aktualisht të mira, ekziston mundësia që ato të dobësohen në kushtet e konkurrencës mes bankave. Për vendosjen e stimuljeve më të drejtë në ecurinë e kredisë, në zbatim të politikës makroprudenciale, në muajin dhjetor 2024, Banka e Shqipërisë rriti kërkesën për shtesën makroprudenciale kundërciklike të kapitalit, në nivelin 0.5%..

Në terma të rreziqeve më specifike për veprimtarinë e sektorit bankar vlerësohet se:

Rënia e stokut të kredive me probleme dhe rritja e tepricës së kredisë gjatë periudhës, ndikoi në rënien e raportit të kredive me probleme në nivelin 4.2%, më i ulëti në 15 vjetët e fundit. Rënia e stokut të kredive me probleme është vënë re në të gjithë portofolin e kredisë, por ishte më e dukshme në

kreditë në valutë, në atë afatshkurtër dhe në kreditë për bizneset. Për kreditë në valutë të pambrojtur nga lëvizjet e kursit të këmbimit, cilësia e kredisë është përmirësuar lehtë në krahasim me një vit më parë. Ecuria e kredive me probleme u ndikua nga një ritëm më i shpejtë i shlyerjeve që ka ndikuar në zhvendosjen e kredive nga klasat "nënstandard" dhe "të dyshimta" drejt klasave performuese. Fshirja e kredive gjatë vitit të fundit, ishte në vlerën 2.4 miliardë lekë. Raporti i mbulimit me provigjione të kredive me probleme dhe mbulimi me kolateral i tepcës së kredisë shënuan rritje.

Pozicioni i likuiditetit të sektorit bankar mbetet në nivele të mira dhe treguesit e likuiditetit vijnë të qëndrojnë dukshëm mbi kufijtë rregullativë. Gjatë periudhës, bankat raportojnë raporte thuajse të pandryshuara të aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra dhe aktiveve totale. Në krahasim me një vit më parë, këto raporte kanë rënë lehtë, duke reflektuar rritjen më të shpejtë të kredisë ndaj depozitave. Diferenca midis afateve mesatarë të maturimit të aktiveve dhe të detyrimeve është rritur. Përqendrimi i aktiveve likuide në tituj të borxhit të qeverisë shqiptare mbetet i lartë dhe evidenton rëndësinë për zhvillimin e tregut ku tregtohen këta tituj.

Elementet e rrezikut të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të tregut kanë qenë të kontrolluar. Gjatë periudhës, pozicioni i hapur valutor për sektorin bankar nuk shfaq ndryshime, duke qëndruar "në blerje", sa 4.5% e vlerës së kapitalit rregullator. Kjo ecuri është përcaktuar nga bankat sistemike. Ekspozimi ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit, i matur nga treguesi i mospërputhjes valutore, u rrit gjatë periudhës, si rezultat i zgjerimit të kredisë për rezidentët në valutë, por mbetet nën nivelin e mesatares së 5 viteve të fundit. Treguesi që mat ekspozimin e sektorit bankar ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë të normës së interesit ka shënuar rritje gjatë periudhës, por mbetet ndjeshëm nën kufirin maksimal rregullator. Sektori bankar është më i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit për pozicionet në Lek, ato me normë interesi të ndryshueshme dhe për maturitetin afatgjatë. Për shkak të ekspozimeve me normë interesi të ndryshueshme dhe atyre në formën e investimeve në tituj, efekti i ndikimit të lëvizjeve të normës së interesit në cilësinë e këtyre ekspozimeve duhet monitoruar dhe testuar në mënyrë të vazhdueshme.

Rezultatet e ushtrimeve të provës së rezistencës mbështesin vlerësimet për gjendjen e mirë financiare të sektorit bankar. Për të vlerësuar rezistencën e sektorit bankar ndaj goditjeve nga ekonomia reale ose tregjet financiare në një horizont afatmesëm, Banka e Shqipërisë kryen në mënyrë periodike ushtrimet e provës së rezistencës.

Prova e rezistencës për aftësinë paguese tregon shkallën e rezistencës së bankave individuale në terma të kapitalit dhe synon të evidentojë përshtatshmërinë e tij në përballimin e goditjeve të supozuara mbi rritjen ekonomike, kreditë, nivelet e kursit të këmbimit dhe normat e interesit. Rezultatet e këtij ushtrimi për periudhën 2025-2026, tregojnë se sektori bankar paraqitet i qëndrueshëm ndaj goditjeve makroekonomike të supozuara ndaj skenarëve të rrezikut për periudhën ushtrimore. Ndjeshmëria e sektorit bankar është përmirësuar në krahasim me një vit më parë, pasi numri i bankave që do të kishin nevojë për të forcuar pozicionet e tyre të kapitalit dhe vlera e nevojshme e kapitalit, në skenarët më pak të favorshëm, ka rënë.

Prova e rezistencës së likuiditetit vlerëson aftësinë e bankave për të përballuar goditje me natyrë ekstreme mbi gjendjen e likuiditetit dhe kapacitetin e tyre për të shitur aktivet likuide. Rezultatet e ushtrimit tregojnë se rezistenca e sektorit bankar ndaj goditjeve të mundshme të likuiditetit sipas të dhënave të muajit nëntor 2024, për horizontin kohor 2025-2026, paraqitet pothuajse e njëjtë me atë të një viti më parë. Në terma të hyrjeve dhe daljeve të përgjithshme të parasë, ushtrimi tregon një dobësim të lehtë në drejtim të daljeve në monedhat Lek dhe Euro, që pritet të jenë më të larta dhe një rënie të lehtë të flukseve hyrëse në monedhën Euro. Pavarësisht pritjeve për thellim të hendekut të thjeshtë të likuiditetit për shkak të pakësimit të hyrjeve dhe rritjes së daljeve të parasë, rezistenca individuale e bankave vijon të mbetet e mirë, për shkak

të nivelit të përshtatshëm të aktiveve likuide që bankat mund të përdorin për të gjeneruar likuiditet në kushte të supozuara stresi.

Në tërësi, këto ushtrime tregojnë se sektori bankar paraqitet i qëndrueshëm ndaj goditjeve të supozuara makroekonomike dhe të likuiditetit. Ndjeshmëria e sektorit bankar është përmirësuar dukshëm në krahasim me një vit më parë, pasi numri i bankave që do të kishin nevojë për të forcuar pozicionet e tyre të kapitalit në skenarët më pak të favorshëm është më i vogël. Sfidat për veprimtarinë e sistemit financiar dhe të sektorit bankar mbeten të pranishme, në kushtet e pasigurisë që ruajnë zhvillimet ndërkombëtare dhe të brishtësive që shoqërojnë zhvillimet në fushën e teknologjisë së informacionit.

Si rezultat, është e nevojshme që në afat të mesëm bankat të forcojnë sistemet e përgjithshme të kontrollit dhe aftësitë e tyre teknike për të testuar qëndrueshmërinë ndaj skenarëve më pak të favorshëm. Rritja e fitimit të bankave gjatë vitit 2024 mbetet mundësia më pak e kushtueshme për të fuqizuar investimet e nevojshme në këto drejtime.

Si zakonisht, Banka e Shqipërisë do të monitorojë me kujdes zhvillimet në sektorin bankar dhe në treguesit makroekonomikë e financiarë. Mbi bazën e një komunikimi të ngushtë me industrinë bankare, autoritetet e tjera publike dhe me institucionet financiare ndërkombëtare, Banka e Shqipërisë do të veprojë në mënyrë proaktive për të ruajtur stabilitetin makroekonomik dhe financiar.

1. Zhvillimet makroekonomike

1.1 Harta e stabilitetit financiar


Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2024, rreziqet e monitoruara nga Harta e Stabilitetit Financiar kanë qenë në nivele të përmbajtura dhe në zbutje.

Krahasuar me një vit më parë, kjo ecuri është diktuar nga treguesit e aktivitetit të agjentëve të ekonomisë dhe zhvillimet në mjedisin e jashtëm, ndërkohë që niveli i përgjithshëm i rreziqeve nga ekonomia e brendshme ka mbetur pothuaj i pandryshuar ndaj një viti më parë.

Edhe rreziqet e veprimtarisë bankare vlerësohen të kontrolluara dhe përgjithësisht në zbutje, ndikuar nga përmirësimi i përfitueshmërisë dhe nivelet e mira dhe të qëndrueshme të likuiditetit dhe kapitalizimit.

Harta e stabilitetit financiar tregon një nivel përgjithësisht të ulët dhe në rënie të rreziqeve nga mjedisi makroekonomik gjatë gjashtëmujorit të dytë 2024. Në krahasim me një vit më parë, vërehet një prirje në zbutje e niveleve të vlerësuara të rreziqeve nga "mjedisi i jashtëm", sektori i "bizneseve", "individëve" dhe i "qeverisë", ndërkohë që rreziku nga "ekonomia e brendshme" mbetet "i ulët" dhe i pandryshuar gjatë periudhës. Rreziqet lidhur me veprimtarinë e sektorit bankar kanë rezultuar gjithashtu në rënie për kategoritë e "kapitalizimit dhe përfitueshmërisë" dhe "fondet dhe likuiditeti", ndërkohë që niveli i rrezikut nga "struktura e sektorit bankar" ka mbetur i pandryshuar.

Grafik 1. Harta e stabilitetit financiar



* Rreziku vlerësohet: i ulët për notat 0-3 në hartë, mesatar për notat 4-5, i moderuar për notat 6-8 dhe i lartë për notat 9-10. Lëvizja drejt skajeve të hartës, larg qendrës, nënkupton rritje të rrezikut.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rreziqet në mjedisin e përgjithshëm ekonomik


Rreziku që buron nga ekonomia e brendshme, sipas treguesve që paraqesin situatën deri në fund të tremujorit të tretë të 2024-ës, ka rezultuar në nivelin "i ulët" dhe pa ndryshime krahasuar me një vit më parë. Rënia e normës së inflacionit gjatë periudhës dhe rënia e nivelit të borxhit të jashtëm në raport me PBB-në kanë balancuar rritjen e rrezikut të lidhur me përqesimin e treguesit të hendekut të prodhimit dhe luhatshmërinë e kursit të këmbimit.

Vlerësimi për rrezikun nga mjedisi i jashtëm ka rënë nga niveli "mesatar" në "i ulët" gjatë periudhës. Zbutja e këtij rreziku ndaj një viti më parë është diktuar kryesisht nga rënia e normave afatshkurtra të interesit në tregjet ndërkombëtare, duke reflektuar normalizimin e politikës monetare nga bankat qendrore kryesore, rënien e çmimeve të naftës në fund të vitit dhe përmirësimin e ecurisë ekonomike të partnerëve kryesorë tregtarë të vendit tonë.

Rreziqet e lidhura me veprimtarinë e agentëve të ekonomisë reale⁴

Rreziku nga sektorët e "individëve", "bizneseve" dhe "qeverisë" gjithashtu është zbutur krahasuar me një vit më parë, duke rënë nga niveli "mesatar" në nivelin e rrezikut "të ulët". Niveli i përgjithshëm i rrezikut nga sektori i individëve është zbutur më tej gjatë periudhës, ndikuar nga zhvillimet në tregun e banesave, dinamikat e huamarrjes dhe rritja e dërgesave të emigrantëve, ndërkohë që nivelet e rrezikut nga nëntreguesit e tjerë (si papunësia, cilësia e portofolit të kredisë dhe pritshmëritë e individëve), kanë mbetur të pandryshuara. Për sektorin e bizneseve, niveli i rrezikut gjithashtu ka rezultuar "i ulët" dhe në rënie në terma vjetorë, si rezultat i përmirësimit të treguesve lidhur me nivelin e huamarrjes dhe cilësinë e portofolit të kredisë, ndërkohë që niveli i rrezikut nga pjesa tjetër e treguesve nuk ka ndryshuar. Niveli i përgjithshëm i rrezikut nga sektori i "qeverisë" vlerësohet i "ulët" dhe disi më i zbutur, falë tkurrjes së peshës së borxhit publik ndaj PBB-së dhe ecurisë pozitive të të ardhurave tatimore krahasuar me një vit më parë. Ecuria e këtyre dy treguesve ka balancuar rreziqet lidhur me thellimin e deficitit buxhetor gjatë periudhës dhe rritjen e kostos së borxhit.

Grafik 2. Ndryshimi vjetor në notën e rrezikut sipas sektorëve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Vlerësimet për rrezikun nga "Qeveria" janë kryer duke u bazuar në të dhënat zyrtare për tremujorin e parë 2024.

⁴ Vlerësimet janë kryer duke u bazuar në vlerat më të fundit zyrtare të publikuara që i përkasin tremujorit të tretë-2024.

Reziqet e lidhura me veprimtarinë e sektorit bankar

Rreziku nga kapitalizimi dhe përfitueshmëria është “i ulët” dhe ka rënë krahasuar me një vit më parë, kryesisht si pasojë e rritjes në të ardhurat e sektorit bankar, raporteve të qëndrueshme të kapitalit të sektorit ndaj aktiveve të tij, si dhe, në një masë më të vogël, nga përmirësimi i cilësisë së portofolit të kredisë. Rreziku nga likuiditeti dhe financimi ka rezultuar në nivelin “mesatar” dhe në rënie të lehtë, ndikuar nga efekti zbutës i rritjes së depozitave të individëve, ndërkohë që zhvillimet në treguesit e tjerë nuk kanë pasur efekt. Rreziku që lidhet me *strukturën e sektorit bankar* gjithashtu ka mbetur në nivelin “mesatar” dhe pothuaj i pandryshuar gjatë periudhës, pasi rënia e rrezikut nga treguesi i përqendrimit të kredisë ka balancuar rritjen e tij nga ecuria e treguesit të devijimit të nivelit të kapitalit ndaj mesatares së sektorit.

1.2 Mjedisi makroekonomik i jashtëm

Aktiviteti ekonomik botëror ka vijuar të zgjerohet gjatë periudhës, me një ritëm modest, por të qëndrueshëm.

Kjo ecuri u mbështet kryesisht nga ecuria e mirë në sektorët e shërbimeve, rigjallërimi i tregtisë dhe kushtet akomoduese të financimit në tregje.

Presionet inflacioniste kanë vijuar të bien, por ato kanë mbetur në nivele relativisht të larta në sektorë dhe rajone të veçantë. Për këto arsye, veprimet e bankave qendrore drejt lehtësimit të politikës monetare kanë qenë të kujdesshme.

Rënia e inflacionit është shoqëruar me kushte financimi më të favorshme në tregjet financiare.

Në fund të vitit, luhatshmëria në tregje u rrit, duke reflektuar ndryshimet në faktorët e kërkesës dhe ofertës që përfshinin edhe ndikimin e rezultatit të zgjedhjeve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA).

Gjatë periudhës, ekonomia botërore u zgjerua me një ritëm modest, por të qëndrueshëm. Ecuria e mirë e sektorëve të shërbimeve dhe prodhimit - veçanërisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) dhe Kinë - rigjallërimi i tregtisë dhe kushtet akomoduese të financimit në tregje, ishin kontribuuesit kryesorë që mbështetën zgjerimin e aktivitetit ekonomik botëror. Përtej normalizimit të mëtejshëm të zinxhirëve botërorë të prodhimit dhe shpërndarjes, shtimi i aktivitetit tregtar gjatë periudhës reflektoi edhe pasiguritë lidhur me politikat e tregtare të administratës së re të SHBA-së që do të niste punën në janar 2025. Ecuria e treguesve makroekonomikë dhe probabiliteti i lartë për mosmarrëveshje tregtare mes poleve ekonomike më të mëdha të Botës, përforcon pritjet për një rritje ekonomike modeste gjatë dy viteve të ardhshme.

Në rajonet e zhvilluara, ekonomia e SHBA-së është rritur në mënyrë të qëndrueshme në tremujorin e tretë dhe të katërt të vitit, mbështetur nga gjallërimi i konsumit privat dhe shtetëror, ndërkohë që rritja e ekonomike e Evropës ka mbetur e ndrydhur, ndikuar nga ecuria e dobët e prodhimit dhe e eksporteve. Në rajonet në zhvillim, rritja është diktuar kryesisht nga zgjerimi ekonomik i Kinës, mbështetur veç të tjerash dhe nga një seri stimulues fiskalë, me qëllim përmirësimin e besimit dhe nxitjen e konsumit. Treguesit për vendet e tjera në zhvillim ishin më pak optimistë.

Inflacioni global ka vijuar të bjerë, por presionet kanë shfaqur shenja rritjeje në sektorë dhe rajone të caktuara, veçanërisht në muajt e fundit të vitit. Në vendet e zhvilluara dhe disa nga ato në zhvillim, inflacioni i mallrave është rikthyer në vlerat më të ulëta të parapandemisë, ndërsa inflacioni i shërbimeve ka mbetur i lartë, ndikuar nga presionet në tregun e punës. Aty ku presionet inflacioniste kanë rezultuar më të qëndrueshme, bankat qendrore janë shfaqur më të kujdesshme në ciklin e lehtësimit monetar, duke theksuar angazhimin e tyre për të rikthyer inflacionin brenda objektivave të synuar.

Në tregjet e lëndëve të para, çmimet e naftës dhe të gazit u rriten, ndërsa ato të metaleve u shfaqen të qëndrueshme. Çmimet e ushqimeve gjithashtu shfaqën një prirje rritëse, kryesisht për shkak të ndryshimeve të ofertës.

Ekonomia botërore pritet të vijojë të rritet në mënyrë të qëndrueshme, por të ngadaltë gjatë periudhës 2025-2026, dhe rritja do të kryesohet nga rajonet në zhvillim.

Normat e inflacionit në shkallë globale pritet të mbeten në trajektore rënëse.

Rreziqet ndaj perspektivës së ekonomisë botërore vlerësohen përgjithësisht në rritje, ndikuar nga dinamikat e inflacionit, ecuria e tensioneve gjeopolitike dhe tregtare, si edhe nevoja për ndryshime strukturore të lidhura me klimën dhe teknologjinë.

Në tregjet financiare, kushtet e financimit u bënë më të favorshme, duke reflektuar lehtësimet në politikat monetare të bankave qendrore. Në tregjet evropiane, normat afatshkurtra të interesit shënuan rënie, duke reflektuar qëndrimin e Bankës Qendrore Evropiane (BQE) drejt normalizimit të politikës monetare përmes uljeve të njëpasnjëshme të normës bazë të interesit. Ndërsa në SHBA, normat më të larta të rritjes ekonomike dhe persistenca e presioneve inflacioniste, kërkuan rritjen e normës bazë të interesit nga ana e Rezerves Federale në periudhën qershor-shtator 2024, duke e çuar atë në intervalin 5.5%-5.75%. Në tregjet e titujve të borxhit të qeverive, normat e kthimit kanë qenë përgjithësisht në rritje në tregjet amerikane dhe në rënie në ato evropiane, por në këto të fundit janë vënë re diferenca mes vendeve, ndikuar nga situatat politike dhe zhvillimet fiskale individuale. Në tregjet e kapitalit, luhatshmëria u bë më e ndjeshme në tremujorin e fundit të vitit, ndikuar nga rezultati i zgjedhjeve presidenciale në SHBA dhe pasiguria lidhur me politikën e administratës së re. Çmimet e monedhave në tregjet e këmbimit të valutave kryesore kanë treguar mbiçmimin e Dollarit amerikan ndaj Euros dhe shumicës së monedhave të partnerëve tregtarë, duke reflektuar kërkesën për investime me norma më të larta të kthimit. Euro u nënçmua gjithashtu dhe në raport me Paundin britanik, Frangën zviceriane, dhe ndaj monedhave të disa prej vendeve në zhvillim.

Në tregjet e lëndëve të para, çmimet kanë qenë të qëndrueshme, dhe kanë treguar një prirje rritëse në fund të vitit. Në tregjet e energjisë, çmimet e naftës kanë qenë të luhatshme, për shkak të përshkallëzimit të tensioneve gjeopolitike në Lindjen e Mesme dhe ndikimit mbi kërkesën dhe ofertën. Në kahun e kërkesës, rritja e konsumit nga SHBA-të rriti presionet e çmimeve në treg, gjë që u balancua nga dobësimi i kërkesës për naftë nga Kina. Në Evropë, çmimi i gazit natyror u rrit në fund të vitit, për shkak të kërkesës më të lartë në stinën e dimrit, mbylljes së marrëveshjes së tranzitit mes Ukrainës dhe Rusisë, si edhe pakësimit të furnizimeve nga burime alternative. Në tregjet e lëndëve të para joenergjetike, çmimet e metaleve kanë mbetur të stabilizuara. Në tregjet e produkteve ushqimore, çmimet kanë shfaqur një trajektore rritëse, ndikuar nga faktorë të ofertës.

Parashikimet e ekspertëve sugjerojnë që ekonomia botërore do të vijojë të zgjerohet në mënyrë të qëndrueshme, por të ngadaltë, gjatë viteve 2025- 2026⁵. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), rritja ekonomike e rajoneve të zhvilluara do të jetë pranë një niveli mesatar prej 1.8% - 1.9%, ku aktiviteti në SHBA pritet të vijojë të zgjerohet me një ritëm të qëndrueshëm, ndikuar nga forcimi i

⁵ Në përditësimin më të fundit (Janar 2025), FMN-ja parashikon që aktiviteti i ekonomisë botërore do të zgjerohet me 3.3% për vitet 2025 dhe 2026.

kërkesës së brendshme dhe kushtet e favorshme të financimit. Nga ana tjetër, rritja ekonomike e Eurozonës do të mbetet e ndrydhur gjatë këtij viti, ndikuar nga dobësimi i prodhimit dhe investimeve, në kushtet e rritjes së pasigurive politike të rajonit. Rritja ekonomike pritet të rigjallërohet gjatë vitit të ardhshëm, mbështetur nga ecuria e konsumit të brendshëm dhe forcimi i kërkesës së jashtme. *Ekonomitë në zhvillim* parashikohet të vijojnë të rriten në mënyrë të qëndrueshme, mbështetur kryesisht nga zgjerimi i mëtejshëm i aktivitetit në vendet e mëdha si Kina dhe India.

Pavarësisht luhatjeve të vitit të kaluar, inflacioni global pritet të mbetet në trajektoren rënëse⁶, ndikuar nga ngadalësimi i kërkesës për shkak të ftohjes graduale të tregut të punës dhe pritjet për rënien e çmimeve të lëndëve të para energjetike. Presionet inflacioniste pritet të mbeten më të ndrydhura në Evropë dhe në disa nga rajonet e mëdha në zhvillim, krahasuar me SHBA-në, gjë që mund të thellojë divergjencat e pritjeve mbi politikat e ardhshme të bankave qendrore.

Rreziqet ndaj perspektivës së ekonomisë botërore vlerësohen në rritje. Në afatin e shkurtër, rreziku kryesor lidhet me shpejtësinë e rënies së inflacionit që, pavarësisht shenjave të ngadalësimit, mbetet ende mbi nivelet e synuara të bankave qendrore, gjë që mund të vonojë normalizimin e politikës monetare përtej pritjeve. Në afatin e mesëm, përshkallëzimi i tensioneve gjeopolitike - veçanërisht vijimi i luftës në Ukrainë dhe konflikti në Rripin e Gazës - ndryshimet e mundshme në qëndrimet politike, ushtarake dhe tregtare të administratës së re të SHBA-ve, dhe nevoja për ndryshime strukturore të lidhura me ndryshimet klimaterike dhe risitë teknologjike, përbëjnë sfidat kryesore ndaj rigjallërimit të pritshëm të aktivitetit ekonomik botëror.

⁶ FMN-ja parashikon që inflacioni në shkallë botërore do të bjerë në nivelin 4.2% në vitin 2025, dhe në 3.5% në vitin 2026.

Ekonomia e Eurozonës është ngadalësuar gjatë periudhës, për shkak të dobësisë së ekonomisë në vendet anëtare më të mëdha. Aktiviteti është mbështetur nga forcimi i konsumit, ndërkohë që rënia e investimeve dhe ngadalësimi i eksporteve kanë pasur efekt frenues.

Më gjithë rënien e inflacionit në pjesën më të madhe të vitit, presionet inflacioniste kanë qenë të pranishme gjatë periudhës, ndikuar kryesisht nga tregu i shtrënguar i punës, rritja e çmimeve të energjisë dhe reflektimi i vonuar i rritjeve të mëparshme të çmimeve në disa sektorë ekonomikë.

Banka Qendrore Evropiane ka ndërmarrë veprime drejt lehtësimit gradual monetar gjatë periudhës, duke mbetur e fokusuar tek arritja e objektivit të inflacionit prej 2%.

Tregjet financiare evropiane janë karakterizuar nga luhatshmëria, veçanërisht në afatet më të gjata. Rënia e normave të interesit është reflektuar në kushtet e kreditimit, por rritja e tij ka mbetur poshtë pritshmërive.

Rritja ekonomike e Eurozonës pritet të mbetet anemike gjatë këtij viti dhe të rigjallërohet gradualisht gjatë vitit të ardhshëm, e mbështetur nga konsumi dhe

Eurozona

Pas një periudhe me rritje modeste por pozitive gjatë tre muajve të parë të vitit 2024, ekonomia e Eurozonës duket se ka hyrë në një fazë stanjacioni në tremujorin e fundit të vitit. Aktiviteti ekonomik u zgjerua me 0.4% në T3-2024, mbështetur nga rimëkëmbja e konsumit dhe inventarëve, ndërkohë që tregtia pati efekt shtrëngues, për shkak të ngadalësimit të eksporteve. Treguesit ekonomikë dëshmojnë për një ngadalësim të rritjes gjatë tremujorit të fundit të 2024-ës, në të cilin Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) u rrit me vetëm 0.1%. Kjo ecuri u përcaktua nga rënia e investimeve, që neutralizoi kontributin pozitiv të konsumit privat dhe publik gjatë periudhës. Ky rezultat mesatarizon ecuri të ndryshme të PPB-së mes vendeve anëtare, ku vende si Spanja dhe Portugalia kanë vijuar të shënojnë rritje ekonomike, ndërsa Gjermania dhe Franca kanë shënuar rënie ekonomike. Ekspertët parashikojnë që ekonomia e Eurozonës do të rimëkëmbet me ritëm të moderuar gjatë vitit 2025, mbështetur kryesisht nga forcimi i konsumit të brendshëm si rezultat i rënies së inflacionit dhe efektit pozitiv të të ardhurave. Në të njëjtën kohë, forcimi i kërkesës së jashtme pritet të mbështesë rritjen e eksporteve evropiane, ndërsa politika akomoduese monetare e Bankës Qendrore Evropiane do të mbështesë kushtet e financimit në tregje.

Zhvillimet në tregun e punës ndikuan në rritjen e inflacionit në fund të periudhës. Norma vjetore e inflacionit të Eurozonës arriti në 2.4% në dhjetor 2024, nga 2.2% në muajin nëntor. Dinamikat e inflacionit u diktuan kryesisht nga ecuria e çmimeve të energjisë dhe inflacioni në sektorin e shërbimeve. Përbërësit e inflacionit të brendshëm vijnë të përcaktohen nga rritja e qëndrueshme e pagave në tregjet evropiane të punës dhe reflektimi i vonuar i rritjeve të mëparshme të çmimeve në sektorë të caktuar. Në *tregun e punës*, zhvillimet kanë qenë të qëndrueshme, por me sinjale dobësimi në fund të periudhës. Niveli i punësimit ka vijuar të rritet në tremujorin e tretë dhe është stabilizuar në muajt e fundit të vitit, ndërsa kërkesa për punësim është ngadalësuar. Norma mesatare e papunësisë ra në 6.2% në muajin dhjetor, duke shënuar një nga vlerat më të ulëta historike që nga fillimi i përdorimit të monedhës së përbashkët Euro.

Në tregjet financiare evropiane, zhvillimet ishin të luhatshme gjatë periudhës. Ecuria e normave dhe vlerave në tregje u diktua nga veprimet e BQE-së në drejtim të lehtësimit të politikës monetare, rezultati i zgjedhjeve presidenciale në SHBA dhe pasiguria lidhur me përshtetshmërinë e tensioneve gjeopolitike dhe tregtare. Nisur nga rënia graduale e inflacionit në pjesën më të madhe të vitit 2024, gjatë periudhës qershor-dhjetor 2024, BQE-ja ka realizuar 4 ulje të normës bazë të interesit me nga 25 pikë pazë (0.25%), dhe ka deklaruar se politika e saj do të mbetet e orientuar drejt arritjes së objektivit afatmesëm të inflacionit në nivelin 2%. Këto qëndrime janë reflektuar në rënien e normave afatshkurtra të interesit në tremujorin e fundit të vitit, ndërkohë që kushtet financiare në tregje më afatgjata kanë qenë më të luhatshme.

shërbimet. Norma e inflacionit pritet të lëvizë drejt objektivit prej 2%. Pasiguria për këto parashikime mbetet e lartë, në kushtet e tensioneve gjeopolitike dhe atyre tregtare.

Kushtet e kreditimit të bizneseve dhe individëve janë lehtësuar gjatë periudhës. Uljet e herëpashershme të normës bazë të interesit nga BQE-ja nisën të reflektohen gradualisht në uljen e normave të kredisë për bizneset dhe familjet në muajt e fundit të vitit. Megjithatë, rritja e kredisë mbeti përgjithësisht e ndrydhur veçanërisht nga sektori i bizneseve, ndikuar nga kërkesa e dobët dhe perceptimi për standarde ende të shtrënguara të kreditimit.

Sipas parashikimeve më të fundit të publikuara nga BQE-ja, aktiviteti ekonomik në Eurozonë pritet të mbetet në rritje të moderuar gjatë vitit 2025. Në afatin e shkurtër, rritja do të vijojë të diktohet kryesisht nga sektori i shërbimeve, ndërkohë që zhvillimet në sektorin e industrisë pritet të mbeten modeste, për shkak të kërkesës ende të dobët për mallra dhe pasigurisë lidhur me politikat e ardhshme tregtare. Nga ana tjetër, rritja e të ardhurave të disponueshme si rezultat i rritjes së qëndrueshme të pagave, forcimi i kërkesës së jashtme për eksportet evropiane dhe lehtësimi i kushteve të financimit, pritet të mbështesin zgjerimin ekonomik të rajonit në afatin më të gjatë. Këto parashikime mbeten të rrethuara nga një nivel i lartë pasigurie, lidhur me tensionet tregtare dhe gjeopolitike në rritje, të cilat mund të pengojnë rigjallërimin e prodhimit dhe të investimeve. Normat e inflacionit pritet të luhaten rreth niveleve aktuale dhe në pjesën e parë të vitit 2025 dhe të rikthehen nën nivelin 2% në fund të tij. Deri atëherë, BQE-ja ka deklaruar se mbetet e angazhuar në misionin e saj për të rikthyer inflacionin brenda objektivit të synuar, duke ruajtur njëkohësisht stabilitetin ekonomik dhe financiar të Eurozonës.

Tabelë 1. Disa tregues makroekonomikë për SHBA-në, Eurozonën dhe disa vende anëtare

	Ndryshimi i PBB-së (% vjetore)			Inflacioni (% vjetore)		Papunësia (% vjetore)		Borxhi i qeverisë (% e PBB-së)	
	2024*	T3'24	T4'24	Sht'24	Dhj'24	Sht'24	Dhj'24	T2'24	T3'24
SHBA	2.8	2.7 (0.8)	2.5 (0.6)	2.4	2.9	4.1	4.1	95.2	96.4
Eurozonë	0.8	1.1 (0.4)	1.4 (0.4)	1.7	2.4	6.3	6.2	88.2	88.2
Gjermani	-0.2	-0.3 (1.1)	-0.2 (-0.2)	1.8	2.8	3.5	3.5	61.9	62.4
Francë	1.1	1.2 (0.4)	0.6 (-0.1)	1.4	1.8	7.4	7.3	112.4	113.8
Itali	0.6	0.6 (0.0)	0.6 (0.0)	0.7	1.4	6.2	6.4	136.9	136.3
Greqi	:	2.3 (0.4)	2.6 (0.9)	3.1	2.9	9.6	9.3	160.0	158.2

Burimi: BQE, Eurostat, *-vlerësim i FMN-së (Janar, 2025), Zyra Amerikane e Analizave Ekonomike (US Bureau of Statistical analysis); Zyra Amerikane e Statistikave të Punës (U.S. Bureau of Labor Statistics); ": mungesë informacioni.

Shënim: Vlerat në kllapa të PPB-së së Eurozonës përfaqësojnë rritjet tremujore.

Sipas të dhënave të tremujorit të tretë të vitit 2024, ekonomitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor vijuan të rriten pozitivisht, ndonëse në disa prej vendeve ritmi i rritjes është ngadalësuar krahasuar me pjesën e parë të

Ballkani Perëndimor

Ekonomia e vendeve të Ballkanit Perëndimor u zgjerua mesatarisht me 3.2% gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024, krahasuar me një vit më parë (nga 3.7% në tremujorin paraardhës). Të gjitha vendet regjistruan rritje pozitive të PBB-së, por përgjithësisht më të moderuar

vitet. Kontributin kryesor në këtë rritje e ka dhënë konsumi i brendshëm, i mbështetur nga rritja e pagave, dhe ecuria e mirë e eksportit të shërbimeve. Nga ana tjetër, eksportet e mallrave ishin përgjithësisht të dobëta dhe deficit i llogarisë korrente është zgjeruar në shumicën e vendeve.

Zgjerimi i aktivitetit ekonomik ka sjellë përmirësim të bilanceve fiskale dhe ulje të borxhit publik.

Inflacioni ka vijuar te bjerë në të gjitha vendet e rajonit, ndaj bankat qendrore kanë lëvizur në drejtim të lehtësimit monetar.

Kushtet e lehtësuara monetare kanë favorizuar rritjen e kredisë. Cilësia e kredisë në rajon ka mbetur e qëndrueshme dhe raportet e kredive me probleme raportohen në nivele relativisht të ulëta.

krahasuar me tremujorin paraardhës. Rritja u mbështet kryesisht nga kërkesa e brendshme ku kontributin kryesor e dhanë shpenzimet e konsumit, të ndihmuara nga rritja nominale e pagave. Norma e papunësisë shënoi rënie në shumicën e vendeve gjatë tremujorit të tretë 2024, duke u luhatur nga 8.1% në Serbi, në 12.2% në Maqedoninë e Veriut, por duke mbetur mbi nivelin mesatar të BE-së. Ndërsa tregtia neto dha kontribut negativ në rritjen ekonomike. Në përgjithësi, dinamikat e tregtisë të rajonit ishin të luhatshme, ku ecuria e eksportit të mallrave rezultoi e dobët dhe herë pas here në rënie, ndërsa eksporti i shërbimeve, veçanërisht i atyre turistike, pavarësisht ngadalësimit, mbeti i kënaqshëm. Flukset e investimeve direkte mbetën përgjithësisht të qëndrueshme. Rritja pozitive dhe e qëndrueshme i ka ndihmuar vendet e rajonit të regjistrojnë përmirësim të balancave buxhetore dhe të ulin nivelet e borxhit publik në raport me PBB-në. Kjo ecuri ishte më e theksuar në rastin e Shqipërisë dhe të Kosovës.

Presionet inflacioniste u zbutën gjatë tremujorit të tretë, por u treguan më të qëndrueshme në tremujorin e katërt të vitit. Si rezultat, normat mesatare të inflacionit vjetor variuan nga 1.1% në Kosovë, në 4.4% në Maqedoninë e Veriut. Me përjashtim të Shqipërisë dhe të Maqedonisë së Veriut, në vendet e tjera të rajonit, bankat qendrore ruajtën të pandryshuar normën bazë të interesit. Në përgjithësi, kostot e financimit kanë rënë dhe kjo është reflektuar në zgjerimin e aktivitetit kreditues në të gjitha vendet e rajonit. Raportet e kredive me probleme kanë vijuar të mbeten të ulëta dhe në rënie.

Tabelë 2. Disa tregues kryesorë makroekonomikë dhe financiarë për vendet e Ballkanit Perëndimor

	PBB (reale, % vjetore)			Papunësia (në %)		Borxhi i qeverisë (% e PBB-së)		Rritja e kredisë (% vjetore)		Rap. i kredive me probleme (në%)	
	T2'23	T3'24	2024 p	T3 24	T3'24 *	T2'24	T3'24	T3' 24	T4'24 *	T3'24	T4'24 *
Bosnje-Hercegovinë	2.3	2.6	2.3	13.3	12.2	25.3	24.8	9.6	9.8	3.5	:
Maqedoni e Veriut	2.8	3.0	2.9	12.6	12.5	49.1	49.3	7.5	9.8	3.0	:
Mali i Zi	2.7	2.6	3.4	11.5	11.2	61.2	60.2	15.6	14.0	4.0	3.8
Kosovë	4.3	4.1	:	:	:	15.8	15.5	14.6	16.3	2.1	2.1
Serbi	4.2	3.1	3.5	8.2	8.1	50.0	46.5	6.0	7.8	2.7	:
Shqipëri**	4.0	4.1	3.3	:	:	55.7	55.5	12.5	12.8	4.6	4.2

Burimi: Komisioni Evropian, bankat qendrore përkatëse, INSTAT. Shpjegime: 'p'- parashikimi i ECFIN në janar, 2025; ':' mungesë informacioni; "*" të dhënat të muajit nëntor, 2024; "***" të dhënat të muajit dhjetor 2024.

1.3 Mjedisi makroekonomik në vend

Gjatë periudhës, ekonomia shqiptare vijoi të rritej me ritme pozitive dhe në fund të tremujorit të tretë rritja

Sektori real dhe tregu i punës

Në fund të tremujorit të fundit të vitit, norma e rritjes vjetore të ekonomisë ishte rreth 3.6%. Kjo normë ishte më e ulët si në terma vjetorë ashtu edhe tremujorë, kur rritja e aktivitetit ekonomik në vend arriti në një

ekonomike vjetore shënoi vlerën 4.1%.

Kjo rritje ka pasur një bazë të gjerë sipas sektorëve, dhe është mbështetur kryesisht nga kërkesa e brendshme, në formën e konsumit final dhe investimeve të sektorit privat.

Tregu i punës u karakterizua nga zhvillime pozitive, në formën e rritjes së punësimit të pagave në sektorin shtetëror dhe atë privat.

nivel prej përkatësisht rreth 4.2%. Rritja ekonomike është ndikuar kryesisht nga sektori i shërbimeve. Të dhënat e periudhës tregojnë që kontributin kryesor në rritje e kanë dhënë degët e "administrimit publik, arsimit dhe shëndetësisë", "tregtisë, transportit, akomodimit dhe shërbimit ushqimor", "aktivitetet e pasurive të paluajtshme", ndjekur nga aktiviteti i "ndërtimit"⁷. Nga ana tjetër, "industria" dhe "bujqësia" kontribuuan negativisht në rritjen ekonomike, me përkatësisht rreth 0.9 dhe 0.4 p.p.

Nga ana e kërkesës, rritja ekonomike kishte një bazë të gjerë dhe u mbështet kryesisht nga konsumi final dhe investimet e sektorit privat. Ndërsa, rritja në flukset e importeve të mallrave dhe shërbimeve, shoqëruar me ngushtimin e eksporteve të tyre, ka ndikuar në kahun negativ. Treguesi i ndjesisë ekonomike, ndonëse vijon të regjistrojë vlera mbi mesataren e tij historike, shënoi rënie në muajin dhjetor, ndikuar kryesisht nga rënia e treguesve të besimit në të gjithë sektorët e biznesit, kryesisht në ndërtim dhe në shërbime. Po në kahun negativ, por në një masë më të vogël, ka ndikuar edhe rënia e besimit të konsumatorit.


Zhvillimet në tregun e punës gjatë tremujorit të katërt të vitit ishin pozitive. Punësimi u rrit me rreth 1.6 p.p. në terma vjetorë, duke arritur në nivelin e rreth 68%. Kjo ecuri reflektoi rritjen e numrit të të punësuarve në sektorin e bujqësisë me 1.0%, në sektorin e industrisë me 3.6% dhe në atë të industrisë me 1.5%. Si rrjedhojë, norma e papunësisë u ul në nivelin 8.8%, kundrejt 9.5% një vit më parë. Papunësia për grup-moshën 30-64 vjeç është 7.3%, lehtësisht më e ulët se një vit më parë (7.5%). E njëjta prirje vërehet edhe në treguesin e papunësisë të rinjtë (15-29 vjeç), e cila arriti në nivelin 19.1%, duke regjistruar një rënie vjetore prej rreth 2.1 pikësh përqindjeje.

Rritja e pagave ka vijuar në sektorin shtetëror dhe në atë privat. Në terma vjetorë, norma mesatare e rritjes së pagave^[1] arriti në rreth 11% gjatë tremujorit të katërt të vitit, duke reflektuar rritjen e pagave në sektorin privat (rreth 10%) dhe në sektorin publik (rreth 14%). Në sektorin privat, rritja e pagave është shtrirë në të gjithë sektorët, por mbetet më e theksuar në sektorin e shërbimeve. Rritja me bazë të gjerë e pagave përbën një premisë pozitive për përmirësimin e shëndetit ekonomik dhe financiar të familjeve shqiptare, me ndikim direkt në përmirësimin e aftësisë paguese të kredimarrësve dhe raporteve të disa treguesve të kredisë, si atij të "të ardhura ndaj borxhit" dhe të "shërbimit të borxhit ndaj të ardhurave".


⁷ Këta sektorë kontribuuan përkatësisht me rreth 1.44 p.p., 0.81 p.p., 0.50 p.p. dhe 0.25 p.p. në terma vjetorë.

[1] Paga mesatare mujore bruto.

Grafik 3. Rritja vjetore e PBB-së




Burimi: INSTAT.

Grafik 4. Norma e inflacionit⁸

Burimi: INSTAT.

Grafik 5. Balanca buxhetore ndaj PBB-së



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Periudha është karakterizuar nga përshpejtimi i rënies së normës së inflacionit, e ndikuar kryesisht nga ecuria e çmimit të ushqimeve. Kjo ecuri ka reflektuar qëndrimin e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë dhe mbiçmimin e monedhës vendase. Megjithatë, presionet inflacioniste nga ekonomia e brendshme janë shfaqur më të qëndrueshme në sajë të tregut të shtrënguar të punës dhe forcës së konsumit.

Në muajt korrik dhe nëntor, Banka e Shqipërisë uli normën bazë të interesit me nga 25 pikë bazë, në nivelin 2.75%.

Në pjesën më të madhe të periudhës, politika fiskale ka qenë në kahun konsolidues, me një tepricë pozitive buxhetore dhe, vetëm në fund të saj, përmbushi

Zhvillimet monetare dhe fiskale

Gjatë periudhës inflacioni përshpejtoi ritmin e rënies. Norma mesatare e inflacionit vjetor zbriti në nivelin 2.2% në fund të vitit 2024, kundrejt 4.8% një vit më parë. Kjo ecuri e inflacionit reflektoi një situatë më të favorshme me çmimet e ushqimeve. Ajo gjithashtu evidentoi kontributin e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë dhe të ecurisë mbiçmuese të monedhës vendase që ka zbutur presionet inflacioniste nga mallrat e importuara. Nga ana tjetër, presionet e brendshme inflacioniste kanë qenë më të qëndrueshme, në sajë të tregut të shtrënguar të punës dhe forcës së konsumit. Rënia e inflacionit mundësoi që, në muajt korrik dhe nëntor, Banka e Shqipërisë të ulë normën bazë të interesit me nga 0.25 pp, në nivelin 2.75%. Presionet inflacioniste duken përgjithësisht në rënie, por balanca e rreziqeve paraqitet në kahun rritës, për shkak të ndikimit eventual prej tensioneve gjeopolitike dhe mosmarrëveshjeve tregtare mes poleve ekonomike rajonale dhe botërore.

Politika fiskale ruajti pozicionin konsolidues në pjesën më të madhe të periudhës, me një tepricë pozitive buxhetore dhe, vetëm në fund të saj, përmbushi vlerat e synuara të deficitit fiskal. Në fund të muajit dhjetor 2024, balanca buxhetore regjistroi një tepricë negative (deficit) prej rreth 18 miliardë lekësh, kundrejt një deficiti prej rreth 31 miliardë lekësh një vit më parë. Në raport me PBB-në, treguesit e qëndrueshmërisë fiskale - deficiti buxhetor dhe borxhi publik në total – janë përmirësuar me tej, duke vijuar rënien. Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, borxhi publik në fund të muajit dhjetor 2024 zbriti në nivelin 55%, më i ulët që nga viti 2010.

Ngushtimi i deficitit fiskal në terma vjetorë ka ardhur për shkak të rritjes më të lartë të të ardhurave në krahasim me shpenzimet. Kështu, të ardhurat u rritën me rreth 67 miliardë lekë ose me rreth 10%. Prej tyre, të ardhurat nga tatimet dhe doganat u rritën me rreth 34 miliardë lekë ose me 8%. Nga

⁸ Norma mesatare tremujore e rritjes vjetore të IÇK-së.

vlerat e synuara të deficitit fiskal. Në raport me PBB-në, treguesit e qëndrueshmërisë fiskale - deficitit buxhetor dhe borxhi publik – janë përmirësuar, duke vijuar rënien. Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, në fund të vitit 2024, borxhi publik zbriti në nivelin 55%, më i ulëti që nga viti 2010.

Në bilancin e pagesave me jashtë, deficitit i llogarisë korrente u zgjerua në tremujorin e katërt të vitit. Në këtë rezultat, kontributi kryesor erdhi nga thellimi i deficitit në llogarinë e tregtimit të mallrave, zgjerimi i tepricës pozitive në llogarinë e shërbimeve, rritja e tepricës pozitive në llogarinë e të ardhurave parësore për shkak të rritjes së dërgesave të emigrantëve dhe ulja e deficitit të llogarisë së të ardhurave dytësore. Balancat e llogarisë kapitale dhe asaj financiare ishin pozitive, duke reflektuar rritjen e flukseve të njëanshme për sektorin privat dhe atë publik, rritjen e investimeve të huaja direkte dhe të investimeve të tjera, dhe tepricën negative në investimet e portofolit.

Gjatë periudhës, mjetet e rezervës valutore vijuan të rriten, duke mbuluar 7 muaj importe, dhe gati

ana tjetër, shpenzimet u rritën me rreth 54 miliardë lekë ose me rreth 8%, dhe u orientuan drejt shpenzimeve korrente për fondet speciale dhe ato për paga, ndjekur nga ato kapitale. Deficiti buxhetor është financuar më shumë nga huamarrja e brendshme sesa ajo e huaj. Shpërndarja më e drejtë e shpenzimeve të planifikuara përgjatë vitit mbetet një nevojë e administrimit fiskal. Një zhvillim i rëndësishëm nga pikëpamja fiskale është dhe emetimi nga ana e Republikës së Shqipërisë i Eurobondit me vlerë 650 milionë euro, në shkurt të 2025. Instrumenti ka një maturitet 10-vjeçar dhe u emetua me një normë interesi prej 5%. Emetimi i Eurobondit ka një rëndësi të veçantë pasi jo vetëm që siguron likuiditet të nevojshëm, por konfirmon prezencën e Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare të kapitalit, duke ndikuar në vlerësimin e kredibilitetit afatgjatë të ekonomisë shqiptare.

Sektori i jashtëm

Në fund të tremujorit të katërt, deficitit i llogarisë korrente rezultoi 374 milionë euro. Në krahasim me një vit më parë, vëllimi i transaksioneve në llogarinë korrente u rrit me 6% dhe deficitit u thellua me 133 milionë euro (ose 55%), për shkak të thellimit të deficitit në tregtinë e mallrave. Deficiti në tregtinë e mallrave u thellua me 325 milionë euro në terma vjetorë dhe ka evidentuar të ardhurat më të ulëta nga eksportet, dhe rritjen e kërkesës për importe. Kontribut në zbutjen e deficitit të llogarisë korrente dha zgjerimi i bilancit pozitiv në tregtinë e shërbimeve, me rreth 19%, në nivelin 886 milionë eurove. Brenda saj, bilanci pozitiv i shërbimeve të udhëtimit u rrit me 147 milionë euro. Gjithashtu, teprica pozitive në llogarinë e të ardhurave dytësore u zgjerua në 337 milionë euro, ku prurjet valutore të emigrantëve u rritën me 8%, në nivelin 273 milionë euro. Deficiti në llogarinë e të ardhurave parësore u ngushtua (me 35 milionë euro) në nivelin 51 milionë euro, duke evidentuar efektin kryesor të të ardhurave nga puna dhe flukseve dalëse të kthimit nga investimet.

Llogaria kapitale rezultoi me një fluks neto pozitiv prej 44 milionë eurosh, kundrejt fluksit neto negativ prej 50 milionë eurosh të një viti më parë. Kjo ecuri është diktuar nga flukset hyrëse për sektorin privat dhe grantet e huaja për mbështetje buxhetore të qeverisë shqiptare. Në llogarinë financiare, pa përfshirë rritjen e rezervës valutore, flukset neto hyrëse ishin 561 milionë euro dhe reflektuan zgjerimin e detyrimeve neto në formën e investimeve të huaja direkte (382 milionë euro) dhe të investimeve të tjera (360 milionë euro). Investimet e portofolit, rezultuan me flukse neto dalëse, ose me rritje të pretendimeve të huaja të ekonomisë shqiptare, për rreth 182 milionë euro. Mes të tjerash, flukset hyrëse në formën e investimeve të huaja direkte u rritën me 7%, në nivelin 423 milionë euro, dhe ishin të përqendruara në pasuri të paluajtshme (për 25%), sektorin e ndërmjetësimit financiar (për 19%) dhe investime në hidrokarbure (për 13%). Gjatë tremujorit të katërt të vitit, mjetet e rezervës valutore u rritën me 293 milionë euro, në vlerën 6,264


5.3 herë borxhin afatshkurtër.

Gjatë periudhës, pozicioni debitor në investimet ndërkombëtare të vendit u ngushtua.

milionë euro. Rezerva valutore mbulon 7 muaj importe mallrash dhe shërbimesh dhe 5.3 herë borxhin e jashtëm afatshkurtër.


Pozicioni i investimeve ndërkombëtare të vendit mbeti debitor dhe vlera e tij u ngushtua kryesisht për shkak të rritjes së detyrimeve neto të sektorit privat. Në fund të tremujorit të katërt të vitit 2024, mjetet dhe detyrimet financiare të vendit ndaj jorezidentëve ishin përkatësisht 13.5 dhe 23.9 miliardë euro, dhe pozicioni debitor neto u ngushtua me rreth 882 milionë euro në terma vjetorë. Ky ngushtim i pozicionit debitor është ndikuar pozitivisht nga ecuria e mjeteve të rezervës valutore dhe e investimeve të portofolit (që kanë ndikuar në rritjen e pretendimeve të ekonomisë shqiptare ndaj të huajave), dhe është ndikuar negativisht nga ecuria e investimeve të huaja direkte dhe e investimeve të tjera (që kanë ndikuar në rritjen e detyrimeve të ekonomisë shqiptare ndaj të huajave).

Grafik 6. Flukset e bilancit të pagesave dhe bilanci korrent



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe INSTAT.

Grafik 7. Pozicioni i investimeve ndërkombëtare sipas sektorëve




Burimi: Banka e Shqipërisë.

2. Llogaritë financiare dhe pozicioni financiar i individëve dhe bizneseve

Sipas të dhënave të llogarive financiare të vendit për fundin e vitit 2023, ekonomitë familjare (ose individët) dhe korporatat jofinanciare (ose bizneset) vijojnë të mbeten përkatësisht sektori më i madh kreditor dhe sektori më i madh debitor në ekonominë vendase, ndërkohë që Shqipëria paraqitet si një vend me pozicion neto debitor ose huamarrës në raport me pjesën tjetër të botës. Detyrimet neto të ekonomisë tonë ndaj jorezidentëve prej rreth 1,000 miliardë lekësh, përbëheshin nga pozicionet negative të bizneseve (2,400 miliardë lekë) dhe qeverisë (1,000 miliardë lekë), të cilat mbyllen pjesërisht nga pozicioni i konsiderueshëm pozitiv i sektorit të individëve (2,400 miliardë lekë). Përveç sektorit të qeverisë që ka regjistruar zvogëlim të detyrimeve të veta neto gjatë vitit 2023, sektorët e bizneseve dhe individëve kanë vijuar të zgjerojnë pozicionet përkatëse edhe gjatë kësaj periudhe. Për sektorin e bizneseve, thellimi i pozicionit debitor lidhet me rritjen dy herë më të madhe të detyrimeve kryesisht në formën e kapitalit, në krahasim me rritjen e mjeteve të tyre (depozita dhe llogari të tjera). Nga ana tjetër, zgjerimi i konsiderueshëm në pozicionin kreditor të individëve lidhet me rritjen e fortë të pretendimeve të individëve në formën e kapitalit të investuar në bizneset vendase. Sektori i korporatave financiare paraqitet si huadhënës neto ndaj jorezidentëve me pretendime neto që, deri në fund të vitit 2023, arrinin në 670 miliardë lekë. Financimi


midis sektorëve rezidentë mbulohet: nga sektori i individëve/ekonomive familjare, i cili financon kryesisht bizneset me kapital dhe sektorin e korporatave financiare me depozita; nga sektori i korporatave financiare që financon bizneset dhe individët me kredi dhe qeverinë e përgjithshme, duke investuar në letra me vlerë; dhe nga sektori i qeverisë së përgjithshme, i cili ka një pretendim të vogël neto në raport me bizneset vendase. Të dhënat e disponueshme për vitin 2024 flasin për rritje të detyrimeve të bizneseve ndaj jorezidentëve, për shkak të rritjes së stokut të investimeve të huaja direkte, rritje të ndjeshme të detyrimeve neto të bizneseve ndaj sektorit financiar, për shkak të rritjes më të shpejtë të kredisë në krahasim me depozitat, dhe një rritje po ashtu të fortë të pozicionit kreditor neto të familjeve ndaj sektorit financiar.

Grafik 8. Pozicioni dhe financimi neto midis sektorëve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 9. Pozicioni neto i bizneseve dhe individëve sipas kundërpasive



2.1 Pozicioni financiar i bizneseve

Sipas të dhënave të llogarive financiare të vendit për fundin e vitit 2023, ekonomitë familjare (ose individët) dhe korporatat jofinanciare (ose bizneset) vijojnë të mbeten përkatësisht sektori më i madh kreditor dhe sektori më i madh debitor në ekonominë vendase, ndërkohë që Shqipëria paraqitet si një vend me pozicion neto debitor ose huamarrës në raport me pjesën tjetër të botë.

Pozicioni i bizneseve është debitor dhe ai është thelluar gjatë vitit 2024, kryesisht si pasojë e rritjes së detyrimeve ndaj

Bizneset vijojnë të përfaqësojnë sektorin më të madh debitor në vend dhe ky pozicion ka vijuar të thellohet gjatë viteve 2023 – 2024.

Detyrimet kryesore të sektorit të bizneseve vijojnë të lidhen me financimin nga sektori i familjeve dhe ai i jorezidentëve, ndërsa instrumenti që mbizotëron në detyrimet e bizneseve është kapitali i individëve, i ndjekur nga kreditë nga institucionet financiare. Pjesa dërrmuese e mjeteve financiare të bizneseve përfaqësohet nga llogari të arkëtueshme ose pretendime të bizneseve ndaj bizneseve të tjera dhe ndaj sektorit të qeverisë, ndërsa detyrimet mbizotërohen nga kapitali i investuar në ndërmarrjet vendase nga familjet rezidente dhe nga investitorët e huaj, si edhe nga llogaritë e pagueshme midis ndërmarrjeve. Zgjerimi i pozicionit debitor të bizneseve gjatë 10 viteve të fundit ka ardhur nga rritja e shpejtë e detyrimeve në formën e kapitalit të investuar nga sektori i familjeve dhe ai i jorezidentëve. Këto detyrime janë pothuajse dyfishuar gjatë viteve 2017-2023 dhe në fund të vitit 2023 shënonin përkatësisht 1,140 dhe 1,350 miliardë lekë. Në fund të vitit 2023, mjetet dhe detyrimet financiare të bizneseve ishin sa 80% dhe 180% e PBB-së vjetore, ndërkohë që pozicioni neto është luhatur rreth nivelit 100%-120% të PBB-së gjatë gjithë periudhës 2013 – 2023, dhe ka shfaqur një prirje në rënie gjatë tre viteve të fundit.

jorezidentëve dhe thellimit të pozicionit debitor ndaj sektorit bankar.

Në raport me jorezidentët, bizneset kanë shtuar në mënyrë të ndjeshme detyrimet në formën e investimeve të huaja direkte dhe në një masë të vogël detyrimet e tjera të borxhit.

Detyrimet neto të bizneseve vijuan të rriten gjatë vitit 2024, ku rritja e kredisë bankare me gati 12%, ishte më e lartë se norma e ulët e rritjes së depozitave. Në rritjen e kredisë dhanë kontribut pozitiv Leku dhe Euroja, duke përfutur edhe nga rënia e normave mesatare përkatëse të interesit.

Rritja e kredisë përfshiu pothuajse të gjithë sektorët e prodhimit, ndërkohë që sipas qëllimit, ajo është përqendruar në blerjen dhe zhvillimin e pronave të paluajtshme nga ana e bizneseve.


Gjatë periudhës, rritjes së kërkesës për kredi nga ana e bizneseve, bankat i janë përgjigjur me ulje të shkallës së refuzimit të aplikimeve.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024, bizneset kanë zgjeruar në mënyrë të ndjeshme pozicionin e tyre debitor ndaj jorezidentëve, si edhe hendekun negativ midis depozitave dhe kredisë bankare⁹. Në raport me sektorin e jorezidentëve, pozicioni neto i bizneseve vendase u thellua me rreth 17% në terma vjetorë, deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2024, duke pasqyruar rritjen në të njëjtën masë në stokun e investimeve të huaja direkte. Pozicioni debitor i bizneseve ndaj sektorit bankar, i matur si diferencë midis depozitave dhe kredive, deri në fund të vitit 2024, u thellua me rreth 36% në krahasim me nivelin e fundvitit 2023. Kjo ecuri lidhet me faktin që stoku i kredisë bankare të bizneseve vendase u zgjerua me rreth 12% ose 50 miliardë lekë, ndërkohë që depozitat e bizneseve në banka kanë mbetur pothuajse të pandryshuara në krahasim me një vit më parë, në rreth 300 miliardë lekë.


Detyrimet neto të bizneseve vendase ndaj jorezidentëve kanë vijuar të rriten si pasojë e rritjes së shpejtë të stokut të investimeve të huaja direkte, të cilat përfaqësojnë pothuajse të gjithë vlerën e detyrimeve neto të bizneseve vendase ndaj jorezidentëve. Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2024, stoku i investimeve të huaja direkte dhe bilanci neto i bizneseve ndaj jorezidentëve sipas pozicionit të investimeve ndërkombëtare të vendit ishin përkatësisht 14.9 dhe 14.1 miliardë euro. Paralelisht, detyrimet në formën e borxhit shënuan një rritje të lehtë, duke u ngjitur në 3.16 miliardë euro. Rritja e detyrimeve ndërkufitare që kanë formën e investimeve kapitale përfaqëson një zhvillim pozitiv për qëndrueshmërinë financiare të bizneseve dhe të vendit, duke qenë se këto investime kanë natyrë afatgjatë, kanë kosto më të lartë tërheqjeje dhe janë më pak të ndjeshme ndaj goditjeve afatshkurtra me natyrë spekulative në krahasim me investimet e portofolit apo ato në instrumente të tjera financiare si derivativët. Deri në fund të tremujorit të tretë, sektorët me stokun më të madh të investimeve të huaja ishin sektori i energjisë, gazit dhe avullit (3.6 miliardë euro) dhe ai i industrisë nxjerrëse (2.5 miliardë euro). Sektori i aktiviteteve në pasuri të paluajtshme është karakterizuar nga një rritje e shpejtë e investimeve të huaja direkte gjatë viteve të fundit. Në fund të periudhës, këto investime shënonin 1.9 miliardë euro, duke tejkaluar lehtë stokun prej 1.7 miliardë eurosh të investuar nga jorezidentët në sektorin e aktiviteteve financiare dhe të sigurimit.

⁹ Në mungesë të tablosë së plotë të llogarive financiare për vitin 2023, analiza mbështetet mbi treguesit e sektorit të jashtëm deri në fund të tremujorit të tretë dhe treguesit e aktivitetit bankar deri në fund të muajit dhjetor 2023.

Grafik 10. Mjetet (+), detyrimet (-) dhe pozicioni neto i bizneseve sipas instrumenteve



Grafik 11. Pozicioni neto i bizneseve sipas sektorëve




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në rritjen e pozicionit debitor të bizneseve, gjatë vitit 2024 ndikoi edhe rritja më e shpejtë e kredisë në raport me depozitat pranë sektorit bankar.


Gjatë viteve 2020-2023, depozitat e bizneseve janë zgjeruar më shpejt sesa kredia, dhe kjo ecuri ka rezultuar në ngushtimin me rreth 50 miliardë lekë, ose me mbi 20% të hendekut depozita-kredi për këtë periudhë. Gjatë vitit 2024, kjo prirje u zëvendësua nga një rritje e fortë e kredisë - e shoqëruar me nivele pothuajse të pandryshuara në depozitat afatshkurtra të bizneseve - e cila rezultoi në një rikthim të hendekut në vlerat e viteve 2018-2019. Megjithatë, për shkak të rritjes relative mesatare më të shpejtë të depozitave në krahasim me kredinë, raporti kredi/depozita për bizneset ka ardhur në rënie të vazhdueshme dhe, në fund të vitit 2024, ai shënoi 1.7 herë, nga 2.3 herë në fund të vitit 2017. Në pretendimet e bizneseve ndaj sektorit bankar dhe sistemit financiar në përgjithësi, krahas depozitave, përfshihen edhe tregues të tjerë si: kapitali i investuar nga bizneset në subjektet financiare, pretendimet në formën e borxhit të varur të emtuar nga bankat dhe pjesëmarrja në sipërmarrjet e investimeve kolektive. Nga ana tjetër, detyrimet e bizneseve ndaj subjekteve financiare janë të përafërta në vlerë me kredinë e përfutur, pasi vlera e detyrimeve të tjera të ndryshme nga kredia është e papërfillshme. Për këtë arsye, pozicioni neto i sektorit të bizneseve në raport me sektorin financiar, ose diferenca midis mjeteve dhe detyrimeve, është shumë e vogël, dhe ka ardhur duke u ngushtuar gjatë viteve 2017-2023. Kjo do të thotë që, në tërësi, varësia e bizneseve vendase ndaj sektorit financiar është e kufizuar dhe ka ardhur në rënie. Pavarësisht këtij konstatimi, duhet mbajtur në vëmendje fakti që të dhënat e agreguara apo ato mesatare mbulojnë të gjitha ndërmarrjet dhe të gjitha subjektet financiare vendase, dhe nuk e përjashtojnë mundësinë që ekspozimi i bizneseve apo sektorëve të caktuar ndaj sistemit financiar apo segmenteve të caktuara të tij të jetë i ndjeshëm.

Grafik 12. Rritja e kredisë së bizneseve sipas qëllimit (kontribut, p.p.)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 13. Rritja e kredisë së bizneseve sipas sektorëve (kontribut, p.p.)




Kredia bankare për bizneset rezidente u zgjerua me rreth 12% gjatë vitit 2024 dhe me 5% gjatë periudhës, ku si kredia në Lekë ashtu edhe ajo në valutë dhanë kontribut pozitiv. Portofoli i kredisë për bizneset në Lekë u zgjerua me 9% në krahasim me një vit më parë, ndërsa kredia në valutë u rrit me 14% (në valutën origjinale kjo rritje ishte 20%). Rritja e kredisë sipas sektorëve të prodhimit ka pasur një bazë të gjerë dhe është shpërndarë në pothuajse të gjithë sektorët kryesorë si ai i energjisë, gazit dhe avullit, sektori i tregtisë, sektori i akomodimit, sektori i ndërtimit etj. Stoku i kredive të biznesit, të klasifikuara sipas qëllimit të përdorimit, dominohet nga kreditë për blerje pasurish të paluajtshme dhe nga kreditë kufi – me peshat përkatëse 40% dhe 22% - ndërkohë që kredia për blerje pajisjesh dhe ajo për kapital qarkullues zënë përkatësisht 19% dhe 17%. Kontributin kryesor në rritjen e kredisë për bizneset gjatë vitit 2024 e ka dhënë zgjerimi i stokut të kredisë për pasuri të paluajtshme në Lek dhe në Euro.

Grafik 14. Normat e interesit për kredinë e re në Lek dhe në Euro, pa përfshirë kredinë - kufi



Grafik 15. Normat e interesit për kredinë e re për bizneset



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ekspozimi i përgjithshëm i sektorit të biznesit ndaj sektorit bankar, në terma të numrit të bizneseve kredimarrëse dhe të madhësisë së kredisë për biznes, ka mbetur pothuajse i pandryshuar gjatë viteve të fundit. Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë për kredinë bankare për bizneset dhe të INSTAT-it për numrin e bizneseve të regjistruara në vend deri në fund të vitit 2023, raporti i bizneseve me kredi bankare ndaj bizneseve gjithsej është ulatur rreth një mesatareje prej 20%, pa shënuar ndryshime të ndjeshme gjatë periudhës 2016-2023. Po kështu, numri i bizneseve kredimarrëse në banka ka qenë i qëndrueshëm rreth një mesatareje prej 27 mijë, ndërkohë që madhësia mesatare e kredisë për bizneset që kanë kredi ka shfaqur një rritje të lehtë gjatë viteve 2020-2023.

Gjatë periudhës, norma mesatare e interesit të kredisë së re për sektorin e bizneseve ka rënë për Lekun dhe për Euron. Në fund të vitit, norma e ponderuar e interesit për të gjitha kreditë e reja ishte rreth 6.1% nga 6.5% një vit më parë. Për Lekun, norma mesatare e interesit të kredive të reja ishte 6.2%, nga 6.4% një vit më parë. Për Euron, ajo ishte 5.3%, krahasuar me 6.5% një vit më parë.

Sipas vërtimit me bankat¹⁰, kërkesa për kredi e bizneseve u rrit gjatë periudhës. Kërkesë e lartë për kredi u raportua si në terma të madhësisë së biznesit, ashtu edhe në terma të qëllimit të përdorimit të kredisë. Rritja e kërkesës për kredi u mbështet nga nevojat më të larta për financimin e inventarëve, të kapitalit qarkullues dhe të investimeve. Në gjykimin e bankave, situata dhe pritjet pozitive makroekonomike,

¹⁰ "Vërtimi i aktivitetit kreditues" i publikuar në: https://www.bankofalbania.org/Politika_Monetare/Vrojtimet/Vrojtimi_i_aktivitetit_kreditues/

niveli i përgjithshëm i normave të interesit dhe treguesi i besimit të biznesit mbështetën zgjerimin e kërkesës për kredi. Nga ana tjetër, përdorimi i burimeve të brendshme të financimit ndikoi në kahun rënës të kërkesës për kredi të bizneseve në tremujorin e fundit të viti. Kushtet dhe termat e përgjithshme të kreditimit mbetën të pandryshuara, ndërkohë që shkalla e miratimit të kredive për bizneset u rrit gjatë muajve të fundit të vitit. Faktorët që ndikuan në këtë drejtim ishin politikat e bankave lidhur me kolateralin, pasqyrat financiare të bizneseve, perceptimi më i ulët i rrezikut nga ana e bankave mbi të ardhmen e sektorit ku operojnë bizneset, si edhe elementet e lidhura me historikun e kreditit të bizneseve.

2.2 Përballueshmëria e borxhit dhe pritjet e bizneseve për të ardhmen

Performanca financiare e bizneseve ka qenë pozitive gjatë periudhës, ku shumica e bizneseve kanë operuar me fitim. Shitjet dhe rezultati financiar janë rritur krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës. Sfidat e veprimtarisë lidhen me kushtet e konkurrencës dhe gjetjes së tregut, kostot ende të larta të financimit dhe gjetjen e ruajtjen e personelit të nevojshëm.

Pesha e bizneseve huamarrëse nuk ka treguar ndryshim të rëndësishëm gjatë periudhës. Ngarkesa me borxh, në formën e raportit të huasë ndaj kapitalit, ka shënuar rritje gjatë periudhës, ndikuar nga treguesi për ndërmarrjet e mesme.

Pavarësisht rritjes së shpenzimit për pagesën e huasë, raporti i këtij shpenzimi ndaj të ardhurave vlerësohet në rënie për pjesën më të madhe të ndërmarrjeve, krahasuar me gjashtëmujorin e mëparshëm.

Bizneset presin që kërkesa e tyre për kredi të mbetet e pozitive dhe të tregojë rritje gjatë gjysmës së parë të vitit 2025.

Performanca financiare e bizneseve ka qenë pozitive gjatë periudhës. Sipas vërtetimit "Mbi gjendjen financiare dhe ngarkesën me borxh të ndërmarrjeve", rreth 93% e ndërmarrjeve të vrojtuar gjatë periudhës kanë operuar me fitim. Ecuria e shitjeve vlerësohet pozitive dhe në rritje krahasuar me periudhën e kaluar dhe me një vit më parë. Vlera më e lartë e indeksit është regjistruar në ndërmarrjet e mëdha dhe ato të sektorit të ndërtimit, ndërsa rritja e më e shpejtë e tij gjatë periudhës rezultoi në ndërmarrjet e mesme dhe ato të sektorit të shërbimeve. Për gjysmën e parë të vitit 2025, të tre grupet e ndërmarrjeve (të vogla, të mesme dhe të mëdha) presin rritje të mëtejshme të shitjeve dhe të rezultati financiar. Këto pritshmëri kanë rezultuar disi në rënie krahasuar me periudhën e kaluar, por mbi vlerat e një viti më parë, veçanërisht në grupin e ndërmarrjeve të mëdha. Sa iu përket sfidave të aktivitetit gjatë periudhës, ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme kanë cilësuar "konkurrencën" dhe "gjetjen e tregut", ndërsa ndërmarrjet e mëdha kanë veçuar "kostot e financimit" dhe "disponueshmërinë e stafit".

Pesha e ndërmarrjeve që kanë hua për të paguar nuk ka treguar ndryshim të rëndësishëm gjatë periudhës. Rreth 36% e ndërmarrjeve deklarojnë se kanë aktualisht hua për të paguar. Kjo peshë ka shënuar një rënie prej 1 p.p. krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, por është rritur me 0.3 p.p. krahasuar me një vit më parë. Rreth 84% e ndërmarrjeve e konsiderojnë të përshtatshëm nivelin e tyre të huamarrjes, por ndërmarrjet e vogla vijojnë të shfaqin kërkesë më të lartë për financim.

Raporti "hua/kapital" ka shënuar rritje për totalin e ndërmarrjeve të vrojtuar krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar. Rreth 79% e ndërmarrjeve raportojnë se vlera totale e huasë rezultoi afërsisht sa gjysma e kapitalit të ndërmarrjes, 14% deklarojnë se është pothuaj e njëjtë me vlerën e kapitalit dhe prej 7% deklarojnë që kjo vlerë e tejkalon atë të kapitalit, çka rezultoi në një raport mesatar "hua/kapital" prej 88%. Ky raport është rritur krahasuar me periudhën paraardhëse, veçanërisht në rastin e ndërmarrjeve të mesme, ku rreth 30% e tyre shprehën se huaja është e barabartë ose tejkalon vlerën e kapitalit. Në nivel sektorial, ngarkesa me borxh ka shënuar rritje krahasuar me periudhën e kaluar në rastin e sektorëve të industrisë dhe shërbimeve, dhe rënie në rastin e sektorëve të ndërtimit dhe tregtisë. Sektori i shërbimeve vijon të mbetet sektori me vlerën më të lartë të huasë ndaj kapitalit, ku rreth 28% e


ndërmarrjeve kanë deklaruar se kjo vlerë është e barabartë ose tejkalon vlerën e kapitalit.

Tabelë 3. Pesha e ndërmarrjeve me një vlerë huaje të barabartë ose më të lartë se kapitali

Pesha e ndërmarrjeve me një vlerë huaje të barabartë ose më të lartë se kapitali, sipas sektorëve				
	Industri	Shërbime	Ndërtim	Tregti
6MII 2022	22%	29%	26%	25%
6MI 2023	10%	20%	24%	18%
6MII 2023	15%	15%	18%	15%
6MI 2024	20%	22%	18%	18%
6MII 2024	23%	28%	17%	17%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 16. Ndërmarrjet që deklarojnë ndryshim të pagesës së huasë gjatë periudhës



Në tërësi, bizneset raportojnë për një rritje të pagesës së huasë gjatë periudhës, por raporti i këtij shpenzimi ndaj të ardhurave mbetet i kontrolluar. Rreth 77% e ndërmarrjeve raportojnë se pagesa e huasë nuk ka ndryshuar gjatë periudhës, por kjo peshë ka rënë në terma gjashtëmujorë dhe në terma vjetorë. Përgjigjet e pjesës tjetër rezultojnë në balancë neto pozitiv, por në rritje, gjë që tregon në agregat rritje të këtij shpenzimi gjatë gjysmës së dytë të vitit. Ky rezultat është konstatuar te të tria grupet e ndërmarrjeve, por shfaqet më i theksuar tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Kostoja e shërbimit të huasë arrin në 20% të të ardhurave për 74% të ndërmarrjeve, dhe në 20%-50% të të ardhurave për 21% të tyre. Huaja me koston më të lartë në terma të të ardhurave vlerësohet tek ndërmarrjet e mëdha, 28% e të cilave deklarojnë se shërbimi i huasë tejkalon 20% të të ardhurave të tyre. Rreth 85% e ndërmarrjeve nuk presin ndryshim të koston së huasë në gjysmën parë të vitit 2025, 12% presin rritje të mëtejshme dhe 2% presin që kjo kosto të bjerë. Pritjet për rritje kanë rezultuar më të larta për ndërmarrjet e vogla, ndërkohë që te ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha, ato paraqiten në rënie.

Lidhur me planifikimin për huamarrje në gjashtëmujorin e ardhshëm, ndërmarrjet janë përgjigjur se kërkesa për kredi pritet pozitive dhe disi në rritje, krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar. Kështu, rreth 41% e tyre deklarojnë se “nuk ka asnjë mundësi” që të kërkojnë një kredi bankare gjatë periudhës së ardhshme, dhe kjo peshë ka rënë për grupin e ndërmarrjeve të vogla, është rritur për ndërmarrjet e mëdha dhe ka mbetur e pandryshuar tek ato të mesme. Ndërkohë që pesha e atyre që pohojnë në shkallë të ndryshme sigurie (“ka pak mundësi”, “shumë mundësi” apo “është e sigurt”) që të kërkojnë një kredi gjatë gjysmës së parë të vitit 2025, ka shënuar rritje.

2.3 Pozicioni financiar i individëve

Sipas të dhënave të llogarive financiare për fundin e vitit 2023, sektori i individëve përfaqëson sektorin rezident më të rëndësishëm në financimin e korporatave financiare dhe bizneseve. Format kryesore të financimit ishin

Sektori i individëve rezidentë vijon të jetë financuesi kryesor i bizneseve dhe i institucioneve financiare nga sektorët rezidentë të ekonomisë dhe format më të rëndësishme të financimit janë kapitali i investuar në ndërmarrjet vendase dhe depozitat e vendosura në banka. Sipas të dhënave të llogarive financiare deri në fund të vitit 2023, mjetet financiare të individëve u shtuan me rreth 160 miliardë lekë gjatë vitit, duke arritur në 2,800 miliardë lekë. Në këtë shtesë kontribuuan rritja me rreth 85 miliardë lekë, në kapitalin e investuar nga individët në bizneset

përkatësisht ato të kapitalit të investuar në ndërmarrjet vendase dhe depozitat e vendosura në banka.

Pozicioni kreditor i individëve rezidentë ndaj sektorit bankar u zgjerua lehtë gjatë periudhës, për shkak të rritjes më të madhe të depozitave në krahasim me kreditë. Në terma relativë, rritja e kredisë ishte më e lartë se ajo e depozitave.

Kërkesa për kredi është drejtuar kryesisht për konsum dhe për blerje banesash. Ajo është mbështetur nga prirja rënëse e normave të interesit për kreditë e re dhe nga rritja e të ardhurave të familjeve.


Në përgjithësi, kushtet dhe termat e kredisë së bankave për individët kanë mbetur të qëndrueshëm. Midis bankave, drejtimit e ndryshimit të tyre kanë qenë të ndryshme. Për pjesën e parë të vitit 2025, kërkesa për kredi nga individët pritet të mbetet e qëndrueshme, dhe të orientohet përsëri drejt konsumit dhe blerjes së banesave.

vendase dhe ajo prej rreth 40 miliardë lekësh në stokun e depozitave. Detyrimet e sektorit të individëve në fund të vitit 2023 shënonin rreth 400 miliardë lekë dhe pothuajse të gjitha ato lidheshin me kreditë e marrë në institucionet financiare. Rritja më e shpejtë e mjeteve financiare të individëve në krahasim me rritjen e detyrimeve të tyre ka bërë që pozicioni neto kreditor i individëve të zgjerohet vazhdimisht, veçanërisht midis viteve 2020 – 2023. Për vitin 2023, ky pozicion ishte pothuajse i barabartë me vlerën e PBB-së vjetore.


Gjatë vitit 2024, pozicioni neto kreditor i individëve ndaj sektorit bankar u zgjerua ndjeshëm me rreth 40 miliardë lekë dhe pothuaj e gjithë rritja është regjistruar gjatë gjysmës së dytë të vitit. Kjo ecuri është përcaktuar nga një zgjerim i konsiderueshëm prej rreth 75 miliardë lekësh në depozitat e individëve, ndërkohë që kredia për individët nga bankat u rrit me rreth 40 miliardë lekë. Në terma relativë, kredia për individët është zgjeruar më shpejt sesa depozitat e individëve, si në terma gjashtëmujorë, ashtu edhe në krahasim me një vit më parë. Gjatë vitit 2024, kursimet e individëve në formën e depozitave bankare u rritën me 6% ndaj një viti më parë, ndërkohë që ndryshimi vjetor në stokun e kredisë ishte 14%. Për gjashtëmujorin e dytë të vitit, këto ndryshime ishin përkatësisht 4% dhe 6%.

Gjatë periudhës, depozitat e individëve në banka, si forma kryesore e investimit të tyre, u rriten me rreth 52 miliardë lekë. Investimet e individëve në titujt e qeverisë, në formën e bonove të thesarit, kanë shënuar rënie krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2024, ndërkohë që investimet në obligacione qeveritare janë zgjeruar. Edhe investimet në fondet private të investimit dhe të pensioneve regjistruan rritje, duke ndikuar në rritjen e mjeteve financiare të sektorit të individëve.

Grafik 17. Pozicioni neto i individëve rezidentë sipas sektorëve




Grafik 18. Kursimet e individëve rezidentë sipas instrumenteve (mld lekë)




Kredia për individët, është zgjeruar gjatë vitit 2024 me ritme të shpejta. Kontributin kryesor në zgjerimin e stokut të kredisë për individët ka vijuar ta japë kredia për blerjen e banesave, e cila u rrit me 13% në terma vjetorë dhe me 6% gjatë gjysmës së dytë të vitit. Edhe kredia për mallra jo të qëndrueshme, që zë rreth 16% të kredisë për individët, shënoi një rritje të fortë prej 18% në terma vjetorë. Struktura e portofolit të kredisë për individët rezidentë nuk ka shënuar ndryshime të rëndësishme gjatë viteve të fundit; peshën kryesore, ose rreth 2/3 e këtij portofoli vijojnë ta zënë kreditë për blerje banese, të ndjekura nga kreditë për mallra jo të qëndrueshme dhe ato për mallra të qëndrueshme. Për shkak të prirjeve të vërejtura në tregun valutor dhe duke qenë se pjesa më e madhe e huamarrësve në sektorin e individëve kanë të ardhura në Lek, portofoli i kredisë për blerjen e banese në monedhën Euro ka shfaqur ngadalësim të ritmit të rritjes dhe madje tkurrje të tij gjatë mesit të vitit 2024. Në të njëjtën kohë, kredia për banesa dhe për konsum në monedhën vendase është karakterizuar nga norma të larta të rritjes vjetore gjatë gjithë vitit. Rritja në stokun e kredive për konsum lidhet me rritjen e fortë të kredisë për mallra jo të qëndrueshme, ku përfshihen kryesisht kreditë për shërbime dhe mallra që konsumohen për një periudhë më të shkurtër se një vit. Kredia për mallra të qëndrueshme përfaqëson rreth 10% të kredisë së përgjithshme për individët rezidentë dhe në fund të vitit, ajo ishte rreth 30% më e lartë në krahasim me nivelin e regjistruar një vit më parë.

Në fund të vitit 2024, norma e ponderuar e interesit për kredinë e re për individët¹¹ rezultoi 7.3%, duke qenë më e ulët në krahasim me gjashtë muaj dhe një vit më parë. Gjatë periudhës, norma e interesit ka qëndruar mbi nivelin 8%, ndërkohë që normat mesatare të periudhës për monedhat Lek dhe Euro ishin përkatësisht 8.4% dhe 7.0%. Në muajin dhjetor, këto norma regjistruan një rënie të ndjeshme, nën ndikimin e ecurisë së normave të kredisë afatshkurtër për konsum. Norma mesatare e interesit për kredinë për blerje banese në monedhën Lek ka rënë lehtë gjatë vitit 2024, duke zbritur nën nivelin 4% në fund të vitit. Norma mesatare e interesit për kreditë e reja në monedhën Euro është luhatur rreth një vlere mesatare prej 5.5%. Normat më të larta të interesit, individët vijojnë t'i paguajnë për kreditë kufi në monedhën vendase.

Grafik 19. Rritja vjetore e kredisë për individët, kontribut në p.p.



Grafik 20. Rritja vjetore e kredisë për konsum dhe për pasuri të paluajtshme (PP) për individët




Fundi i periudhës u karakterizua nga një rritje e dukshme e kërkesës për kredi nga individët, kryesisht për të financuar konsumin dhe blerjen e banesave. Bankat vlerësojnë se faktori kryesor që ka ndikuar në

¹¹ Duke përfshirë kredinë - kufi dhe kartat e kreditit.

forcimin e kërkesës ishte ecuria në rënie e normave të interesit, por edhe ecuria e të ardhurave të familjeve. Kjo kërkesë e shtuar nga ana e individëve është shoqëruar me një ulje të normës së refuzimit nga ana e bankave, të mbështetur në historikun e kreditit dhe të ardhurat e disponueshme nga ana e individëve. Në tremujorin e parë të vitit 2025, bankat presin që kërkesa për kredi të mbetet e lartë, dhe të jetë e orientuar përsëri drejt konsumit dhe blerjes së banesave.


Në përgjithësi, bankat nuk kanë raportuar ndryshime të ndjeshme në kushtet dhe termat e përgjithshëm të kredisë për individët. Banka të ndryshme mund t'i kenë ndryshuar këto kushte në drejtime të ndryshme. Megjithatë, bankat që i kanë shtrënguar kushtet, e kanë realizuar këtë duke shtuar kërkesat për miratimin e kredive dhe duke forcuar kërkesat për monitorimin e kredive specifike. Disa banka kanë aplikuar marzhe më të larta për kreditë me rrezik. Faktorët që ndikuan në shtrëngimin e kushteve e termave të kreditimit ishin toleranca më e ulët ndaj rrezikut, kostot dhe kufizimet më të larta nga bilanci, si edhe perceptimi i rrezikut. Konkurrenca e shtuar në sistemin bankar pati ndikim lehtësues te kushtet dhe termat e kreditimit për individët.

Grafik 21. Ecuria e kërkesës së individëve për kredi



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 22. Normat e interesit për kredinë e re për individë



2.4 Përballueshmëria e borxhit dhe pritjet e individëve për të ardhmen

Rezultatet e vërtetimit të Bankës së Shqipërisë tregojnë se pesha e familjeve huamarrëse ka rënë.

Aftësia paguese e familjeve vlerësohet se është përmirësuar në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Pritjet për aftësinë paguese në gjashtëmujorin e ardhshëm paraqiten disi më pesimiste.

Gjatë periudhës, pesha e familjeve huamarrëse ka rënë ndërsa aftësia e tyre paguese shfaqet e përmirësuar. Rezultatet e vërtetimit "Mbi gjendjen financiare dhe ngarkesën me borxh të familjeve"¹² për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2024, tregojnë që sipas deklaratimit të familjeve të vrojtuar, rreth 18% e tyre kishin të paktën një hua për të paguar në momentin e intervistimit. Kjo peshë ka rënë me rreth 6 p.p. krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë, duke qëndruar nën mesataren historike të treguesit prej 27%. Rreth 84% e familjeve deklarojnë se pagesa e huasë zë "më pak se 30% të të ardhurave mujore"¹³ dhe ky tregues është rritur me 9 p.p. në terma gjashtëmujorë, dhe me 1 p.p. në terma vjetorë. Në të njëjtën kohë, pesha e familjeve për të cilat "pagesa e huasë" tejkalon 30% të

¹² Vërtetimi është gjashtëmujor dhe për 6MII 2024 është kryer mbi një kampion prej 1200 familjesh, ku shkalla e përgjigjes ka rezultuar 87%. Kampioni i familjeve përzgjidhet, intervistohet dhe rishikohet në mënyrë periodike nga Instituti i Statistikave, në bazë të regjistrave që përdoren nga agjencia për anketat pranë familjeve.


¹³ "deri në 10% të të ardhurave" për 27% të familjeve huamarrëse, "10-30% të të ardhurave" për 47% të familjeve, dhe "mbi 30% të të ardhurave" për 26% të familjeve.

Familjet presin që kërkesa e tyre për kredi të mbetet e qëndrueshme në pjesën e parë të vitit 2025.

“të ardhurave” ka shënuar rënie dhe kjo ecuri sugjeron për një zbutje të ngarkesës së huasë së familjeve gjatë periudhës.


Rreth 74% e familjeve huamarrëse kanë deklaruar se aftësia e tyre paguese “nuk ka ndryshuar” gjatë gjysmës së dytë të vitit 2024 dhe gjithashtu 67% nuk presin që të ndryshojë në gjysmën e parë të vitit 2025. *Indekset e aftësisë paguese* për gjashtëmuajorin e kaluar dhe për gjashtë muajt e ardhshëm, të cilat agregojnë përgjigjet e familjeve që presin të kenë ndryshime në aftësinë e tyre paguese, tregojnë për përmirësim të këtij treguesi në periudhën e vrojtuar, dhe shfaqin pritje disi më pesimiste për periudhën e ardhme.

Grafik 23. Indekset e aftësisë paguese për 6 muajt e kaluar dhe 6 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 24. Indeksi i planifikimit të huamarrjes dhe shpërndarja e familjeve që planifikojnë hua të re



Familjet presin një qëndrueshmëri të kërkesës për kredi në gjashtë muajt e ardhshëm. Rreth 59% e atyre që janë përgjigjur kanë deklaruar se “nuk presin të marrin hua të re në 6 muajt e ardhshëm”. Peshat e atyre që deklarojnë se e konsiderojnë në shkallë të ndryshme sigurie¹⁴ mundësinë për të marrë/rimarrë një hua të re, ka shënuar një rritje me 1 p.p. krahasuar me gjashtëmuajorin e kaluar, dhe rënie me 1 p.p. krahasuar me një vit më parë. Rritja modeste e vlerës së *indeksit të planifikimit të huamarrjes* sugjeron për një qëndrueshmëri të kërkesës së individëve për kredi në gjysmën e parë të vitit 2025.

3. Tregjet dhe sistemet e pagesave

3.1 Tregjet e letrave me vlerë

Në tregun parësor të titujve të borxhit të qeverisë, vëllimi i emetimeve shënoi rënie me rreth 43%, ndikuar nga emetimet më të ulëta për titujt afatshkurtë dhe ata afatgjatë.

Në tregun parësor të titujve të borxhit të qeverisë, normat e interesit shënuan rënie pavarësisht volumeve më të vogla të emetimit. Gjatë periudhës, u emetuan rreth 140 miliardë lekë borxh nga ana e qeverisë, dhe i gjithë emetimi ishte në monedhën vendase. Vlera e emetimeve të periudhës ishte rreth 43% më pak në krahasim me vëllimin e emetuar në gjashtëmuajorin e parë të vitit dhe 13% më pak në krahasim me vëllimin e regjistruar gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023. Norma mesatare e

¹⁴ Alternativat e dhëna janë: “ka pak mundësi”, “ka shumë mundësi” dhe “është e sigurt”.

Pavarësisht rënies së volumeve të emetimeve, norma mesatare e ponderuar e interesit ra me 0.3pp, në nivelin 3.9%. Kjo rënie e yield-eve reflektoi edhe uljen e normës bazë të interesit në muajt korrik dhe nëntor.

Për titujt afatshkurtër, norma mesatare e interesit u ul me 0.5 p.p. në nivelin 3.0%, ndërsa për titujt afatgjatë ajo ra me 0.4 p.p. në 4.6%.

Në përgjithësi, oferta e investitorëve ka qenë më e lartë dhe e ka mbuluar më mirë nevojën e qeverisë për huamarrje. Preferenca e investitorëve ka qenë për titujt e borxhit afatgjatë.

Jorezidentët kanë rritur më tej kërkesën për titujt e borxhit të qeverisë në Lek. Në fund të periudhës, portofoli i tyre zinte 2% të titujve të borxhit të qeverisë në Lek.

ponderuar e interesit për të gjitha maturitetet e titujve të emetuar në Lek ra me 0.3 p.p. në nivelin 3.9%.


Më shumë se gjysma e vlerës së emetuar lidhet me titujt afatgjatë. Kjo është hera e parë që emetimi në tregun primar për tituj afatgjatë tejkaloi atë në tituj afatshkurtër, pavarësisht se pesha e emetimit të borxhit afatgjatë është rritur dukshëm gjatë dy viteve të fundit. Në emetimet e titujve afatgjatë, peshën kryesore e zënë obligacionet me maturim 2 dhe 5 vjet (secila me rreth 26%). Pesha e borxhit afatshkurtër të emetuar gjatë periudhës ishte sa 44% e emetimit dhe ky borxh mbizotërohet nga tituj 12-mujorë. Blerja e letrave me vlerë të Qeverisë Shqiptare në Lek nga subjekte jorezidente ka vijuar gjatë periudhës. Në fund të vitit 2024, portofoli i jorezidentëve në Lek ishte rreth 14 miliardë lekë ose sa rreth 2% e borxhit të përgjithshëm të qeverisë në formën e letrave me vlerë të emetuara në monedhën vendase.

Emetimet në tituj afatshkurtër ishin rreth 62 miliardë lekë ose 56% më pak në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Pothuaj e gjithë vlera e emetimit ishte në tituj me maturim 12-muj. Në krahasim me të njëjtin periudhë një vit më parë, vëllimi i emetuar në tituj afatshkurtër ishte 27% më i ulët. Gjatë periudhës u zhvillua vetëm një ankand për tituj me maturim 6-muj, por kërkesa për të ishte më e ulët nga oferta e shpallur, çka rezultoi në një emetim me vlerë mjaft të ulët. Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit nuk pati asnjë emetim në tituj me maturim 3 muaj.

Vëllimi i titujve afatgjatë të emetuar gjatë periudhës ishte rreth 78 miliardë lekë, ose 24% më pak në krahasim me gjashtëmujorin paraardhës, por në nivel të krahasueshëm me gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023. Me përjashtim të titujve me maturitet 10 dhe 15 vjet, për titujt e tjerë afatgjatë u regjistrua tkurrje e vëllimit të emetuar. Titujt me emetimin më të lartë gjatë periudhës ishin ato me maturim 2 vjet dhe 5 vjet, me nga rreth 20 miliardë lekë secila. Në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, vëllimi i obligacioneve 2-vjeçare u përgjysmua, ndërsa vëllimi i emetimit për obligacionet 5-vjeçare ra lehtë. Në krahasim me të njëjtin gjashtëmujor një vit më parë, vëllimet e emetimit 2 dhe 5 vjet u rritën me përkatësisht 5% dhe 15%. Vëllimi i emetuar i titujve me maturim 3 dhe 7 vjet ishte përkatësisht rreth 14 dhe 12 miliardë lekë, ose 8% dhe 20% më pak në krahasim me emetimin në gjashtëmujorin e kaluar, ndërkohë që në krahasim me vëllimin e emetuar në të njëjtin gjashtëmujor një vit më parë, ato ishin përkatësisht 2% dhe 31% më shumë. Vëllimi i titujve me maturim 10 vjet ishte rreth 8 miliardë lekë, ose 2% më shumë në krahasim me emetimin e gjashtëmujorit të kaluar, ndërsa në krahasim me vëllimin e emetuar një vit më parë, ky emetim u tkurr ndjeshëm (me 48%). Titujt me maturim 15 vjet zënë rreth 5% të vëllimit të borxhit afatgjatë dhe gjatë periudhës vëllimi i tyre u rrit me 8% në nivelin 4 miliardë lekë, ndërsa në krahasim me të njëjtin gjashtëmujor një vit më parë, vëllimi i tyre u dyfishua.

Grafik 25. Ecuria e normës mesatare të ponderuar të interesit të letrave me vlerë të borxhit (në %)

Grafik 26. Vëllimi dhe norma mesatare e peshuar e bonove të thesarit në tregun primar




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Norma mesatare e ponderuar e interesit për titujt afatshkurtër për gjashtëmujorin e dytë të vitit është ulur në 3.0%, nga niveli prej 3.5% në gjashtëmujorin e kaluar dhe 3.2% në të njëjtin gjashtëmujor një vit më parë. Për shkak të peshës mbizotëruese, ecuria e normës mesatare të interesit është përcaktuar nga norma e interesit për titujt me maturim 12-mujor. Kjo normë shënoi 3.2% në emetimin e parë në muajin korrik dhe ka ardhur në rënie graduale, duke regjistruar nivelin më të ulët në emetimin e fundit të vitit 2024, prej 2.7%. Normat e interesit në rënie kanë diktuar uljen e kërkesës së investitorëve për tituj borxhi me maturim afatshkurtër dhe nevojat e qeverisë për huamarrje janë përbushur në rreth 70% të rasteve.


Gjatë periudhës, norma mesatare e ponderuar e interesit për titujt afatgjatë ishte 4.6%, nga mesatarisht 5.1% dhe 5.2% në dy gjashtëmujorët e mëparshëm. Normat mesatare të interesit për titujt me maturim 2 dhe 10 vjet ranë me 0.5 p.p. në nivelet përkatëse prej 3.8% dhe 6.0%. Normat e ponderuara të interesit për titujt me maturim 3 dhe 7 vjet u ulën me 0.7 pp dhe 0.6 pp, në nivelet 4.0% dhe 5.2%. Norma e interesit për titujt me maturim 5 vjet ra me 0.8 p.p. në nivelin 4.6%. Norma mesatare e interesit për titujt me maturim 15 vjet shënoi rënien më të madhe me 1.0 p.p. në nivelin 6.7%, nga niveli prej 7.7% në dy gjashtëmujorët e kaluar. Kërkesa e pjesëmarrësve për tituj afatgjatë në tregun primar ka qenë e lartë dhe ka plotësuar nevojat e qeverisë për huamarrje, duke përbushur ofertën e saj në rreth 85% të rasteve.

Grafik 27. Vëllimi dhe norma mesatare e peshuar e obligacioneve në tregun primar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 28. Nivelet e yield-it fiks



Vëllimet e tregtimit në tregun dytësor të titujve mbeten të ulëta dhe mbizotërohen nga titujt e Qeverisë Shqiptare. Transaksionet e titujve mes bankave për portofolin e tyre, ku përfshihen edhe transaksionet mes bankave për klientët e tyre, mbeten mbizotëruese. Gjatë periudhës, vëllimi i tyre u tkurr rreth 5 dhe 3 herë në krahasim me përkatësisht gjashtëmujorin dhe vitin e kaluar. Ulja e vëllimit të transaksioneve u reflektua në rënien e peshës së tregut ndërbankar në 49% të vëllimit të transaksioneve të përgjithshme në tregun sekondar të titujve, nga rreth 75% që zinte në dy gjashtëmujorët e mëparshëm.

Vëllimi i regjistruar i transaksioneve të shitjes dhe blerjes në *tregun dytësor me pakicë* të titujve të qeverisë ishte rreth 5.0 miliardë lekë ose 35% më pak në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, por në krahasim me të njëjtin gjashtëmujor një vit më parë, ishte rreth 29% më shumë. Vëllimet e tregtimit për periudhën u dominuan në masën 60% nga transaksione në instrumente afatgjata (obligacione) dhe 40% nga transaksionet në instrumentet afatshkurtra (bono thesari). Tregtimi në *Bursën Shqiptare të Titujve*, ALSE, mbetet i ulët, me rreth 0.5 miliardë lekë në transaksione të kryera gjatë periudhës, duke u rritur me 5% gjatë periudhës, por duke mbetur rreth 6% më pak se një vit më parë. Titujt e borxhit të qeverisë mbizotëruan në volumet e tregtimit, ndërsa tregtimi i obligacioneve private ishte vetëm 0.01 miliardë lekë. Me qëllim zhvillimit të tregut të kapitaleve, prej disa vitesh funksionon modeli i zhvilluesve të tregut (*market-makers*), të cilët ofrojnë kuotime ditore të titujve referencë (*benchmark*) me maturitet 3- dhe 5-vjeçar. Kuotimi me bazë ditore i titujve referencë mundëson llogaritjen e kurbës së *yield*-it që shërben si referencë për titujt e tjerë të borxhit në treg dhe mundëson llogaritjen e çmimit të tyre.

Kurba e yield-it për titujt referencë paraqitet me pjerrësi normale (me *yield-e* më të ulëta për titujt më afatshkurtër dhe më të larta për titujt më afatgjatë). Në krahasim me gjashtëmujorët e kaluar, kurba është zhvendosur për poshtë, si reflektim i uljes së normave të kthimit për të gjitha maturitetet.

3.2 Tregu ndërbankar i financimit

Gjatë periudhës, vëllimi i transaksioneve të financimit në tregun ndërbankar shënoi rënie. Kjo ecuri u diktua nga tkurrja e vëllimit të transaksioneve 1-javore që mbizotërojnë në vëllimet e transaksioneve në këtë treg.

Interesat e aplikuara nga bankat për transaksionet e financimit në tregun ndërbankar, gjithashtu kanë rënë, duke ndjekur uljen e normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë.

Gjatë periudhës, Banka e Shqipërisë ka injektuar rregullisht likuiditet në treg, nëpërmjet instrumentit kryesor të marrëveshjeve të riblerjes me maturim 1-javor.


Tregu ndërbankar ka regjistruar tkurrje të vëllimit të transaksioneve dhe ulje të normave mesatare të interesit, të cilat janë të ankoruara pranë normës bazë të interesit. Vëllimi i transaksioneve ra me 32% në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, por ishte 11% më i lartë në krahasim me të njëjtin gjashtëmujor një vit më parë. Normat e interesit në tregun ndërbankar vijnë të luhaten pranë nivelit të normës bazë të interesit. Gjatë gjysmës së dytë të vitit, Banka e Shqipërisë ka ulur 2 herë normën bazë të interesit¹⁵, çka u reflektua në norma më të ulëta ndërbankare në krahasim me dy gjashtëmujorët e kaluar.

Ulja e vëllimit të transaksioneve ndërbankare lidhet me tkurrjen me rreth 44% në transaksionet 1-javore, të cilat përbëjnë rreth 70% të vëllimit të huamarrjes ndërbankare. Gjatë periudhës, transaksionet 1-javore shënuan rreth 530 miliardë lekë, por vëllimi i tyre ishte i krahasueshëm me një vit më parë. Transaksionet 1-ditore të kryera gjatë këtij gjashtëmujori ishin 150 miliardë lekë dhe zinin rreth 20% të volumit të përgjithshëm të transaksioneve të kryera gjatë periudhës. Transaksionet 1-ditore regjistruan rritje

¹⁵ Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2024, norma bazë e interesit u ul në muajt korrik dhe nëntor me nga 25 pikë bazë (0.25 pikë përqindjeje).


me 40% në krahasim me gjashtëmuorin e kaluar dhe 46% në krahasim me një vit më parë. Gjatë periudhës janë regjistruar transaksione 3-mujore, të cilat ishin sa 6% e volumit të përgjithshëm të transaksioneve si dhe transaksione 2-ditore/javore, të cilat zënë rreth 1.0% të transaksioneve ndërbankare. Gjatë gjysmës së dytë të vitit, Banka e Shqipërisë ka vijuar të kryejë operacione të rregullta, duke injektuar likuiditet përmes marrëveshjes së anasjelltë të riblerjes me afat njëjavor, e cila përfaqëson instrumentin e saj kryesor.

Grafik 29. Vëllimi i transaksioneve dhe normat e interesit në tregun ndërbankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 30. Kursi i këmbimit në tregun e brendshëm valutë



3.3 Tregu i këmbimit të monedhës

Kursi i këmbimit të Lekut ka vijuar të mbiçmohet ndaj valutave kryesore, por në masë dhe shpejtësi më të ulët.

Banka e Shqipërisë ka zhvilluar ankandet e planifikuara për blerjen e Euros, duke i shërbyer objektivit për rritjen e rezervës valutore dhe duke kontribuar në qëndrueshmërinë e kursit të këmbimit.

Gjatë periudhës, Leku u mbiçmua kundrejt valutave kryesore, por masa dhe shpejtësia e mbiçmimit ishte më e ulët. Mbiçmimi i Lekut ishte me i dukshëm në muajt që pasuan sezonin veror, në vijim të flukseve të rritura valutore prej turizmit. Në muajin nëntor, kursi mesatar i këmbimit të Euros shënoi nivelin më të ulët historik prej 98.2 lekësh. Në fund të periudhës, Leku ishte mbiçmuar me rreth 4% ndaj Euros në terma vjetorë, kundrejt 6% dhe 11% përkatësisht gjashtë muaj dhe një vit më parë.

Ecuri të ngjashme me Euron ka regjistruar dhe dollari amerikan. Në muajin shtator një dollar kembehej mesatarisht me 89.4 lek, i cili ishte niveli mesatar më i ulët në 15 vjetet e fundit. Drejt fundit të vitit, ne vijim të zhvillimeve politike në SHBA, dollari amerikan u forcua gradualisht derisa në muajin dhjetor u kuotua me mesatarisht 93.9 lekë. Banka e Shqipërisë ka vijuar të kryejë ndërhyrje në tregun valutë përmes ankandëve për blerjen e valutës, me objektiv rritjen e rezervës valutore dhe për të zbutur ritmin e mbiçmimit të monedhës vendase.

3.4 Tregu i pasurive të paluajtshme

Sipas vërtimit të posaçëm të Bankës së Shqipërisë, kërkesa e përgjithshme për blerje në tregun e pasurive të paluajtshme rezidenciale gjatë periudhës ka qenë e qëndrueshme, ndërkohë që

Analiza e zhvillimeve në tregun e pasurive të paluajtshme (rezidenciale) kryhet mbi bazën e të dhënave të vërtimit për gjendjen e tregut të pasurive të paluajtshme dhe ecurinë e çmimit të banesave, të dhënave të raportuara nga bankat dhe të dhënave të tjera administrative.

Tregu i pasurive të paluajtshme rezidenciale ka vijuar të përballë me një kërkesë të qëndrueshme. Sipas vërtimit, agjentët e tregtimit të

kërkesa nga jorezidentët ka rënë lehtë.

Numri i pronave të pashitura ka vijuar të bjerë për disa gjashtëmujorë radhazi dhe koha mesatare e shitjes është shkurtuar lehtë për shkak të rënies së kohës së shitjes për pronat e shitura në kryeqytet.

Rritja e kredisë bankare për blerje dhe zhvillim pasurish të paluajtshme ka mbështetur qëndrueshmërinë e kërkesës. Bankat kanë shtrënguar disi standardet për këtë lloj kredie dhënë individëve.

Në tërësi, rritja e ofertës së njësive të banimit, sipas numrit të lejeve të ndërtimit, ishte më e ulët në krahasim me një vit më parë, por sipërfaqet për ndërtimet e reja paraqiten më të mëdha. Peshë e kredisë bankare për ndërtim nuk ka shënuar ndryshime gjatë periudhës. Kostot e ndërtimit janë rritur, kryesisht për shkak të rritjes në shpenzimet për paga, energji dhe transport.

Vrojtimi tregon se Indeksi Fischer i çmimit të banesave në rang vendi u rrit me 23.6% në terma gjashtëmujorë, dhe me 44.5% ndaj një viti më parë. Rritja e vlerës së indeksit për Tiranën ishte gjithashtu e fortë. Edhe çmimet e qirasë janë rritur.

Agjentët ruajnë një vlerësim pozitiv në lidhje me ecurinë

pasurive të paluajtshme raportojnë për ecuri të mirë të vëllimit të shitjeve dhe rënie të numrit të pronave të pashitura. Po ashtu, bankat raportojnë¹⁶ se kërkesa e individëve për kredi për financimin e blerjes së banesave është paraqitur në rritje gjatë periudhës. Kërkesa nga jorezidentët mbetet e pranishme, por ka shënuar një rënie relative në raport me kërkesën e përgjithshme, duke qenë se pronat e shitura tek jorezidentët zinin më pak se 20% të shitjeve të përgjithshme nga një nivel prej 26%-27% në dy gjashtëmujorët e mëparshëm.

Sektori bankar ka vijuar të mbështesë me kredi blerjen e pasurive të paluajtshme rezidenciale nga individët dhe bizneset.

Në fund të vitit 2024, teprica e kredisë për këtë segment ishte 210 miliardë lekë, duke u rritur me 6% gjatë periudhës dhe me 13% kundrejt një viti më parë. Kushtet dhe termat e kreditimit të bankave për blerjen e banesave shfaqën një shtrëngim të lehtë në formën e shtimit të kërkesave për miratimin e kredisë. Cilësia e kredisë së marrë për këtë qëllim mbetet e mirë, dhe raporti i kredive me probleme u ul në 1.6%, nga rreth 1.7% dhe 2% një gjashtëmujor dhe një vit më parë. Në fund të periudhës, stoku i të gjitha kredive të kolateralizuara me pasuri të paluajtshme ishte 390 miliardë lekë ose rreth 8% më i lartë në krahasim me nivelin e raportuar gjashtë muaj më parë. Rreth 50% e kredisë së kolateralizuar me pasuri të paluajtshme mbahet nga sektori i individëve. Stoku i kredisë për pasuri të paluajtshme dhënë biznesit rezident arriti në 190 miliardë lekë në fund të periudhës, duke u rritur me 10% krahasuar me fundin e muajit qershor. Në ndryshim nga kredia për sektorin e individëve, 2/3 e së cilës përbëhet nga kredia në Lek, mbi 60% e kredisë së marrë nga bizneset për blerjen e pasurive të paluajtshme përfaqësohet nga kredia në monedhë të huaj (kryesisht në Euro).

Treguesit e ofertës për ndërtesa banimi, në formën e lejeve të ndërtimit të dhëna gjatë periudhës, tregojnë rënie të numrit të lejeve, por rritje të ndjeshme të sipërfaqes së ndërtimit.

Sipas të dhënave të INSTAT-it, numri i lejeve për ndërtesa banimi gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024 ishte 266, nga një mesatare tremujore prej 323 lejevsh e raportuar për vitin 2023. Megjithatë, lejet e ndërtimit tregojnë një rritje të ndjeshme të sipërfaqeve të reja të ndërtimit. Gjatë viteve të fundit vihet re një rritje e peshës së sipërfaqes së rezidencave të banimit me tre ose më shumë kate, në krahasim me sipërfaqen e përgjithshme të lejeve për ndërtesa për banim. Kostot e ndërtimit të matura nga Indeksi i Kushtimit në Ndërtim kanë shënuar rritje të lehtë. Ndryshimi vjetor në indeksin e përgjithshëm ishte 1.6% në tremujorin e tretë të 2024. Zërat me rritjen më të lartë ishin shpenzimet për paga (+3.2%), shpenzimet për transport (+3.1%), shpenzimet e energjisë (+2.9%) dhe kosto të tjera (+2%). Kredia për sektorin e ndërtimit u rrit me 3.7% gjatë gjashtëmujorit dhe 7.1% ndaj një viti më parë, duke arritur në 80 miliardë lekë në fund të vitit, por vërehet që peshë e kredisë për ndërtim ndaj tepricës së kredisë së bizneseve ka mbetur


¹⁶ Për më shumë detaje konsultoni dokumentin "Vrojtimi i Aktivitetit Kredites" në adresën https://www.bankofalbania.org/Politika_Monetare/Vrojtimet/Vrojtimi_i_aktivitetit_kredites/

e tregut të banesave në periudhën afatshkurtër, dhe mbeten optimistë për ecurinë e tij në një periudhë më afatgjatë.

thuaje e pandryshuar nga periudhat e mëparshme, duke zënë rreth 17% në fund të periudhës.


Agjentët e tregtimit të pasurive të paluajtshme dhe përfaqësuesit e kompanive të ndërtimit, kanë raportuar rritje të ndjeshme të çmimeve të shitjes së banesave gjatë periudhës. Mbi bazën e këtyre raportimeve, indeksi Fischer¹⁷ tregon që çmimi mesatar i banesave të shitura gjatë periudhës u rrit me 23.6% në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, dhe me 44.5% në krahasim me një vit më parë. Indeksi i çmimeve për shitjet në Tiranë u rrit me 26.2% ndaj periudhës paraardhëse dhe 56% ndaj nivelit të një viti më parë. Në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, dhe veçanërisht me një vit më parë, vihet re një rënie e peshës së transaksioneve për të cilat çmimi i blerjes së pronës ka qenë i njëjtë me çmimin e kërkuar nga shitësi, dhe rritje e peshës së transaksioneve të realizuara me një çmim deri në 5% më të ulët se çmimi i kërkuar nga shitësi.

Grafik 31. Indeksi Fischer i Çmimit të Banesave për Tiranën dhe për të gjithë territorin



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 32. Çmimi i transaksionit të shitjes në krahasim me çmimin e kërkuar



Çmimet e qirasë sipas agjentëve kanë shënuar rritje gjatë periudhës. Ky informacion mbi kërkesën dhe çmimet e qirasë vjen kryesisht nga agjentët që kryejnë aktivitet në zonën e kryeqytetit. Sipas tyre, kërkesa e përgjithshme për marrje me qira raportohet më e lartë nga kërkesa gjatë gjashtëmujorit të mëparshëm. Vlerësimet e subjekteve për gjendjen e tregut dhe çmimet në tregun e banesave mbeten përgjithësisht pozitive për afatin e shkurtër dhe afatin më të gjatë.

Hapësirë informuese 1. Përmbledhje e rezultateve të vërtimit “Tregu i pasurive të paluajtshme” dhe ecuria e indeksit të çmimit të banesave për 6M II-2024

Informacioni mbi ecurinë e çmimeve dhe vlerësimin e situatës nga ana e agjentëve në tregun e pasurive të paluajtshme merret nëpërmjet vërtimit në terren të një kampioni të përbërë nga 230 subjekte, që kanë si aktivitet kryesor tregtimin e pronave të paluajtshme. Subjektet e zgjedhura janë agjentë të zyrave të tregtimit të pasurive të paluajtshme dhe shoqëri ndërtimi shitjet e të cilave përfaqësojnë rreth 75%-80% të xhiros së të gjithë popullatës. Banka e Shqipërisë realizon hartimin e pyetësorit, si edhe hedhjen dhe përpunimin e rezultateve, ndërkohë që Instituti i Statistikave mbulon intervistimin në terren, proceset kryesore të kampionimit dhe kontrollin fizik të pyetësorëve të plotësuar. Krahas

¹⁷ Ky indeks ndërtohet mbi bazën e një vërtimi specifik. Analiza për këtë vërtim publikohet e plotë në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë (www.bankofalbania.org).

informacionit për ecurinë e Indeksit Fischer të çmimit të banesave të shitura në rang vendi, të përmendur më sipër në këtë raport, informacioni nga vrojtimi tregon që:

Vlerësimi i përgjithshëm i agjentëve për situatën e përgjithshme të tregut ishte disi më pozitiv në krahasim me periudhën e kaluar. Në përgjigje të pyetjes “Si e vlerësoni situatën e tregut në krahasim me periudhën (gjashtëmujorin) e mëparshme?”, balanca neto e përgjigjeve ishte pozitive për rreth 5%, me përgjigje veçanërisht optimiste për zonën e qyteteve bregdetare, ku vlera e balancës ishte dukshëm më pozitive sesa mesatarja afatgjatë. I njëjti tregues i vlerësuar vetëm për subjektet që kanë raportuar shitje rezultoi ndjeshëm më pozitiv gjatë periudhës, me një balancë neto rreth 17%.

Balanca e treguesit të numrit të banesave të reja të regjistruara nga agjentët ka rënë lehtë ndaj periudhës paraardhëse. Balanca neto e atyre që raportojnë rritje të numrit të banesave të regjistruara dhe atyre që raportojnë rënie të numrit të tyre ishte -5%. Nga ana tjetër, numri i pronave të pashitura, si për banesa, ashtu edhe për godinat tregtare, ka vijuar të shënojë rënie për disa gjashtëmujorë radhazi.

Koha mesatare e shitjes së banesave në rang vendi ra në 9.3 muaj nga 10.5 muaj në vrojtimin e mëparshëm. Në rastin e Tiranës, koha mesatare e shitjes u ul ndjeshëm në 7.1 nga 9.7 muaj. Koha mesatare për shitjet në zonat bregdetare u rrit, duke u kthyer në vlerat e një viti më parë, në 10 muaj, ndërsa për zonat e tjera, kohëzgjatja e shitjes ishte pak më e ulët sesa në gjashtëmujorin e kaluar, duke rënë në 11.6 nga 12.9 muaj.

Financimi nëpërmjet kredisë bankare ka vijuar të figurojë në një pjesë të mirë të shitjeve të pronave. Sipas agjentëve, ashtu si periudhën e kaluar, gjysma e pronave për banim dhe e atyre për përdorim tregtar të shitura prej tyre janë blerë me hua bankare. Nga këto, në 72% të rasteve, kredia ka mbuluar deri në 60% të vlerës.

Gjatë gjashtëmujorit të dytë të viti 2024, rreth 18% të banesave të shitura janë raportuar të blera nga shtetas jorezidentë. Nga këta, rreth 77% rezultojnë shtetas të vendeve të BE-së. Në tërësi, pesha e transaksioneve në të cilat blerësit janë jorezidentë ka shfaqur një prirje në rritje gjatë 5 viteve të fundit.

Pritjet për të ardhmen paraqiten pozitive. Agjentët kanë pritje pozitive për ecurinë e tregut në territorin ku ata veprojnë për të ardhmen afatshkurtër dhe për periudhën më të gjatë (deri në dy vjet).

3.5 Sistemet e pagesave

Infrastruktura bazë për klerimin dhe shlyerjen e pagesave në monedhë vendase dhe në Euro ka vijuar të funksionojë me siguri dhe efikasitet.


Gjatë periudhës është regjistruar rritje e vlerës dhe numrit të transaksioneve në sistemet e pagesave. Përdorimi i kartave për kryerjen e pagesave ka vijuar të rritet në mënyrë të ndjeshme dhe ato përfaqësojnë instrumentin më peshën kryesore në pagesat e kryera.

Numri dhe vlerat e transaksioneve në sistemet e pagesave të administruara nga Banka e Shqipërisë, kanë njohur rritje gjatë periudhës. Në terma të vëllimit të transaksioneve të përpunuara, në sistemin AIPS u kleruan gjatë periudhës rreth 88 mijë pagesa me një vlerë prej 5,800 miliardë lekësh. Këta tregues u rritën me përkatësisht 8% dhe 5% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në të njëjtën kohë, në sistemin e pagesave me vlerë të vogël AECH, gjatë periudhës janë kleruar rreth 880 mijë pagesa me një vlerë mesatare për transaksion prej rreth 137 mijë lekësh. Gjatë viteve të fundit është vënë re një rritje e vazhdueshme në numrin e transaksioneve dhe, nga ana tjetër, një rënie e vlerës mesatare për transaksion, çka tregon edhe një përdorim të shtuar të sistemit AECH nga publiku në tërësi. Krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, aktiviteti i sistemit AECH ka regjistruar rritje në numrin dhe në vlerën e transaksioneve, me përkatësisht 16.5% dhe 17.4%.

Aderimi i Shqipërisë në zonën SEPA më 21 nëntor 2024 shënon një hap shumë të rëndësishëm në drejtim të sigurisë dhe modernizimit të sistemit të pagesave, si edhe uljes së kostove për shtetasit dhe bizneset shqiptare në kryerjen e pagesave ndërkufitare në Euro.

Edhe në sistemin AIPS-EURO, klerimi dhe shlyerja e pagesave në Euro njohu rritje në numër dhe në vlerë. Gjatë periudhës, në këtë sistem janë shlyer 175 mijë pagesa me një vlerë prej 2,9 miliardë euro. Krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, këta tregues u rriten me përkatësisht 17% dhe 22%. Ky sistem ndihmon në ruajtjen e stabilitetit financiar dhe atij monetar, duke qenë një mekanizëm shtesë për Bankën e Shqipërisë në lidhje me monitorimin e segmentit të tregut të pagesave në monedhën Euro, që mbështet njëkohësisht formalizimin e mëtejshëm të ekonomisë.


Grafik 33. Ecuria e aktivitetit në AIPS dhe AECH në gjashtëmujorin e dytë të viteve 2023-2024




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kartat e debitit dhe të kreditit përfaqësojnë instrumentin kryesor për kryerjen e pagesave nga ana e klientëve të bankave dhe shkalla e përdorimit të tyre ka vijuar të zgjerohet me shpejtësi. Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2024 janë kryer rreth 25.8 milionë pagesa me një vlerë totale prej 3,400 miliardë lekësh, duke reflektuar një rritje të numrit të transaksioneve me 14%, si dhe një rritje në vlerë me 10% krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2024. Pagesat me karta u rriten me 27% në numër dhe me 17% në vlerë gjatë periudhës, dhe zunë 65% të numrit të transaksioneve gjatë periudhës, duke përfaqësuar kështu instrumentin kryesor të pagesave. Nga ana tjetër është vënë re një rritje e ndjeshme e numrit dhe vlerës së transfertave të kreditit në formë joleter (internet banking, mobile banking), përkatësisht me 23% dhe me 18% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Grafik 34. Ecuria e instrumenteve të pagesave në numër dhe në vlerë



Grafik 35. Ecuria e pagesave për klientë në sistemin AIPS - EURO



Gjatë periudhës, u finalizua aderimi i Shqipërisë në zonën SEPA (Single Euro Payments Area)¹⁸ si pjesë e grupit të parë të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ky shënon një hap cilësor drejt modernizimit të sistemit të pagesave. Përfitimet e Shqipërisë nga pjesëmarrja në SEPA, për qytetarët dhe ekonominë në tërësi, janë të shumëfishta, por më kryesoret janë ulja e ndjeshme e kostove financiare dhe e kohës së kryerjes së pagesave ndërkufitare në Euro, si edhe rritja e konkurrencës nëpërmjet zgjerimit të produkteve dhe shërbimeve të pagesave moderne dhe të sigurta. Ky anëtarësim nxit ndërveprimin tregtar dhe lëvizjen e flukseve monetare me Bashkimin Evropian dhe paralelisht nxit përfshirjen financiare në vend, redukton përdorimin e parasë fizike dhe nxit zhvillimin e teknologjisë financiare.


4. Sistemi financiar

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2024, pesha e aktiveve të sistemit financiar¹⁹ ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) u rrit me 3 p.p. në nivelin 93.2%. Në terma vjetorë, ky tregues ra me rreth 1 p.p. pasi norma vjetore e rritjes së bilancit të sistemit financiar ishte më e ulët në krahasim me atë të rritjes së PBB-së. Në këtë rënie, sektori bankar ka kontribuar me 1.2 p.p. Brenda sistemit financiar, sektori bankar vijon të mbizotërojë me gati 90% të totalit të aktiveve. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar mbetet i ulët dhe ka shënuar një rënie të lehtë për periudhën, ndërsa ndjeshmëria e sektorit jobankar ndaj veprimtarisë së sektorit bankar vijon të mbetet e lartë. Banka e Shqipërisë monitoron rregullisht treguesit e ndërlidhjes, në kuadër të vlerësimit periodik të rreziqeve sistemike.

Tabelë 4. Peshat e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së²⁰ në vite (në %)

Grafik 36. Peshat e segmenteve të sistemit financiar ndaj totalit të aktiveve të sistemit, dhjetor 2024

Autoriteti Licencues dhe Mbikëqyrës	Banka e Shqipërisë			Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare			Ndërmjetësimi financiar
	Spektori bankar	IFJB	SHKK dhe	Shoqëri sigurimi	Fonde pensioni	Fonde investimi	
2011	86.1	2.6	0.8	1.5	0.0		91.0
2012	89.1	2.7	0.8	1.6	0.0	1.2	95.4
2013	91.4	2.6	0.7	1.6	0.0	3.7	100.2
2014	92.7	2.8	0.8	1.8	0.0	4.6	102.7
2015	91.9	2.7	0.7	2.0	0.1	4.7	102.0
2016	95.5	2.8	0.6	2.0	0.1	4.5	105.5
2017	93.2	2.9	0.5	2.0	0.1	4.7	103.4
2018	88.8	3.2	0.6	1.9	0.1	4.2	98.8
2019	87.2	3.9	0.6	2.0	0.2	4.0	97.9
2020	97.8	4.2	0.7	2.4	0.2	4.2	107.5
2021	95.5	4.1	0.7	2.2	0.2	4.2	107.0
2022	87.8	3.8	0.7	2.0	0.3	1.9	96.5
2023	84.9	3.8	0.7	2.2	0.3	2.2	94.0
2024	83.7	3.6	0.7	2.2	0.5	2.5	93.2



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

4.1 Sektori bankar

4.1.1 Zhvillimet kryesore në sektorin bankar

¹⁸ SEPA përfaqëson zonën e përbashkët të pagesave në Euro të Bashkimit Evropian, e cila u mundëson individëve dhe bizneseve të bëjnë pagesa elektronike në këtë monedhë, në mënyrë të sigurt, të lehtë dhe efikase, duke ndjekur rregulla të njëjta ndërmjet vendeve anëtare.

¹⁹ Sistemi financiar përbëhet nga sektori bankar dhe sektori jobankar. Baza e të dhënave për të gjitha subjektet e sistemit financiar i përkasin tremujorit të katërt të vitit 2024, me përjashtim të shoqërive të sigurimit dhe PBB-së, të cilat i referohen tremujorit të tretë të vitit 2024.

²⁰ Peshat në tabelë janë llogaritur duke përdorur PBB-në nominale me çmime korrente sipas INSTAT-it.

Aktiviteti bankar u zgjerua gjatë periudhës me gati 5%, dhe në terma vjetorë me gati 7%. Kontributi pozitiv në këtë rritje erdhi nga investimet në tituj dhe kreditimi. Në krahun e pasivit, bankat raportuan rritje të depozitave dhe të kapitalit.

Efekti statistikor negativ i mbiçmimit të Lekut ndaj monedhave të huaja mbi treguesit e bilancit të sektorit bankar ishte më i zbutur në krahasim me gjashtëmujorët e mëparshëm.

Pesha e aktiveve dhe detyrimeve në valutë ndaj totalit të bilancit ka mbetur e pandryshuar në nivelin 50%.

Pozicioni neto kreditor ndaj jorezidentëve u rrit lehtë, duke arritur në 19% të aktiveve të sektorit bankar.


Gjatë periudhës, bilanci i sektorit bankar u zgjerua me rreth 5%, si pasojë e zgjerimit të investimeve në letra me vlerë dhe në kredi.

Në terma vjetorë, aktivet e sektorit bankar u zgjeruan me rreth 7%. Gjatë periudhës, vlera e raportuar e aktiveve u rrit me 92 miliardë lekë, duke arritur në rreth 2,090 miliardë lekë në fund të dhjetorit. Kontributin kryesor në rritjen e aktiveve e ka dhënë zgjerimi i investimeve në titujt e qeverisë dhe në stokun e kredisë me përkatësisht 60 dhe 40 miliardë lekë. Zëri i vetëm që regjistroi rënie gjatë periudhës ishte ai i veprimeve me thesarin dhe ndërbankare që u tkurr me 14 miliardë lekë, ose 3%, ndikuar nga rënia në zërin e thesarit "bono thesari" dhe rënia në aktivitetin ndërbankar në formën e depozitave në banka, institucione krediti dhe institucione të tjera financiare. Veprimet ndërbankare u tkurrën me 20 miliardë lekë, ose 11%, ndikuar nga rënia në nivelin e depozitave me bankat dhe institucionet e tjera financiare, kryesisht jorezidente. Shtimi i fondeve të provigjioneve të sektorit bankar i pakësoi aktivet me 1 miliardë lekë. Gjatë periudhës, efekti statistikor negativ i mbiçmimit të Lekut ndaj monedhave të huaja në treguesit e bilancit të sektorit bankar ishte më i zbutur.

Baza e gjerë e depozitave dhe niveli i konsiderueshëm i aktiveve likuideve bëjnë që rreziku i financimit të sektorit bankar të mbetet i ulët.


Në strukturën e detyrimeve, peshën kryesore e zënë llogaritë rrjedhëse të klientëve, depozitat me afat dhe kapitali. Pavarësisht peshës së ulët prej më pak se 1% në strukturën e detyrimeve të bankave, gjatë vitit të fundit është vënë re një rritje e konsiderueshme relative e zërit "borxhe të përfaqësuara me letra me vlerë", si pasojë e nevojës në rritje për të përmbushur kërkesat minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar – MREL. Ky zë u rrit në 9.5 miliardë lekë, nga 3 miliardë lekë i raportuar një vit më parë.

Grafik 37. Ecuria e aktivitet sipas përbërësve, kontribut në p.p.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 38. Ecuria e detyrimeve të bankave, sipas përbërësve në miliardë lekë




Pesha e aktiveve dhe detyrimeve në valutë ndaj totalit të bilancit, nuk ka ndryshuar gjatë periudhës.

Në fund të saj, aktivet dhe detyrimet e sektorit bankar në valutë zinin një peshë të barabartë prej 50% të totalit të bilancit. Në vlerë absolute, bankat raportuan nivele të përafërta të aktiveve dhe detyrimeve në

valutë, në vlerat 1,040 miliardë lekë dhe 1,020 miliardë lekë, duke paraqitur kështu një pozicion të ekuilibruar të aktivitetit në valutë të sektorit bankar. Nga ana e aktiveve në valutë, zërat me peshën më të madhe janë kreditimi, investimet e thesarit dhe ato ndërbankare, si edhe në tituj të borxhit. Nga ana e detyrimeve në valutë, struktura paraqitet më e qëndrueshme në vite dhe mbizotërohet nga depozitat në valutë. Zërat e mësipërm kanë përcaktuar, në masën më të madhe, ndjeshmërinë e sektorit bankar ndaj ndryshimeve në kursin e këmbimit.


Grafik 39. Struktura e aktiveve (majtas) dhe detyrimeve (djathtas) në valutë, dhjetor 2024



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Në terma vjetorë, aktivet dhe detyrimet në valutë u rritën me nga 4%, por të korigjuara për efektin e ndryshimit të kursit të këmbimit, këto norma rritjeje llogariten përkatësisht në 8% dhe 10%. Efekti statistikor i mbiçmimit të kursit të këmbimit të Lekut, në krahasim me një vit më parë, ishte negativ, dhe ky efekt e pakësoi me rreth 4 miliardë lekë vlerën e raportuar të bilancit valutor të sektorit bankar. Në krahasim me gjysmën e parë të vitit, efekti statistikor paraqitet dukshëm më i ulët. Në anën e aktivitetit, forcimi i monedhës vendase ka pasur ndikim pothuajse të njëjtë në zërat kryesorë të bilancit si veprimet me titujt, kreditë, veprimet me thesarin dhe ato ndërbankare (nga rreth 1 miliardë lekë). Në anën e pasivitetit, efekti total i kursit mbi vlerën e raportuar të zërave kryesorë të detyrimeve në valutë vlerësohet në nivelin 1 miliard lekë. Efekti pakësues statistikor i kursit të këmbimit është ndjerë edhe për pjesën në valutë të kapitalit të sektorit bankar, me një vlerë rreth 15 miliardë lekë.

Grafik 40. Detyrimet ndaj jorezidentëve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 41. Pozicioni neto me jorezidentët



Financimi i veprimtarisë së bankave ka vijuar të mbështetet në depozitat dhe fondet e veta, ndërkohë që pozicioni kreditor relativ ndaj jorezidentëve ka rënë lehtë. Depozitat dhe fondet e veta zënë 91% të totalit të pasivitetit dhe kjo strukturë ka qenë e qëndrueshme gjatë periudhës. Varësia ndaj burimeve të huaja të financimit mbetet e ulët, e megjithatë për periudhën shënoi rritje, si pasojë e rritjes së detyrimeve të bankave ndaj jorezidentëve. Rritja e detyrimeve ndaj jorezidentëve ka ardhur si rezultat i zgjerimit të

veprimeve ndërbankare në formën e huave të marra nga institucionet e tjera financiare jorezidente, zgjerimit të burimeve të përhershme në formën e kapitalit të paguar dhe borxhit të varur jorezident të bankave me maturitet mbi 5-vjet, si dhe rritjes së depozitave të subjekteve jorezidente në bankat vendase. Këta zëra përfaqësojnë përkatësisht 37%, 17% dhe 45% të detyrimeve të bankave ndaj jorezidentëve. Aktivitetet e vendosura pranë subjekteve jorezidente u zgjeruan, për shkak të rritjes së investimeve në letra me vlerë të emetuara nga jorezidentët. Në fund të periudhës, pretendimet ndaj jorezidentëve ishin sa 22% e totalit të aktiveve, ndërsa detyrimet ndaj jorezidentëve zinin rreth 2% të totalit të bilancit. Pozicioni kreditor neto shënoi rritje ndaj një gjashtëmujori dhe një viti më parë në terma absolutë, por një tkurrje të lehtë në ata relativë.

5.1.1.1 *Indeksi i shëndetit bankar*

Gjatë periudhës, indeksi i shëndetit bankar mbeti i pandryshuar dhe tregon një gjendje të mirë financiare të sektorit bankar.

Në krahasim me gjashtë muaj më parë, indeksi i shëndetit për bankat sistemike sinjalizon për ulje të rrezikut, ndërsa për bankat josistemike sinjalizon rritje të lehtë të rrezikut. E njëjta ecuri vërehet edhe për ndarjen midis bankave të huaja dhe bankave vendase.


Në një horizont më afatgjatë, indeksi tregon përmirësimin e veprimtarisë së sektorit bankar në terma të cilësisë së aktiveve dhe nivelit të kapitalizimit.

Indeksi i shëndetit bankar (ISHB) mbeti i pandryshuar gjatë periudhës, në nivelin 0.42, dhe reflekton një gjendje të mirë dhe të qëndrueshme financiare të sektorit bankar. Treguesi i cilësisë së aktiveve shfaq një rritje të lehtë të lidhur kryesisht me rritjen e peshës së kredisë nënstandarde ndaj totalit të kredive me probleme, për disa banka të sektorit, gjatë periudhës. Megjithatë, ky efekt negativ thuhet të jetë kompensuar nga përmirësimi i treguesit të eficiencës, kryesisht për nëntreguesin e shpenzimeve të personelit, në llogaritjen e vlerës totale të ISHB-së. Krahasuar me një vit më parë, rreziqet që burojnë nga përfitueshmëria dhe nga likuiditeti paraqesin rritje të lehtë. Kjo lidhet me ngadalësimin e ritmit të rritjes së fitimit të sektorit bankar, një ecuri normale dhe e pritshme në kushtet kur fitimet e bankave rezultuan të larta një vit më parë, dhe nga rënia e nëntreguesit të aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve. Treguesi i kapitalizimit u shfaq i qëndrueshëm dhe pa ndryshime të qenësishme në krahasim me periudhat e mëparshme.

Indeksi i shëndetit për grupin e bankave sistemike tregon ulje të lehtë të rrezikut në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Ky zhvillim lidhet kryesisht me përmirësimin e notës së eficiencës, të ndjekur nga përmirësimi më i lehtë i treguesve të kapitalizimit dhe të cilësisë së aktiveve. Në krahasim me të njëjtën periudhë një vit më parë, indeksi i shëndetit bankar për këtë grup paraqitet i dobësuar lehtë, si rezultat i përkeqësimit të treguesve të lidhur me likuiditetin, eficiencën dhe cilësinë e aktiveve.


Indeksi i shëndetit për grupin e bankave josistemike sinjalizon rritje të lehtë të rrezikut. Në këtë grup, me përjashtim të cilësisë së aktiveve, notat për treguesit e tjerë u shfaqën më të dobësuar.

Grafik 42. Indeksi i shëndetit bankar²¹



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 43. Harta e shëndetit bankar²²



Indeksi i shëndetit bankar tregon për një ecuri të përgjithshme më të mirë të bankave me kapital të huaj në krahasim me bankat me kapital shqiptar. Gjatë periudhës, indeksi i shëndetit bankar shfaq përmirësim për bankat me kapital të huaj, ndërsa ato me kapital vendas nuk shënuan ndryshime të qenësishme. Në krahasim me gjysmën e parë të vitit 2024, bankat me kapital të huaj paraqitën përmirësim të treguesve të likuiditetit dhe eficiencës, ndërsa treguesit e tjerë kontribuuan në përkeqësimin e indeksit, por në një shkallë më të vogël. Në krahasim me një vit më parë, indeksi sinjalizon rrezik të shtuar, pasi me përjashtim të përmirësimit të notës së cilësisë së aktiveve, treguesit e tjerë u shfaqën të dobësuar. Për bankat me kapital vendas vërehet një nivel i përafërt rreziku me atë të gjashtë muajve më parë, ndërkohë që në krahasim me fundin e vitit të kaluar, indeksi u përkeqësua lehtë si rezultat i ecurisë së treguesve të eficiencës dhe të likuiditetit. Nga ana tjetër, nota e kapitalizimit të bankave me kapital vendas nuk shënoi ndryshime, ndërsa nota e përfitueshmërisë dhe cilësisë së aktiveve u përmirësua, por në një masë më të vogël nga përkeqësimi i treguesve të tjerë.

Në tërësi, gjatë viteve 2014-2024, indeksi i agreguar i shëndetit bankar flet për përmirësim të shëndetit dhe rritje të qëndrueshmërisë së sektorit bankar. Ky përmirësim lidhet në mënyrë të veçantë me përmirësimin e cilësisë së aktiveve dhe të kapitalit. Në të njëjtën kohë, ndjeshmëria e indeksit ndaj niveleve të përfitueshmërisë është bërë më e rëndësishme që nga tremujori i parë i vitit 2020.

5.1.1.2 Kapitalizimi i veprimtarisë

Gjatë periudhës, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për sektorin bankar u rrit me 0.5pp, duke u ngjitur në nivelin 19.8%. Ky nivel, është pothuaj i njëjtë me atë të një viti më parë. Në ecurinë e këtij treguesi, kontributin pozitiv e ka dhënë rritja e kapitalit rregullator, pavarësisht


Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për sektorin u rrit gjatë periudhës me 0.5pp, në nivelin 19.8%. Në terma vjetorë, ky tregues mbeti pothuaj i pandryshuar. Në nivel mesatar, normën më të lartë të mjaftueshmërisë së kapitalit e mbajnë bankat me kapital evropian. Bankat me kapital shqiptar raportojnë një nivel më të ulët të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit në krahasim me grupet e bankave të tjera, por ky nivel gjatë gjysmës së dytë të vitit 2024 ka shënuar rritje.

²¹ Sa më e lartë vlera, aq më i lartë rreziku. Gjerësia e çdo dimensionit nënkupton kontributin e tij ndaj rrezikut.


²² Larg nga qendra nënkupton rritje të rrezikut, në një interval nga 0 në 1.

rritjes paralele të aktiveve të ponderuara me rrezik.

Grafik 44. Ecuria e treguesve të mjaftueshmërisë së kapitalit



Grafik 45. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për grupet, sipas rëndësisë dhe origjinës së kapitalit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit u ndikua pozitivisht nga rritja e kapitalit rregullator, pavarësisht zgjerimit të aktiveve të peshuara me rrezik. Gjatë periudhës, kapitali rregullator i bankave u rrit me rreth 12 mld lekë ose 6%, duke u ngjitur në nivelin 207 miliardë lekë. Ecuria e kapitalit rregullator u përcaktua nga rritja e kapitalit të paguar, zgjerimi i fitimit të pashpërndarë si rezultat i përfshirjes së fitimit financiar të certifikuar të periudhës, dhe nga rritja e borxhit të varur të bankave. Në terma vjetorë, ecuria e kapitalit rregullator u përcaktua kryesisht nga fitimet e pashpërndara të periudhave të mëparshme, megjithatë ky kontribut ka ardhur në rënie.


Aktivet e peshuara me rreziku u rriten me 3% gjatë periudhës, në nivelin 1,050 miliardë lekë. Këto vijojnë të dominohen nga aktivet e peshuara për rrezikun e kredisë, që zënë 85% të totalit. Aktivet e peshuara për rrezikun e tregut dhe atë operacional zënë përkatësisht 1% dhe 14% të totalit. Rritja e nivelit të të ardhurave të veprimtarisë bankare u reflektua në zgjerimin e kërkesës për kapital për rrezikun operacional me rreth 20 miliardë lekë, në nivelin 144 miliardë lekë. Në raport me totalin e aktiveve, pesha e aktiveve të peshuara me rrezik mbeti pothuajse e pandryshuar gjatë periudhës, në nivelin 50%. Ekspozimet ndaj portofoleve me pakicë dhe ato të siguruara me kolateral "pasuri të paluajtshme" kontribuuan në rritjen e aktiveve të peshuara me rrezik për rrezikun e kredisë.

Grafik 46. Kontributi vjetor në rritjen e kapitalit rregullator, sipas elementeve përbërëse (në p.p.)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 47. Ecuria e levës financiare, sipas përbërësve



Gjatë periudhës, raporti i levës financiare²³ u rrit lehtë në nivelin 8.8%. Kjo ecuri erdhi si rrjedhojë e rritjes më të shpejtë të kapitalit të nivelit të parë krahasuar me rritjen e ekspozimeve totale të llogaritura për efekt të levës financiare. Minimumi i kërkuar nga kuadri rregullator për këtë tregues është 5.75%. Raporti i levës financiare për sektorin bankar përcaktohet kryesisht nga bankat me rëndësi sistemike. Bankat me kapital të huaj kanë nivelin më të lartë të raportit të levës financiare, çka rrit potencialin për të financuar vijueshmërinë e aktivitetit. Bankat me kapital shqiptar llogarisin një raport më të ulët të levës financiare krahasuar me grupet e tjera, gjë që sjell një nevojë më të lartë për përdorimin e borxhit krahas fondeve të tyre për financimin e veprimtarisë bankare.

Teprica e kapitalit dhe përbushja e kërkesave rregullative për shtesat makroprudenciale të kapitalit

Aktualisht, bankave u kërkohet të përbushin disa kërkesa për nivelet e kapitalit, ku përfshihen shtesat makroprudenciale të kapitalit dhe ato për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar (MREL).

Me qëllim forcimin e pozitave të kapitalit, gjatë periudhës, bankat kanë injektuar kapital, kanë rritur fitimet e paspërndara dhe kanë shtuar përdorimin e borxhit të varur.

Sektorin bankar në tërësi arriti t'i përbushte kërkesat rregullative për kapital në gjysmën e dytë të vitit 2024,

Sektorin bankar, në tërësi, arriti t'i përbushte kërkesat rregullative për kapital gjatë gjysmës së dytë të vitit 2024 dhe të regjistronte një tepricë kapitali pozitive. Në përputhje me rregulloren “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit”, bankat janë subjekt i shtesës konservuese të kapitalit (KONS), shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC) dhe shtesës për bankat me rëndësi sistemike (SIST). Shtesa konservuese e kapitalit për vitin 2024 ishte 2.5% për të gjitha bankat e sektorit, ndërsa shtesa për bankat sistemike lëviz në vlerat 0.5%, 1% dhe 1.5%, në varësi të rëndësisë sistemike të bankës. Shtesa kundërciklike e kapitalit e zbatuar ndaj bankave gjatë gjithë vitit 2024 ishte 0%. Në fund të muajve qershor dhe dhjetor të vitit 2024, Banka e Shqipërisë, nëpërmjet vendimeve të Guvernatorit, shpalli një KUNC të barabartë me 0.25% dhe me 0.5%, i cili duhet të përbushet nga të gjitha bankat, përkatësisht fund të muajit qershor 2025 dhe në fund të muajit dhjetor 2025. Deri në kohën e përgatitjes së këtij raporti, Banka e Shqipërisë nuk ka shpallur shtesë për rrezikun sistematik (STRUK).


²³ Në 1 janar 2022 hyri në fuqi rregullorja nr. 63/2020 “Për raportin e levës financiare të bankave” sipas të cilës raporti i levës financiare llogaritet si raport i kapitalit të nivelit të parë të bankës me ekspozimin total të bankës në datën e raportimit.

dhe, në fund të periudhës, ai regjistrore një tepricë kapitali pozitive. Megjithatë, vlerat e kësaj teprice kanë ardhur në rënie.

Bankat që janë subjekt i kërkesave për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar (MREL) ²⁴ kanë vijuar me plotësimin e kërkesave shtesë, sipas kalendarit të miratuar. Kundrejt një viti më parë, shtesa e MREL-së ishte 1.5-1.9 p.p. më e lartë, në varësi të bankave specifike subjekt i MREL-së. Përfshirja e kërkesës MREL ndikon në shkallën e përmbushjes së shtesave makroprudenciale për bankat që janë subjekt i zbatimit të MREL-së. Kjo ndodh në kushtet kur dhe deri në masën që banka përdor instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë për përmbushjen e MREL-së. Plotësimi i MREL-së me instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë shoqërohet me rënie e kapitalit neto të disponueshëm për përmbushjen e shtesave makroprudenciale të kapitalit.


Në fund të periudhës, sektori bankar rezultonte me një tepricë pozitive të kapitalit të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesave rregullative në fuqi, por kjo tepricë është zvogëluar në krahasim me gjashtë muaj dhe një vit më parë. Ecuria e tepricës së kapitalit diktohet nga ecuria e fitimit të bankave, sjellja e elementeve të kapitalit rregullator dhe kërkesat rregulatore që duhet të përmbushen (shtesat makroprudenciale të kapitalit/MREL). Teprica e kapitalit ose kapitali i disponueshëm ra me rreth 10 miliardë lekë për periudhën në nivelin 35 miliardë lekë, si pasojë e rritjes së kërkesave minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar – MREL. Me qëllim forcimin e vazhdueshëm të pozitave të kapitalit, bankat kanë injektuar kapital, kanë rritur fitimet e pashpërndara dhe kanë shtuar përdorimin e borxhit të varur. Këto elemente kanë përmirësuar treguesit e kapitalit. Aktualisht, bankat me rëndësi sistemike, duke qenë subjekte të përmbushjes edhe të MREL-së, zotërojnë një tepricë kapitali më të ulët në krahasim me bankat e tjera. Në fund të periudhës, teprica e kapitalit për këto banka shënonte 11 miliardë lekë, ose 7 miliardë lekë më pak se teprica e një gjashtëmujori më parë, dhe zinte rreth 2% të aktiveve të peshuara me rrezik. Bankat e tjera rezultuan me një tepricë kapitali prej 24 miliardë lekësh, rreth 3 miliardë lekë më pak se teprica e një periudhe me parë, dhe kjo tepricë është sa 6.5% e ekspozimeve të peshura me rrezik.

Grafik 48. Teprica e kapitalit për sektorin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 49. Struktura e shtesave rregulatore të kapitalit, dhjetor 2024



²⁴ Pesë banka janë subjekt i plotësimin të "kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar" (MREL), në përputhje me kërkesat e parashikuara në rregulloren nr. 78, datë 16.12.2020, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Banka ka detyrimin të plotësojë sipas radhës kërkesat minimale për kapitalin rregullator, kërkesën minimale për MREL dhe shtesat makroprudenciale të kapitalit.

5.1.1.3 Rezultati financiar

Rezultati neto dhe treguesit e përfitueshmërisë së sektorit bankar u përmirësuan në krahasim me një vit më parë, si pasojë e rritjes në të ardhurat neto nga interesat dhe nga veprimtaritë e tjera.

Rritja e të ardhurave neto nga interesat reflektoi rritjen e të ardhurave nga interesat me një ritëm më të shpejtë se ai i shpenzimeve për interesa.

Rritja në të ardhurat jo nga interesat lidhet me një performancë më të mirë të investimeve në instrumentet financiare dhe të ardhura më të larta nga komisionet.

Në krahasim me një vit më parë, bankat kanë raportuar shpenzime disi më të larta të veprimtarisë dhe në ato për provigjione.

Performanca shumë më e mirë e të ardhurave në krahasim me rritjen e shpenzimeve të veprimtarisë ka përmirësuar nivelin e mbulimit të këtyre të fundit.


Rezultati neto dhe treguesit e përfitueshmërisë së sektorit bankar janë përmirësuar në krahasim me një vit më parë, kryesisht si pasojë e rritjes në të ardhurat neto nga interesat, por edhe nga veprimtaritë e tjera. Në fund të vitit 2024, fitimi i akumuluar i sektorit bankar shënoi vlerën 37.4 miliardë lekë, nga rreth 32 miliardë lekë një vit më parë. Rritja e fitimit është pasqyruar në tregues më të lartë mesatarë të rentabilitetit të sektorit bankar, ku kthimi nga aktivet (RoA) rezultoi 1.9% dhe kthimi nga kapitali (RoE) 18.2%, kundrejt përkatësisht niveleve 1.7% dhe 17% të një viti më parë. Sektori bankar ka regjistruar rritje të konsiderueshme në të ardhurat neto nga interesat. Gjithashtu, u raportua rritje në të ardhurat nga veprimtaritë e tjera, kryesisht si rezultat i rritjes së fitimit nga instrumentet financiare, por edhe në të ardhurat nga komisionet. Nga ana tjetër, shpenzimet e veprimtarisë dhe ato për provigjione janë rritur lehtë në krahasim me një vit më parë.

Të ardhurat neto nga interesat u rritën me 5 miliardë lekë kundrejt një viti më parë, duke arritur në nivelin 75.6 miliardë lekë. Rritja vjetore në rezultatin neto nga interesat lidhet vetëm me aktivitetin në valutë, ndërkohë që rezultati në Lekë ishte pothuajse i njëjtë me atë të raportuar në fund të vitit 2023. Rritja e të ardhurave neto nga interesi reflekton rritjen e të ardhurave nga interesat me 10.3 miliardë lekë, në nivelin 95 miliardë lekë. Kjo rritje ishte gati sa dyfishi i rritjes prej 5.3 miliardë lekësh në shpenzimet për interesat e paguara nga bankat për depozitat dhe detyrime të tjera. Pavarësisht rritjes në të ardhurat nga interesat, marzhi neto nga interesat mbeti i pandryshuar në 4.3%, për shkak të rritjes me 9% në aktivet mesatare që sjellin të ardhura. Të ardhurat jo nga interesat të mbledhura nga bankat gjatë periudhës u rritën me 7.4 miliardë lekë, në nivelin 24 miliardë lekë, pasi sektori bankar raportoi rritje të fitimit nga instrumentet financiare me 3 miliardë lekë, dhe mblodhi 2.2 miliardë lekë më shumë të ardhura nga komisionet bankare.

Tabelë 5. Të ardhurat dhe shpenzimet e sektorit bankar (miliardë lekë) Grafik 50. Përbërësit e rezulttit financiar

	2024		2023	
	Në lekë	Në valutë	Total	Total
Të ardhura nga interesat	53.2	41.6	94.8	84.5
Shpenzime për interesat	12.0	7.2	19.2	13.9
Të ardhura neto nga interesat	41.1	34.4	75.6	70.6
Të ardhura jo nga interesat	13.9	8.8	23.9	16.5
gjaba dhe komisione	10.7	8.2	18.9	16.7
humbje ose fitim nga instrumentet financiare	1.8	0.5	2.4	-0.7
Shpenzime jo për interesa	39.9	11.0	51.1	46.5
Provigjione (neto)	4.6	0.2	4.8	4.3
për kreditë	4.6	0.9	5.6	5.9
për mjete të tjera financiare	0.0	-0.7	-0.7	-1.7
Zëra të jashtëzakonshëm	-0.9	-0.3	-1.1	-0.8
Taksa mbi të ardhurat	6.3	0.0	6.3	5.3
Rezultati neto	5.1	32.3	37.4	31.9


Burimi: Banka e Shqipërisë.



Niveli i mbulimit të kostove të veprimtarisë nga të ardhurat e bankave është përmirësuar pasi rritja në shpenzimet e veprimtarisë ishte shumë më e vogël në krahasim me rritjen e të ardhurave. Në krahasim me një vit më parë, shpenzimet e veprimtarisë u rritën me 4.6 miliardë lekë në rreth 51 miliardë lekë, ndërkohë që të ardhurat arritën në rreth 100 miliardë lekë, me një rritje prej 12.4 miliardë lekësh. Raporti i shpenzimeve të veprimtarisë ndaj të ardhurave ra në 50% nga 53%. Shpenzimet për provigjione për kredi gjatë 2024 mbetën të pandryshuara kundrejt një viti më parë, në rreth 5.6 miliardë lekë. Në të njëjtën kohë, sektori bankar vazhdoi të raportojë rimarrje të shpenzimeve për provigjionimin e mjeteve të tjera financiare, por më pak se vitin e kaluar. Në total, shpenzimet për provigjione u rritën lehtë me rreth 0.6 miliardë lekë, duke arritur në 4.8 miliardë lekë në fund të vitit 2024.


Përmirësimi i rezultatit financiar është pasqyruar në një përmirësim të dukshëm të shpërndarjes së vlerave të Kthimit nga Aktivet (RoA). Në fund të vitit 2024, bankat që kanë një RoA midis 2% dhe 3% mbanin 40% të aktiveve të sektorit bankar, nga një mesatare prej rreth 12.5% e llogaritur për vitet 2018-2023; ato me një RoA midis 1% dhe 2% mbanin po ashtu 40% të aktiveve të sektorit bankar, dhe ato me një RoA midis 0% dhe 1% zënë 20% të aktiveve të sektorit bankar.

Grafik 51. ROA sipas peshës së bankave në aktivet e sektorit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 52. Tregues të përfitueshmërisë dhe marzhi neto i interesit



5.1.1.4 Kredia

Teprica e kredisë bankare u zgjerua gjatë periudhës me 5.4%, ndërsa në terma vjetorë rritja ishte 12.8%. E korigjuar për efektin e kursit të këmbimit, norma e rritjes vjetore të kredisë do të ishte 15.3%.

Rritja është regjistruar në të gjithë sektorët dhe monedhat, dhe është përqendruar kryesisht në kreditë afatgjata.

Teprica e kredisë bankare²⁵ u zgjerua ndjeshëm gjatë periudhës dhe në terma vjetorë. Në fund të vitit, stoku i kredisë arriti në 830 miliardë lekë, nga të cilat 460 miliardë lekë janë kredi të dhëna në monedhën vendase. Në terma relativë, kredia u rrit me 5.4% në krahasim me gjashtë muaj më parë dhe me 12.8% ndaj një viti më parë. Rritja e kredisë është vënë re në të dy sektorët (familje dhe biznese) dhe monedhat kryesore (Lek dhe Euro), por ka qenë më e dukshme në portofolin e kredive afatgjata, ndërkohë që edhe ndarjet e tjera të kredive kanë shfaqur rritje.

Në terma vjetorë, rritja e kredisë është regjistruar për të gjitha subjektet, maturitetet dhe monedhat, por kontributin më të madh e ka dhënë kredia afatgjatë (me 8.8 p.p.), kredia e akorduar në monedhën vendase (me 8 p.p.) dhe kredia për bizneset (me 7.2 p.p.). Kredia në Lek është


²⁵ Ky përkufizim përfshin të gjitha kreditë e dhëna nga bankat vendase për subjekte rezidente dhe jorezidente.

Ristrukturimet e kredive dhe largimet nga bilanci të kredive të humbura kanë vijuar. Vëllimet e ristrukturimeve ranë, ndërsa ato të fshirjeve ishin të krahasueshme me periudhën e kaluar.

zgjeruar me ritme veçanërisht të shpejta gjatë periudhës dhe ndryshimi vjetor në fund të vitit 2024 arriti në 15%. Kredia në valutë u rrit me 10.3%. Kredia për individët u zgjerua me 14.4%, ndërsa ajo për bizneset u rrit me 11.8%. Duke korrigjuar efektin statistikor të kursit të këmbimit, i cili ishte negativ për rreth 18 miliardë lekë, rritja vjetore e kredisë në valutë do të rezultonte 15.6%, ndërsa rritja e tepricës së përgjithshme të kredisë do të ishte rreth 15.3%.


Vëllimi i kredive të ristrukturuara ishte më i ulët ndaj gjashtëmujorit të kaluar, ndërsa fshirjet e kredive të humbura ishin në vlera të krahasueshme me periudhën e kaluar. Kredia e ristrukturuar gjatë periudhës ishte rreth 1.6 miliardë lekë ose më pak se 1% e fluksit të kredisë së re të periudhës dhe sa 5% e stokut të kredive me probleme. Portofolet e prekura nga ristrukturimi i kredisë lidhen me kreditë në Lek dhe valutë për sektorin e biznesit. Forma kryesore e ristrukturimit e kërkuar nga klientët dhe e miratuar nga bankat ishte zgjatja e afatit të maturimit. Fluksi vjetor i kredisë së ristrukturuar është zvogëluar gjatë viteve të fundit. Kështu, vlera e kredisë së ristrukturuar gjatë gjashtëmujorit të dytë të 2024 është sa 35% e vlerës së kredisë së ristrukturuar në të njëjtin gjashtëmujor të vitit 2021. Procesi i fshirjes së kredive të humbura nga bilanci e bankave ka vijuar edhe gjatë periudhës dhe vlera e kredive të humbura të fshira nga bilanci ishte rreth 1 miliardë lekë. Gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit janë fshirë rreth 2.4 miliardë lekë kredi të humbura dhe rreth 61% e këtij vëllimi lidhet me kredi të marra nga bizneset. Vlera e kredive të fshira në periudhën e fundit ishte sa 2.7% e tepricës së përgjithshme të kredive me probleme në portofolin e bankave, nga rreth 4% gjashtëmujorin e kaluar.

Grafik 53. Rritja vjetore e kredisë, sipas valutës



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 54. Ndryshimi në tepricën e kredisë, sipas elementeve përbërëse



Kredia për subjektet jorezidente

Kredia për jorezidentët u rrit lehtë gjatë periudhës, por pesha e saj ndaj kredisë së përgjithshme të sektorit bankar mbetet e ulët. Në fund të periudhës, kredia për jorezidentët ishte rreth 36 miliardë lekë ose sa 4% e tepricës së kredisë së sektorit bankar. Stoku i kredisë për subjektet jorezidente u rrit me rreth 5% ndaj gjashtë muajve më parë dhe me rreth 23% ndaj një viti më parë.

Kredia e pambrojtur në valutë

Teprica e kredisë së pambrojtur në valutë u

Kredia e pambrojtur në valutë e shprehur në Lek është rritur lehtë në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Stoku i kredisë së pambrojtur në

rrit me 2.4% në terma gjashtëmujorë dhe me 1.5% në krahasim me një vit më parë. E korrigjuar me efektin e kursit të këmbimit, rritja e periudhës do të ishte 4.3%.

Kontributin kryesor në këtë ecuri e ka dhënë zgjerimi i kredisë së pambrojtur në valutë për bizneset. Kredia e pambrojtur në valutë për individët është tkurrur lehtë.

Raporti i kredive me probleme për kreditë e pambrojtura në valutë rezultoi 4% në fund të periudhës, duke rënë gjatë saj me 0.3 p.p.

valutë ishte 90 miliardë lekë në fund të dhjetorit 2024, dhe kjo vlerë ishte 2.4% më shumë sesa stoku i raportuar në fund të gjashtëmujorit të parë, dhe 1.5% më shumë sesa një vit më parë. Treguesi i korrigjuar për efektin e kursit paraqet një rritje prej 4.3% gjatë këtij gjashtëmujori. Kredia e pambrojtur në valutë është zgjeruar me ritme më të ngadalta sesa stoku i kredisë në valutë dhe i kredisë së përgjithshme, duke bërë që pesha e saj ndaj këtyre tepricave të paraqitet më e vogël krahasuar me fundin e vitit të kaluar, në përkatësisht 24% dhe 11%. Rënia relative e kredisë së pambrojtur në valutë tregon një rënie të ekspozimit të sektorit bankar ndaj efektit të tërthortë të kursit të këmbimit, dhe përfaqëson një zhvillim pozitiv si në drejtim të mbrojtjes së huamarrësve, ashtu edhe të qëndrueshmërisë së sektorit bankar.

Rritja vjetore në tepricën e kredisë së pambrojtur ka ardhur nga rritja e portofolit të kredisë së pambrojtur për bizneset, dhe në monedhën Euro.

Kredia e pambrojtur për bizneset u rrit me 12%, ndërsa kredia e pambrojtur e individëve ka ecur në kahun e kundërt, duke u tkurrur me 9% në terma vjetorë. Pjesa kryesore e tepricës së kredisë së pambrojtur në valutë përbëhet nga kredia në Euro dhe rritja e kredisë së pambrojtur është evidentuar sidomos në stokun e këtij portofoli. Sipas sektorëve, peshën kryesore në kredinë e pambrojtur në valute e zë ajo "për pasuri të paluajtshme" me rreth 57%, e ndjekur nga ajo "për tregti" me 15%.

Kredia e pambrojtur për individët për blerje pasurish të paluajtshme vazhdon të përbëjë rreth 2/3 të tepricës së kredisë së pambrojtur të dhënë për blerje dhe zhvillim të pasurive të paluajtshme. Teprica e përgjithshme e kredisë së dhënë për këtë qëllim mbeti pothuajse e pandryshuar në krahasim me nivelin e regjistruar në fund të gjashtëmujorit të parë, por struktura sipas sektorëve ka ndryshuar në favor të sektorit të bizneseve, ndërkohë që kredia e pambrojtur e marrë nga individët për blerjen e pasurive të paluajtshme ra me 6%. Raporti i kredive me probleme për kreditë e pambrojtura nga kursi i këmbimit ishte 4% në fund të vitit, nga 4.3% periudhën e kaluar. I njëjti tregues vetëm për kreditë për pasuri të paluajtshme shënoi 3.5%.

Kredia e re

Kredia e re e dhënë gjatë periudhës ishte më e lartë se ajo e një viti më parë, me kontributin kryesor pozitiv nga kredia në Euro.

Rritja e fluksit të kredisë së re gjatë periudhës lidhet thuajse tërësisht me kredinë e akorduar sektorit të bizneseve. Kjo kredi ka shkuar kryesisht për të përmbushur nevojat afatshkurtra të bizneseve për likuiditet. Edhe kredia e re për individët u rrit në

Kredia e re e akorduar nga bankat gjatë periudhës, ishte rreth 200 miliardë lekë ose 10% më shumë sesa kredia e re e raportuar gjatë secilit prej dy gjashtëmujorëve paraardhës. Rritja në fluksin e kredisë së re lidhet kryesisht me kreditë e reja në Euro, por edhe flukset e kredisë së re në monedhën vendase dhe USD kanë shënuar rritje. E njëjta ecuri vërehet edhe krahasuar me të njëjtin gjashtëmujor një vit më parë, ku peshën kryesore të rritjes e mban kredia e re e akorduar në Euro.

Rritja e fluksit të kredisë së re gjatë periudhës lidhet thuajse tërësisht me kredinë e akorduar sektorit të bizneseve. Fluksi i kredisë së re për sektorin e bizneseve për gjashtëmujorin rezultoi 144 miliardë lekë, nga rreth 130 miliardë lekë në secilin nga dy gjashtëmujorët paraardhës. Rreth 60% e kredisë për bizneset ka formën e kredisë – kufi dhe për kapital qarkullues, ndërkohë që pjesa tjetër e kredisë së re është ndarë në blerje pajisjesh dhe blerje pasurish të paluajtshme.

terma vjetorë dhe gjashtëmujorë, por me ritme më të ngadalta. Ajo ka shkuar kryesisht për blerjen e pasurive të paluajtshme.


Norma mesatare e interesit për kreditë e reja rezultoi 6.6%, e pandryshuar gjatë periudhës. Për kreditë e reja në Lek, ky tregues ishte 6.9%, ndërsa për ato në Euro, ai rezultoi 6.1%.

Sipas vrojtimit të bankave lidhur me aplikimet për kredi, rezulton një rritje e numrit të aplikimeve, e drejtuar kryesisht nga sektori i individëve dhe ai i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Gjithashtu, ecuria e treguesit të refuzimeve për aplikimet e kryera, sugjeron një qëndrim relativisht më përzgjedhës të bankave, veçanërisht në drejtëm të kredidhënies së individëve.

Fluksi i kredisë së re për individët ishte i krahasueshëm me vlerën e gjashtëmujorit të parë, por 16% më shumë sesa ai i gjashtëmujorit të dytë një vit më parë. Rritja vjetore ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së fluksit të kredisë së re të marrë nga individët për blerje pasurish të paluajtshme, por edhe për blerje mallrash jo të qëndrueshme. Në terma mesatarë, kredie e re për blerje banese përfaqëson gjysmën e fluksit të përgjithshëm të kredisë së re për individët.


Në krahasim me gjysmën e parë të vitit, norma mesatare e peshuar e interesit për të kredinë në të gjitha monedhat mbeti e pandryshuar, në rreth 6.6%. Megjithatë, gjatë muajve të fundit të vitit është raportuar një rënie e normave të kredisë, veçanërisht për kreditë e reja në Euro. Norma mesatare e paguar për kreditë e reja në monedhën vendase gjatë periudhës ishte 6.9%, por në fund të vitit, ajo iu afrua nivelit 6.5%. Norma mesatare e interesit për kreditë e reja të akorduara në Euro u ul lehtë, nga 6.3% në 6.1%. Norma e kredive të reja në monedhën amerikane shfaqti gjithashtu një rënie të lehtë, duke u raportuar 6.2%. Në tërësi, normat e kredive të reja të akorduara në monedhën vendase dhe në Euro kanë treguar luhatje të vogla që nga viti 2022.

Grafik 55. Kredia e re për bizneset dhe individët, sipas qëllimit të përdorimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Grafik 56. Ecuria e normave të interesit të kredisë së re



Hapësirë informuese 2. Ecuria e numrit të aplikimeve për kredi dhe analiza e normës së refuzimit nga bankat në vend, për gjashtëmujorin e dytë 2024

Gjatë gjashtëmujorit të dytë 2024, bankat raportojnë se kanë marrë në shqyrtim gjithsej 75 530 aplikime për kredi, nga të cilat rreth 9% i përkasin "sektorit të ndërmarrjeve" (5.1% ose 3 871 aplikime nga "ndërmarrjet e vogla dhe të mesme" dhe 3.7% ose 2 778 aplikime nga "ndërmarrje të tjera") dhe 91% (ose 68 881 aplikime) i përkasin "sektorit të individëve". Krahasuar me periudhën e kaluar, kjo shpërndarje ka shënuar një zhvendosje të lehtë në favor të sektorit të individëve, duke rezultuar në vlerat e një viti më parë.

Grafik 57. Ecuria e numrit të aplikimeve të marra në shqyrtim dhe norma e refuzimit të kredive



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Numri total i aplikimeve për kredi të shqyrtuara nga bankat, ka shënuar rritje me 4.3% krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me 12.1% krahasuar me një vit më parë. Në terma gjashtëmujorë, rritja ka ardhur vetëm nga grupi i “ndërmarrjeve të tjera”, ku përgjithësisht përfshihen ndërmarrjet e mëdha (ritje me 7%), ndërkohë që numri i aplikimeve të shqyrtuara në segmentet e “ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme” dhe “individëve” ka rezultuar në rënie (respektivisht me 6.1% dhe 1.1%). Në terma vjetorë, numri i aplikimeve të shqyrtuara ka qenë në rritje për të tre segmentet e klientelës, por më e theksuar në rastin e individëve (“ndërmarrjet e vogla dhe të mesme” me 22.1%, ndërmarrjet e tjera me 8.2% dhe “individët” me 15.9%).

Në totalin e aplikimeve të marra në shqyrtim gjatë periudhës, rezulton se rreth 27% e tyre janë refuzuar nga bankat, dhe kjo normë mbetet më e lartë (dhe në rritje) në rastin e individëve. Norma e refuzimit është rritur me 2.3 p.p. krahasuar me gjashtë muaj më parë dhe me 6.7 p.p. ndaj një viti më parë; në të dy periudhat krahasuese, rritja ka qenë më e theksuar në individëve.

Norma totale e refuzimit ka rezultuar në rritje për bankat me kapital vendas dhe për ato me kapital të huaj. Vihet re se gjatë periudhës, dy grupet bankare kanë shfaqur qëndrime të ngjashme ndaj kërkesave për kredi të “individëve”, duke shfaqur prirje shtrënguese krahasuar me periudhën paraardhëse dhe krahasuar me një vit më parë. Ky qëndrim është ndjeshëm më i dukshëm tek bankat e huaja, të cilat kanë refuzuar rreth 37% të kërkesave të individëve, krahasuar me bankat vendase ku kjo normë ka rezultuar 9%. Në të njëjtën kohë, të dy grupet e bankave mbeten më pranuese ndaj segmentit të ndërmarrjeve, por prirjet kanë qenë të ndryshme gjatë periudhës.

Kështu, bankat vendase kanë pasur qëndrim më shtrëngues si ndaj “ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme” dhe ndaj atyre “të mëdha”, duke rritur normën e refuzimit respektivisht në 6% dhe 4% të kërkesave, ndërsa bankat e huaja duket se vijnë të fokusohen te kreditimi i ndërmarrjeve të mëdha (kategoria “ndërmarrje të tjera”), duke refuzuar vetëm 2% të kërkesave të tyre për kredi.

Grafik 58. Norma e refuzimit të kredive - banka vendase dhe të huaja



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në përgjithësi, nga analiza e mësipërme mund të arrihet në përfundimin se ecuria e aplikimeve të shqyrtuara nga bankat gjatë gjysmës së dytë të vitit 2024, krahasuar dhe me periudhat e kaluara, tregon për një rritje graduale, por të qëndrueshme të kërkesës për kredi - të drejtuar kryesisht nga sektori i individëve dhe ai i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme - dhe një qëndrim relativisht më përzgjedhës të bankave, veçanërisht në drejtim të kredidhënies së individëve.

5.1.1.5 Depozitat

Depozitat pranë bankave u rriten me 5% gjatë periudhës dhe në terma vjetorë, duke ruajtur strukturën e tyre. Rritja lidhet me zgjerimin e depozitave me afat dhe të llogarive rrjedhëse kryesisht të individëve, në monedhat kryesore.

Sipas monedhës, depozitat në Lek u rritën me 7%, ndërsa ato në valutë me 3%. E korrigjuar për efektin e kursit të këmbimit, rritja vjetore e depozitave në valutë do të ishte 8%.

Flukset e depozitave të reja reflektojnë një sjellje sezonale, ku rritja e tyre

Depozitat pranë sektorit bankar u shtuan me 70 mld lekë ose me 5% gjatë periudhës, për t'u ngjitur në nivelin 1,680 miliardë lekë. Kontributin pozitiv në këtë rritje e dhanë llogaritë rrjedhëse, depozitat me afat, ato të individëve, dhe depozitat në monedhën vendase e në valutë. Depozitat e bizneseve dhe të sektorit publik shfaqën gjithashtu rritje, por me ritme më të ulëta. Struktura e depozitave nuk tregoi ndryshime të qenësishme. Stoku i depozitave sipas afatit është i shpërndarë në mënyrë pothuajse të barabartë midis llogarive rrjedhëse dhe depozitave me afat, që zënë nga 44% të depozitave, ndërsa depozitat e individëve dhe depozitat në valutë zënë përkatësisht 78% dhe 52% të stokut të përgjithshëm të depozitave. Nëse ndryshimi në stokun e depozitave korrigjohet për efektin e kursit të këmbimit, rritja gjashtëmujore vlerësohet në rreth 5.5%.

Rritja e depozitave gjatë periudhës përcaktoi edhe rritjen e tyre vjetore. Kjo ecuri reflektoi efektin sezonal turistik. Në terma vjetorë, rritja e depozitave është regjistruar për të gjitha afatet, subjektet dhe monedhat, por kontributin më të madh në rritjen e stokut të përgjithshëm e kanë dhënë depozitat me afat, llogaritë rrjedhëse, depozitat e individëve dhe depozitat në Lek. Depozitat në Lek dhe valutë u zgjeruan me përkatësisht 53 dhe me 25 miliardë lekë, ose me 7% dhe 3% gjatë vitit 2024. Depozitat në valutë u


është më e lartë në gjysmën e dytë të vitit.

Normat e interesit të depozitave janë ulhur lehtë, me pak ndryshime gjate vitit. Sipas segmenteve të maturimit, bankat kanë rritur normat mesatare të interesit për depozitat e afatit më të gjatë, pavarësisht monedhës.

tkurrën lehtë në gjashtëmujorin e parë të vitit, por shënuan rritje pozitive në muajt korrik-dhjetor, duke u shtuar me rreth 33 miliardë lekë gjatë periudhës. Nëse korrigjohen për efektin statistikor të kursit të këmbimit²⁶, baza e depozitave dhe depozitat në valutë rezultojnë të jenë rritur me 7.6% dhe 7.9% në krahasim me nivelet e një viti më parë.


Depozitat me afat u zgjeruan me rreth 6% në terma vjetorë dhe kanë vijuar të japin një kontribut të rëndësishëm në rritjen e depozitave të përgjithshme. Llogaritë rrjedhëse u rritën gjithashtu me 6% gjatë periudhës dhe me 5% kundrejt një viti më parë. Stoku i depozitave pa afat u rrit me 2% gjatë periudhës dhe me 0.6% ndaj një viti më parë.

Grafik 59. Rritja vjetore e depozitave, sipas afatit dhe monedhës, në monedhë origjinale



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 60. Rritja vjetore e depozitave, sipas afatit, sektorit dhe valutës (kontribut, p.p.)




Rritja vjetore e depozitave në Lek me 7%, pasqyron kryesisht zgjerimin e llogarive rrjedhëse dhe depozitave me afat të individëve. Në fund të periudhës, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me afat të individëve në monedhën Lek shënonin përkatësisht 240 dhe 340 miliardë lekë, duke qenë 16% dhe 4% mbi nivelin e një viti më parë. Depozitat pa afat në Lek u zgjeruan lehtë gjatë periudhës dhe ndaj një viti më parë, ndërsa depozitat me afat u rritën me 2% gjatë periudhës dhe me 3% në terma vjetorë. Pothuajse i gjithë stoku prej 350 miliardë lekësh i depozitave me afat në Lek përfaqësohet nga depozitat e individëve, të cilat në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë u zgjeruan me përkatësisht 4% dhe 8%.

Depozitat në Euro, në monedhë origjinale, u rritën me 10% ndaj një viti më parë, kryesisht si rrjedhojë e zgjerimit të depozitave të individëve, me dhe pa afat. Depozitat me afat të bizneseve dhe individëve në Euro në fund të periudhës ishin përkatësisht 16% dhe 15% më të larta në krahasim me nivelin e një viti më parë, ndërsa ndryshimi vjetor në depozitat e përgjithshme në Euro të secilit sektor ishte 6.6% dhe 10.6%. Rritja e depozitave ka qenë më e fortë gjatë pjesës së dytë të vitit që ndikohet nga rritja e hyrjeve valutore


²⁶ Efekti statistikor i ndryshimit të kursit të këmbimit në kundërvlerën në Lek të depozitave në valutë llogaritet në -16 miliardë lekë për gjashtëmujorin e dytë të 2024 dhe me -43 miliardë lekë për 12 muajt e fundit.

nga turizmi dhe dërgesat e emigrantëve, ndërkohë që pjesa e parë është karakterizuar nga një ecuri e ngadaltë e tyre. Gjatë periudhës, depozitat në Euro të individëve u shtuan me rreth 340 milionë euro, ndërsa ato të bizneseve u rritën me 110 milionë euro. Gjatë së njëjtës periudhe të vitit 2023, shtesat përkatëse ishin dukshëm më të mëdha, duke arritur përkatësisht vlerat 620 dhe 210 milionë euro. Në linjë me zhvillimet sezonale, depozitat tregojnë një rritje më të fortë në pjesën e dytë të viteve, veçanërisht depozitat e individëve.

Grafik 61. Ecuria e depozitave në Lekë sipas afatit dhe sektorit (kontribut, p.p.)




Grafik 62. Ecuria e depozitave në valutë sipas afatit dhe sektorit (kontribut, p.p.)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Periudha u karakterizua nga luhajtje të lehta të normave të interesit të depozitave për të dy sektorët dhe për të tri monedhat kryesore, si dhe rritje e flukseve të depozitave të reja. Në fund të periudhës, normat e peshuara të interesit për depozitat e reja të bizneseve dhe individëve në Lek ishin përkatësisht 2.6% dhe 1.9%, ndërsa normat për depozitat e reja me afat në monedhën Euro, për bizneset dhe individët shënonin 1.8% dhe 1.2%. Normat për depozitat e reja ishin disi më të ulëta se gjashtëmujorin e kaluar. Nga ana tjetër, normat mesatare të interesit për stokun e depozitave u rritën lehtë gjatë periudhës. Kështu, për depozitat e individëve me afat mbi dy vjet në Lek, kjo normë ishte rreth 3.1% në fund të periudhës nga 2.9% gjatë periudhës së kaluar. Norma e peshuar e interesit për depozitat e individëve me afat mbi dy vjet në Euro u rrit lehtë në 1.9%, nga 1.7% një gjashtëmujor më parë. Flukset mesatare mujore të depozitave të reja të individëve gjatë periudhës ishin përkatësisht 20 miliardë lekë (për depozitat në Lek) dhe 245 milionë euro (për depozitat e reja në Euro), nga 18 miliardë dhe 180 milionë gjatë gjysmës së parë të vitit. Në krahasim me të njëjtën periudhë një vit më parë, flukset e depozitave të reja për të dyja monedhat kishin vlera të ngjashme.

Grafik 63. Depozitat e reja dhe normat e interesit për stokun dhe depozitat e reja në Lek për individët



Grafik 64. Depozitat e reja dhe normat e interesit për stokun dhe depozitat e reja në Euro për individët



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.1.2 Rreziqet e veprimtarisë së sektorit bankar

4.1.2.1 Rreziku i kredisë

Rënia e stokut të kredive me probleme dhe rritja e tepricës së kredisë gjatë periudhës, ndikoi në rënieën e raportit të kredive me probleme në nivelin 4.2%, me i ulëti në 15 vitet e fundit.

Rënia e stokut të kredive me probleme është vënë re në gjithë portofolin e kredisë, por ishte më e dukshme në kredinë në valutë, në atë afatshkurtër dhe në kredinë për bizneset. Për kredinë në valutë të pambrojtur nga lëvizjet e kursit të këmbimit, cilësia e kredisë është përmirësuar lehtë në krahasim me një vit më parë.

Ecuria e kredive me probleme u ndikua nga një ritëm më i shpejtë i shlyerjeve, që ka ndikuar në zhvendosjen e kredive nga klasat "nënstandard" dhe "të dyshimta" drejt klasave performuese. Fshirja e kredive gjatë vitit të fundit, ishte në vlerën 2.4 miliardë lekë.

Raporti i mbulimit me provigjione të kredive me probleme dhe mbulimi me kolateral i tepricës së kredisë shënuan rritje.

Raporti i kredive me probleme (RKP) ka vijuar të përmirësohet gjatë periudhës, duke shënuar, në fund të dhjetorit 2024, vlerën më të ulët të 15 vjetëve të fundit, prej 4.2%. Kjo ecuri u ndikua nga efekti i kombinuar i tkurrjes së stokut të kredive me probleme dhe rritjes së stokut të përgjithshëm të kredisë. Në krahasim me një vit më parë, stoku i kredive me probleme u zvogëlua me 1%, ndërsa raporti i kredive me probleme shënoi një rënie të ndjeshme me 0.6 p.p., nga niveli 4.8%. Bankat kanë raportuar rritje të cilësisë së kredisë kryesisht për kredinë me maturitet afatshkurtër, kredinë për bizneset dhe kredinë në valutë.

Stoku i kredive me probleme ra me 2.4 miliardë lekë, ose 6.5%, dhe në fund të periudhës shënoi rreth 35 miliardë lekë. Në këtë ecuri ka ndikuar kalimi i disa kredive "nënstandard" dhe "të dyshimta" drejt klasave performuese, si pasojë e ritmit më të shpejtë të shlyerjes së kredive me probleme. Gjatë periudhës, kreditë me probleme të klasifikuara "të humbura" u zgjeruan me 3.5 miliardë lekë, duke qenë se fshirjet e kryera nga bankat në këtë klasë të kredive ishin më të pakta në krahasim me një periudhë më parë. Brenda portofolit të kredive me probleme, tepricat në klasat e kredive "nënstandard" dhe "të dyshimta", në fund të dhjetorit zinin përkatësisht 21% dhe 16% të kredive me probleme, nga 28% dhe 23% në qershor 2024. Peshën kryesore në portofolin e kredive me probleme vijnë ta mbajnë kreditë e humbura, dhe pesha e tyre arriti në 62% në fund të periudhës, nga 49% në fund të qershorit 2024.


Vlera e kredive të fshira gjatë 12 muajve të fundit ishte rreth 2.4 miliardë lekë. Pjesa më e madhe e kredive të fshira ishin kredi të bizneseve në Lek. Gjatë periudhës janar 2015 – dhjetor 2024, bankat kanë fshirë nga bilancet e tyre rreth 82 miliardë lekë kredi të humbura.

Në nivel grupesh, bankat josistemike kanë normën më të ulët të raportit të kredive me probleme krahasuar me bankat e tjera²⁷. Në një hark kohor prej 10 vitesh, përmirësimin më të dukshëm të cilësisë së portofolit të kredisë e kanë shënuar bankat evropiane, për të cilat raporti i kredive me probleme ka zbritur nga 27% në vitin 2014 në 3.9% për vitin 2024. Shpërndarja e raportit të kredive me probleme tregon se

²⁷ Raporti i kredive me probleme për bankat josistemike në dhjetor 2024 rezultoi në 3.4%, për bankat sistemike 4.7%, për bankat evropiane 3.9% dhe për bankat shqiptare 4.6%.


shumica e bankave kanë një raport në intervalin 5%-6%. Megjithatë, në dhjetor 2024 vihet re një zhvendosje e bankave drejt intervalit 3%-4%, si rezultat i përmirësimit të cilësisë së portofolit të kredisë.

Grafik 65. Raporti i kredive me probleme, sipas rëndësisë dhe origjinës së kapitalit



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Grafik 66. Shpërndarja e bankave, sipas raportit të kredive me probleme



Mbulimi me kolateral i kredisë mbetet në nivele të larta dhe gjatë periudhës ky raport u rrit me 1 p.p., në 76%. Kreditë me kolateral në formën e pasurive të paluajtshme zënë peshën kryesore ose rreth 61% të kredisë së kolateralizuar dhe 46% të tepricës së kredisë. Stoku i kredisë së kolateralizuar me pasuri të paluajtshme është zgjeruar me 9% në krahasim me një vit më parë, si rezultat i rritjes së kredisë së kolateralizuar me pasuri të paluajtshme rezidenciale. Edhe portofolet e kredive të kolateralizuara me kolateral tjetër kanë shënuar rritje.


Raporti i mbulimit me provigjione për rrezikun e kredisë është rritur, duke qenë se është rritur pesha e kredive të klasifikuara "të humbura" në strukturën e kredive me probleme, për të cilat kërkohet provigjionim i plotë. Në dhjetor 2024, raporti i mbulimit të kredive me probleme me provigjione prej 76% ishte më i lartë se niveli 67% i regjistruar në fund të gjysmës së parë të vitit 2024 dhe më i lartë se niveli prej 71% i një viti më parë.

Grafik 67. Raporti i kredive me probleme dhe mbulimi me provigjione dhe kolateral



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 68. Kontributi në ndryshimin tremujor të stokut të kredive me probleme




Kategoritë e kredisë me përmirësimin me të shpejtë të cilësisë ishin kredia për zhvillim biznesi dhe ajo për tregti. Raporti i kredive me probleme i këtyre kategorive ra përkatësisht në nivelin 4.9% dhe 4.7% në dhjetor 2024, nga përkatësisht 6.3% dhe 5.4% në qershor 2024. Rritje e cilësisë për periudhën u evidentua edhe për kredinë dhënë për investime në pasuri të paluajtshme dhe atë konsumatore. Portofolet e kredisë me vlerën më të lartë të raportit të kredive me probleme janë kredia afatmesme, ajo për biznese, si dhe

kredia në Lek. Në fund të dhjetorit 2024, raportet e kredive me probleme për këto lloj kredish ishin përkatësisht 5.9%, 5.1% dhe 4.8%.


Treguesi i normës së prurjeve të kredive me probleme²⁸ dhe ai i kredive me probleme të rikuperuara²⁹ sugjerojnë se gjatë një viti, sektori bankar ka regjistruar më pak kredi të reja me probleme. Në dhjetor 2024, fluksi vjetor i kredive të reja me probleme ishte sa 1.7% e kredive të rregullta, nga 1.8% dhe 1.9% një gjashtëmujor dhe një vit më parë. Kjo ecuri u përcaktua nga zgjerimi i i tepricës së kredive të rregullta. Norma e rikuperimit të kredive me probleme shënoi rritje në 13.8%, nga 12.7% një vit më parë. Kjo ecuri tregon rritje të aftësisë së bankave për të rikuperuar kreditë me probleme. Nga ana tjetër, norma e dështimit³⁰ që tregon shpejtësinë me të cilën akumulohen kreditë e humbura në krahasim me portofolin e përgjithshëm të kredisë, ka rënë në 1.1%, nga 1.2% dhe 1.4% një gjashtëmujor dhe një vit më parë, ndikuar nga zgjerimi i tepricës së përgjithshme të kredisë. Rënia e normës së dështimit gjatë 12 muajve të fundit sinjalizon një rrezik më të ulët të aktivitetit kreditues, megjithatë zgjerimi i shpejtë i portofolit të kredisë mund të materializohet në një shtim të prurjeve të kredive me probleme në të ardhmen.

Grafik 69. RKP-ja për kredinë, sipas qëllimit të përdorimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 70. Treguesit e vlerësimit të rrezikut të kredisë



Cilësia e kredisë në valutë të pambrojtur nga luhatjet në kursin e këmbimit u përmirësua në krahasim me një gjashtëmujor dhe me një vit më parë. RKP-ja për këtë portofol të kredisë shënoi 4% në fund të dhjetorit 2024, nga 4.3% një vit më parë. Në këtë ecuri ka ndikuar tkurrja në stokun e kredive me probleme të kredisë dhënë për zhvillim biznesi dhe kredisë për zhvillimin e pasurive të paluajtshme (rezidenciale). Peshën kryesore në tepricën e kredive me probleme të pambrojtura nga luhatjet e kursit të këmbimit, me rreth 50%, vijon ta mbajë kredia për investime në pasuri të paluajtshme, dhe RKP-ja për këtë kategori kredie ra në rreth 3.5%, nga 3.6% një vit më parë.

5.1.2.2 Rreziku i likuiditetit

Pozicioni i likuiditetit të sektorit bankar mbetet në nivele të mira dhe treguesit e likuiditetit

Rreziku i likuiditetit në aktivitetin e sektorit bankar mbetet i kontrolluar. Treguesit kryesorë të likuiditetit për monedhën vendase dhe të huaj vijnë të jenë dukshëm mbi kufijtë minimalë të përcaktuar nga aktet rregullative. Aktivitetet likuide janë zgjeruar me ritme të ngjashme në krahasim

²⁸ Fluksi i ri i kredive me probleme gjatë një viti ndaj tepricës së kredive të rregullta në fund të periudhës.

²⁹ Fluksi i ri i kredive me probleme që kanë kaluar në klasat performuese gjatë një viti ndaj tepricës së kredive me probleme në fund të periudhës.

³⁰ Fluksi i ri i kredive të humbura gjatë një viti ndaj tepricës së përgjithshme të kredisë (me përjashtim të kredive të humbura) në fund të periudhës.

vijojnë të qëndrojnë dukshëm mbi kufijtë rregullativë.

Gjatë periudhës, bankat raportojnë raporte thuajse të pandryshuara të aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra dhe aktiveve totale. Në krahasim me një vit më parë, këto raporte kanë rënë lehtë, duke reflektuar rritjen më të shpejtë të kredisë ndaj depozitave.

Hendeku i përgjithshëm për të gjitha maturitetet vijon të jetë pozitiv, në vlerën rreth 5%, dhe nuk ka shënuar ndryshime të dukshme ndaj periudhave të mëparshme.


Diferenca midis afateve mesatare të maturimit të aktiveve dhe të detyrimeve është rritur.

me detyrimet afatshkurtra, dhe treguesi kryesor i rrezikut të likuiditetit nuk ka shfaqur ndryshime të qenësishme në krahasim me nivelin e gjashtëmujorit të kaluar.

Hendeku i përgjithshëm për të gjitha maturitetet vijon të jetë pozitiv, në vlerën rreth 5%, dhe nuk ka shënuar ndryshime të dukshme ndaj periudhave të mëparshme. Sipas segmenteve kohore, bankat kanë raportuar ngushtim të hendekut negativ midis aktiveve dhe pasiveve për maturitetet deri në 3 muaj, dhe zgjerim të atij në shportën 3 muaj – 1 vit. Diferenca midis maturitetit mesatar të mbetur të aktiveve dhe pasiveve u zgjerua, kryesisht si rrjedhojë e rritjes së maturitetit mesatar të mbetur të pasiveve.


Burimi kryesor i financimit të aktivitetit kreditues të bankave mbeten depozitat, që mbulojnë rreth dy herë vëllimin e kredive të sektorit. Në fund të periudhës, raporti “hua/depozita” ishte 49.6%, duke shënuar rritje thuajse të papërfillshme nga gjashtë muaj më parë, ndikuar nga ecuria e kredive në valutë, të cilat u rritën më shpejt se depozitat në valutë. Niveli i këtij treguesi është më i ulët se mesatarja e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe ndjeshëm më i ulët se mesatarja e Bashkimit Evropian. Sipas monedhave, gjatë periudhës, ky raport ishte 57% për Lekun dhe u rrit lehtë në 42.8% (nga 42.1%) për valutën. Të dyja raportet kanë regjistruar rritje që nga fundi i vitit 2023, duke pasqyruar rritjen më të shpejtë të stokut të kredive kundrejt rritjes së bazës së depozitave përgjatë vitit 2024.

Grafik 71. Diferenca në maturimin mesatar të mbetur midis aktiveve-pasiveve dhe kredive-depozitave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 72. Mospërputhja në maturim mes aktiveve dhe detyrimeve³¹



Në krahasim me gjashtë muaj më parë, vëllimi i aktiveve likuide në sektorin bankar, në raport me aktivet e përgjithshme dhe detyrimet afatshkurtra, shfaqet i pandryshuar. Në fund të periudhës, bankat zotëronin një vëllim aktivesh likuide prej rreth 600 miliardë lekësh. Kjo vlerë përfaqëson rreth 29% të totalit të aktiveve në bilanci të bankave dhe ky raport mbeti i pandryshuar në krahasim me gjashtë muaj më parë. Kjo ecuri lidhet me faktin që aktivet likuide dhe aktivet e përgjithshme janë rritur me ritme shumë të ngjashme. Treguesi i aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra, që është subjekt i kufizimeve të

³¹ Janë përfshirë edhe aktivet dhe detyrimet jashtë bilancit.

poshtme sipas rregullores përkatëse për administrimin e rrezikut të likuiditetit³², tregoi gjithashtu ndryshime shumë të vogla, duke regjistruar nivelin 41.8%. Nivelet e këtij treguesi kanë ecur në kahe të ndryshme për raportin aktive likuide/detyrime afatshkurtra në monedhën vendase (në rritje) dhe atë në valutë (në rënie), duke shënuar megjithatë ndryshime jo të rëndësishme. Në krahasim me vlerat e raportuara nga bankat në fund të vitit 2023, ky raport ishte disi më i ulët në fund të vitit 2024, si për monedhën vendase, ashtu edhe për treguesit në valutë.

Gjatë periudhës, në bilancet e bankave është regjistruar zgjerim i aktiveve me afat kontraktual të mbetur deri në tre muaj, ndërkohë që detyrimet e tyre për të njëjtën shportë thuhet nuk kanë ndryshuar. Kjo ecuri bëri që hendeku negativ midis aktiveve dhe detyrimeve për këtë shportë³³ të ngushtohej në 20% të aktiveve të përgjithshme, nga 24% gjashtë muaj më parë. Ky hendek vijon të jetë hendeku më i madh negativ për të gjithë horizontin e maturiteteve. Në të njëjtën kohë, hendeku për maturitetin 3 muaj deri në 1 vit është zgjeruar në -5% nga një vlerë neutrale në fund të gjashtëmujorit të kaluar, kryesisht si rezultat i rritjes së vlerës së pasivit për këtë maturim. Pavarësisht këtyre zhvillimeve, në raport me aktivet e përgjithshme, madhësia e hendekut të përgjithshëm midis aktiveve dhe detyrimeve vijon të mbetet e kufizuar pranë një vlere mesatare prej 5%.

Gjatë periudhës, diferenca midis maturimit mesatar të aktiveve dhe detyrimeve është rritur në 24.3 muaj, nga 22.7 muaj. Kjo ecuri ka ardhur pasi maturiteti i mbetur mesatar i aktiveve është zgjeruar më shpejt kundrejt atij të pasiveve. Diferenca midis maturitetit mesatar të mbetur të huave dhe depozitave u rrit gjithashtu, por më lehtë, në 45.7 muaj (nga 45.1 muaj), pasi maturiteti mesatar i mbetur i huave u rrit relativisht më shpejt. Prej disa gjashtëmujorësh, sektori bankar nuk ka raportuar linja financimi nga grupet zotëruese.

5.1.2.3 Rreziqet e tregut

Rreziku i kursit të këmbimit

Gjatë periudhës, pozicioni i hapur valutor për sektorin bankar nuk shfaqti ndryshime, duke qëndruar "në blerje", sa 4.5% e vlerës së kapitalit rregullator. Kjo ecuri është përcaktuar nga bankat sistemike.

Ekspozimi ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit, i matur nga treguesi i mospërputhjes valutore, u rrit gjatë periudhës, si rezultat i

Në fund të vitit 2024, pozicioni i hapur valutor neto i sektorit bankar ishte "në blerje" në nivelin 4.5% të kapitalit rregullator të sektorit bankar, dukshëm nën kufirin maksimal rregullator prej 30%. Niveli i këtij pozicioni ishte i krahasueshëm me gjashtë muaj më parë (4.6%) dhe në vlerë më të ulët krahasuar me një vit më parë (6.1%). Gjatë periudhës, ky pozicion është luhatur rreth vlerës mesatare prej 4.8%, nga një mesatare prej 5.2% e regjistruar në gjashtëmujorin e parë të vitit dhe 7.3% në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023.

Ecuria e treguesit të përgjithshëm përcaktohet kryesisht nga ecuria e treguesit për bankat me rëndësi sistemike, për të cilat pozicioni i hapur neto valutor "në blerje" ishte sa 5.6% e vlerës së kapitalit rregullator të tyre, nga niveli prej 6.4% gjashtë muaj më parë. Pozicioni i hapur neto i bankave josistemike ishte "në blerje" në nivelin 0.8% të kapitalit rregullator, ose 0.4 p.p. më i lartë në krahasim me gjashtë muaj më parë. Pavarësisht ndryshimit


³² Bankat duhet të mbajnë mjete likuide për mbulimin e 15% të detyrimeve afatshkurtra për Lekun, 20% për valutën, dhe me një kërkesë totale prej 20%.

³³ I llogaritur si raport i "diferencave midis aktiveve dhe pasiveve" ndaj "totalit të aktiveve" për secilën shportë të maturitetit të mbetur. Në vlerën e aktiveve dhe detyrimeve janë përfshirë edhe zërat jashtë bilancit.

zgjërimit të kredisë për rezidentët në valutë, por mbetet nën nivelin e mesatares së 5 viteve të fundit.


të herëpashershëm të kahut të pozicionit të hapur neto, "në blerje" ose "në shitje", ekspozimi i bankave josistemike nuk e tejkalon nivelin prej 2% të kapitalit rregullator të tyre, dhe ky nivel ka mbetur i qëndrueshëm në kohë. Bankat josistemike paraqesin në përgjithësi ekspozim të ulët dhe të qëndrueshëm ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit.

Grafik 73. Pozicioni i hapur valutor ndaj kapitalit rregullator për sektorin bankar dhe grupet




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 74. Ecuria e përbërësve të indeksit të mospërputhjes valutore për sektorin bankar



Grafik 75. Ecuria e indeksit të mospërputhjes valutore për grupet bankare



Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit, i matur me treguesin e mospërputhjes valutore, u rrit lehtë gjatë periudhës, por mbeti nën nivelin e mesatares historike. Në fund të periudhës, treguesi ishte sa 15.1% e aktiveve të sektorit bankar, dhe kjo vlerë ishte 0.2 p.p. dhe 0.7 p.p. mbi vlerat e regjistruara gjashtë muaj dhe një vit më parë, por nën nivelin e mesatares së 5 viteve të fundit (prej 15.7%). Pasivet dhe aktivet në valutë u rritën me ritme të ngjashme, duke u zgjeruar me përkatësisht 4.5% dhe 4.3% gjatë periudhës, ndërsa kredia për rezidentët në valutë u rrit me rreth 5.7%, duke dhënë kontributin kryesor në rritjen e treguesit të përgjithshëm. Treguesi për bankat sistemike reflekton një ekspozim më të ulët në krahasim me sektorin bankar në tërësi. Për këtë grup bankash, treguesi shënoi nivelin 12.0%, dhe ishte në rritje në krahasim me gjashtë muaj dhe një vit më parë me përkatësisht 0.7 p.p. dhe 0.6 p.p. Grupi i bankave josistemike shënon vlera më të larta të indeksit të mospërputhjes valutore, me 20.7% të kapitalit rregullator, dhe kjo vlerë ishte 0.6 p.p. më e ulët krahasuar me gjashtëmuajorin e kaluar dhe 0.5 p.p. më e lartë krahasuar me një vit më parë.

Rreziku i normës së interesit

Treguesi që mat ekspozimin e sektorit bankar ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë të normës së interesit ka shënuar rritje gjatë periudhës, megjithatë mbetet ndjeshëm nën kufirin maksimal rregullator.

Sektorin bankar është më i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit për pozicionet në Lek, ato me


Pozicioni total neto i peshuar i ekspozimeve ndaj normave të interesit në librin e bankës, u rrit gjatë periudhës, duke u ngjitur në 3.7% të vlerës së kapitalit rregullator në fund të saj. Ky nivel është 1.3 p.p. dhe 2.9 p.p. më i lartë në krahasim me nivelin e regjistruar gjashtë muaj dhe një vit më parë, por mbetet dukshëm nën kufirin maksimal rregullator prej 20%. Ecuria e treguesit gjatë periudhës u ndikua nga ndryshimi i kahut të pozicionit të peshuar midis aktiveve dhe pasiveve me normë interesi fikse (FIR) në kahun pozitiv në nivelin 1.2% të kapitalit rregullator, nga kahu negativ (prej 0.1%) që mbante gjashtë muaj më parë. Një vit më parë, diferenca e peshuar e aktiveve me pasivet me normë fikse interesi (FIR) ishte negative në nivelin 1.3% të kapitalit rregullator të sektorit bankar. Pozicioni i peshuar midis aktiveve dhe pasiveve me norma të ndryshueshme të interesit (VIR) regjistroi 2.6% të kapitalit rregullator, nga nivelet 2.5% dhe 2.1% të regjistruar

normë interesi të ndryshueshme dhe për maturitetin afatgjatë.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tërthortë të normës së interesit, i matur me treguesin e spread-it, ka shënuar rënie të lehtë krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë, kryesisht si rezultat i rënies së normave të interesit të kredisë.

përkatësisht gjashtë muaj dhe një vit më parë. Diferenca e peshuar e aktiveve me pasivet me normë të ndryshueshme interesi (VIR) përbën peshën kryesore në pozicionin total neto.

Grafik 76. Pozicioni total neto i peshuar në librin e bankës ndaj kapitalit rregullator



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Treguesi i ekspozimit për bankat sistemike u rrit në nivelin 4.3% të kapitalit rregullator, nga 3.1% dhe 0% përkatësisht gjashtë muaj dhe një vit më parë. Rritja në ekspozimin e përgjithshëm për bankat sistemike u ndikua kryesisht nga rritja e ekspozimit në instrumentet me normë fikse të interesit (FIR), në nivelin 1.2% të kapitalit rregullator³⁴. Për bankat josistemike, pozicioni total neto i peshuar i ekspozimeve ndaj normave të interesit në librin e bankës shënoi 2.7% të kapitalit rregullator të tyre ose 1.4 p.p. dhe 0.4 p.p. më shumë në krahasim me gjashtë muaj dhe një vit më parë. Ecuria e treguesit për bankat josistemike u ndikua nga rritja e ekspozimit në instrumentet me normë fikse të interesit (FIR), e cila për periudhën regjistroi 0.9% të kapitalit rregullator, ose 1.2 p.p. dhe 0.2 p.p. më shumë në krahasim me gjashtë muaj dhe një vit më parë³⁵. Ekspozimi ndaj luhatjes së normës së interesit për instrumentet me normë të ndryshueshme të interesit (VIR) ka shfaqur luhatshmëri më të ulët, për bankat sistemike dhe për ato josistemike. Në fund të vitit 2024, ky tregues shënoi nivelin 3.0% për bankat sistemike dhe 1.7% për bankat josistemike³⁶.

Kontributin kryesor në ekspozimin e bankave ndaj luhatjeve të normave të interesit vijon ta japë pozicioni neto në monedhën vendase. Gjatë periudhës, zgjerimi i pozicionit të përgjithshëm u ndikua nga efekti i kombinuar i zgjerimit të pozicionit të hapur në Lek dhe tkurrja e pozicionit negativ në Euro. Vlera e pozicionit neto në monedhën Lek shënoi 3.8% të kapitalit rregullator ose 0.4 p.p. dhe 1.0 p.p. mbi nivelin e llogaritur gjashtë muaj dhe një vit më parë. Për monedhën evropiane, pasivet vijnë të regjistrojnë vlera më të larta në krahasim me aktivet e ndjeshme ndaj luhatjes së normës së interesit, por kjo diferencë ra me 0.8 p.p. në krahasim me periudhën paraardhëse në nivelin 0.7% të kapitalit rregullator.

Në terma të maturiteteve në pozicionin e bankave, gjatë 12 muajve të fundit, vihet re rritje e ekspozimit për instrumentet me maturitet afatgjatë. Ekspozimi nga shporta me maturim afatgjatë, përfaqëson ekspozimin më të madh dhe mbetet pozitiv, duke qenë se vlera e aktiveve me maturitet


³⁴ Gjashtë muaj më parë, ky tregues ishte 0.0%, ndërsa një vit më parë treguesi mbante vlerë negative (pasivet më të larta se sa aktivet me norma fikse të interesit) në nivelin 2.5% të kapitalit rregullator të bankave sistemike.

³⁵ Gjashtë muaj më parë, ky tregues mbante vlerë negative (pasivet më të larta se sa aktivet me norma fikse të interesit) në nivelin 0.3% të kapitalit rregullator të bankave josistemike.

³⁶ Gjashtë muaj dhe një vit më parë, ky tregues shënonte përkatësisht 3.1% dhe 2.5% për bankat sistemike dhe 1.5% për bankat josistemike.

afatgjatë është më e madhe sesa vlera e detyrimeve afatgjata të bankave. Gjatë periudhës, ky tregues regjistroi nivelin 8.4% të kapitalit rregullator dhe u rrit me 0.6 p.p. dhe 1.0 p.p. në krahasim me gjashtë muaj dhe një vit më parë. Në krahasim me gjashtë muaj më parë, ekspozimi për instrumentet afatshkurtra regjistroi rënie me 0.5 p.p. në nivelin 1.1% të kapitalit rregullator, ndërsa në krahasim me të njëjtën periudhë një vit më parë u rrit me 0.5 p.p. Treguesi i pozicionit neto të peshuar për ekspozimet me maturitet afatmesëm vijon të jetë negativ; ai ishte sa 5.8% e kapitalit rregullator dhe është tkurrur me 1.2 p.p. dhe 1.4 p.p. në krahasim me gjashtë muaj dhe një vit më parë.

Grafik 77. Pozicioni neto i peshuar sipas monedhave (majtas) dhe afatit (djathtas) ndaj kapitalit rregullator, në %



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Treguesi i rrezikut të tërthortë³⁷ ndaj ndryshimit të normave të interesit, i matur me spread-in e normave të interesit midis kredive dhe depozitave të reja³⁸, paraqitet disi më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë. Spread-i i normave të interesit shfaqti luhatshmëri të ulët gjatë periudhës, midis vlerave 4.9-5.1%, dhe në muajin dhjetor regjistroi vlerën 4.9%. Ky nivel ishte i ngjashëm me atë të gjashtë muajve më parë, për arsye se normat e interesit të kredive dhe të depozitave të reja ranë thajse në të njëjtën masë gjatë periudhës (me nga 0.5 p.p.). Krahasuar me fundin e vitit 2023, spread-i ra me 0.3 p.p., si rezultat i uljes së normës të interesit të kredive dhe të depozitave me përkatësisht 0.4 p.p. dhe 0.1 p.p.

Spread-et mesatare u ngushtuan për të gjitha monedhat kryesore (Lek, Euro dhe USD), kryesisht si rezultat i rënies së normave të interesit të kredisë për këto monedha, në krahasim me një vit më parë. Krahasuar me një vit më parë, spread-et e monedhave Lek, Euro dhe USD u ngushtuan me përkatësisht 0.2, 0.6 dhe 2.1 p.p., në nivelet 4.9%, 4.8% dhe 3.9%, ndikuar nga rënia e normave të interesit të kredisë, ndërkohë që normat e interesit të depozitave të reja patën ndryshime relative më të vogla. Në terma mesatare gjashtëmujorë, vetëm spread-i për monedhën vendase u zgjerua krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit me 0.4 p.p., si rezultat i rritjes së normës mesatare të interesit të kredisë (me 0.2 p.p.) në nivelin 6.9% dhe uljes së normës mesatare të interesit të depozitave (me 0.2 p.p.) në nivelin 2%. Spread-i për monedhën USD paraqet luhatshmëri relative më të lartë, por pesha më e vogël e monedhës amerikane në depozitat dhe kreditë e reja bën që kontributi i kësaj monedhe në nivelin e spread-it të përgjithshëm të jetë i kufizuar.

³⁷ Ky rrezik i referohet ndikimit që ndryshimi në normën e interesit jep te klientët e bankave. Për shembull, pavarësisht se rritja e normës së interesit mund të ketë një ndikim pozitiv mbi bilancin e bankës (për shkak të vlerës pozitive të pozicionit neto mes aktiveve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit), kjo rritje do të ketë efekt negativ tek aftësia paguese e huamarrësve të bankës, kur kredia është dhënë me normë interesi të ndryshueshme (rreziku i tërthortë). Megjithatë, ky efekt supozohet që kompensohet në masën më të madhe, nëse në krahun tjetër kemi një rritje të normës së interesit për depozitat.


³⁸ Bazuar në të dhënat e statistikave të interesit sipas standardit të ri metodologjik për statistikën e harmonizuar të normave të interesit të institucioneve monetare financiare, bazuar në rregulloren "Për raportimet në Bankën e Shqipërisë të statistikave të normave të interesit" me vendim nr. 48, datë 6.9.2017.

Grafik 78. Norma e peshuar e interesit të kredisë dhe depozitave dhe spread-i i normave të interesit, në %



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 79. Diferenca e normave të peshuara të interesit të kredisë me depozitat, sipas monedhave, në p.p.



Në kushtet kur pozicioni neto i peshuar i bankave vijon të dominohet nga pozicioni në instrumente me normë të ndryshueshme interesi, luhatshmëria e normave të interesit do të ketë ndikim në cilësinë e kredisë. Lëvizja e normave të interesit shoqërohet me rritjen e luhatshmërisë së spread-eve dhe mund të sjellë ndryshime në pozicionin e peshuar neto të bankave për maturitete, monedha dhe lloje të caktuara instrumentesh. Për këtë arsye, në varësi të skenarëve, nevojitet rritja e vëmendjes së bankave ndaj ndikimit të këtyre faktorëve mbi aftësinë paguese të huamarrësve me kredi me norma interesi të ndryshueshme, veçanërisht për segmente ku ekspozimet janë më të mëdha ose po rriten më shpejt.

4.1.3 Rezistenca e sektorit bankar

5.1.3.1 Prova e rezistencës për mjaftueshmërinë e kapitalit

Rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës së aftësisë paguese tregojnë se sektori bankar paraqitet i qëndrueshëm ndaj goditjeve makroekonomike të supozuara ndaj skenarëve të rrezikut për periudhën ushtrimore.

Ndjeshmëria e sektorit bankar është përmirësuar në krahasim me një vit më parë, pasi numri i bankave që do të kishin nevojë për të forcuar pozicionet e tyre të kapitalit dhe vlera e nevojshme e kapitalit, në skenarët më pak të favorshëm, ka rënë.


Rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës për mjaftueshmërinë e kapitalit tregojnë se sektori bankar paraqitet i qëndrueshëm ndaj goditjeve makroekonomike dhe se ndjeshmëria e tij ndaj zhvillimeve të pafavorshme është zbutur kundrejt një viti më parë. Gjithsesi, një numër i kufizuar bankash paraqet ndjeshmëri të shtuar ndaj supozimeve më ekstreme.

Prova e rezistencës për mjaftueshmërinë e kapitalit tregon shkallën e qëndrueshmërisë së bankave individuale në terma të kapitalit dhe synon të evidentojë aftësinë e sektorit në përballimin e goditjeve të supozuara mbi rritjen ekonomike dhe papunësinë, ecurinë e kursit të këmbimit, volumet dhe cilësinë e portofolit të kredisë, nivelin e normave të interesit dhe ecurinë e çmimeve të aktiveve jofinanciare.

Ushtrimi ndërtohet mbi tre skenarë - skenarin bazë, skenarin e moderuar dhe atë të rënduar - dhe periudha ushtrimore shtrihet deri në fund të vitit 2026. Skenari bazë supozon një rritje ekonomike pozitive gjatë këtij harku kohor, e cila shoqërohet me një rritje pozitive të kreditimit, mbiçmim të monedhës vendase dhe rënie të papunësisë. Në skenarin e moderuar, rritja ekonomike mbetet në territor pozitiv gjatë periudhës ushtrimore, por norma e rritjes është më e ulët kundrejt skenarit bazë. Ndërsa, në skenarin e rënduar, duke filluar që nga tremujori i tretë i vitit 2026, norma e rritjes ekonomike supozohet të jetë negative.

Në skenarin e moderuar dhe atë të rënduar, shtohen edhe supozimet për nënçmimin e kursit të këmbimit, rritjen e normave të interesit dhe ngadalësimin e ritmit të kreditimit, duke kaluar në një ndalim të kreditimit përgjatë vitit të fundit ushtrimor. Këto zhvillime reflektohen në një përkeqësim të cilësisë së portofolit të kredisë, si për individët ashtu edhe për bizneset. Ky përkeqësim paraqitet më i ndjeshëm për portofolin e biznesit.

Grafik 80. Projektionet mbi treguesit kryesorë (lart) dhe treguesit e rinj makroekonomikë (poshtë)



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Tregues të tjerë makroekonomikë të përfshirë në ushtrim, në skenarët më të pafavorshëm supozojnë një rënie të çmimeve të banesave dhe rritje të papunësisë deri në fund të periudhës. Këto supozime ndikojnë në nivelin e kapitalizimit të bankave të veçanta dhe të sektorit bankar në tërësi, kryesisht gjatë vitit 2026.

Në terma të mjaftueshmërisë së kapitalit, rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës tregojnë se:

- në skenarin bazë, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (RMK) të sektorit bankar vlerësohet në rreth 23%, deri në fund të vitit 2026. Këto zhvillime tregojnë një qëndrueshmëri dhe nivele të mira të kapitalizimit të të gjithë sektorit bankar. Bankat nuk paraqesin nevojë për injektim kapitali në këtë skenar;
- në skenarin e moderuar, RMK-ja për sektorin bankar bie në rreth 22% në fund të vitit 2026, duke vijuar të ruajë nivele të mira përgjatë gjithë periudhës ushtrimore. Në këtë skenar, vetëm një prej bankave të sektorit paraqet nevojën për injektim kapitali dhe pesha e aktiveve të saj në aktivet e sektorit bankar arrin në rreth 2.3%. Në këtë rast, nevojat për injektim kapitali vlerësohen në rreth 180 milionë lekë, ose sa rreth 0.01% e PBB-së;
- në skenarin e rënduar, sektori bankar vijon të jetë i mirëkapitalizuar deri në fund të vitit 2026, me një RMK prej rreth 21%. Në këtë rast, numri i bankave që kanë nevojë për injektim kapitali arrin në tre dhe


pesha e aktiveve të tyre në aktivet e sektorit bankar arrin në rreth 21%. Në këtë rast, nevojat për kapital shtesë vlerësohen të jenë rreth 4.4 miliardë lekë ose sa 0.2% e PBB-së.

Grafik 81 . Vlerat e RMK-së përgjatë harkut kohor ushtrimor



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 82. Kontributi në ndryshimin e RMK-së i zërave kryesorë të bilancit për skenarin e rënduar (fund 2026)



Në këtë skenar, për bankat me rëndësi sistemike dhe ato josistemike, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit arrin në përkatësisht 21.6% dhe 19.3%. Grupi i bankave me kapital të huaj paraqet një nivel kapitalizimi prej rreth 23%, duke mbetur i mirëkapitalizuar, ndërsa grupi i bankave me kapital vendas ka një RMK më të ulët prej rreth 17%. Kontribut kryesor në rënien e kapitalizimit në skenarin e rënduar në fund të vitit 2026 e jep zëri "Humbja nga huatë" dhe rënia e "Të ardhurave të tjera".

Rezultatet tregojnë se, pavarësisht ndjeshmërisë së bankave të veçanta, sektori bankar paraqitet i qëndrueshëm ndaj goditjeve makroekonomike dhe qëndrueshmëria e tij ndaj zhvillimeve të pafavorshme është më e fortë sesa një vit më parë. Numri i bankave që paraqet nevojë për shtim kapitali në skenarin më ekstrem është tre, kundrejt katër bankave që rezultojnë një vit më parë. Për rrjedhojë, edhe nevojat për kapital shtesë vlerësohen të jenë ulur në 0.2% të PBB-së, nga 0.34% një vit më parë.

5.1.3.2 Ushtrimi i provës së rezistencës së likuiditetit

Rezultatet e ushtrimit tregojnë se rezistenca e sektorit bankar ndaj goditjeve të mundshme të likuiditetit, sipas të dhënave të muajit nëntor 2024, për horizontin kohor 2025-2026, paraqitet pothuajse e njëjtë me atë të një viti më parë.

Në terma të hyrjeve dhe daljeve të përgjithshme të parasë, ushtrimi tregon një dobësim të lehtë në drejtim të daljeve në monedhat Lek dhe Euro, që pritet të jenë më të larta, dhe një rënie të

Prova e rezistencës së likuiditetit ka për qëllim të vlerësojë aftësinë e bankave individuale dhe të sektorit bankar në përgjithësi, për t'iu bërë ballë goditjeve ekstreme, por të mundshme, në financimin e veprimtarisë së tyre. Prova e rezistencës së likuiditetit realizohet sipas përjasjes "nga lart – poshtë" me të dhëna të raportuara nga bankat një herë në vit, në fund të vitit. Ushtrimi përdor të dhëna mbi flukset e parashikuara hyrëse dhe dalje të parasë, sipas instrumenteve kryesore dhe për një horizont kohor të përbërë nga 8 shporta maturimi që mbulojnë intervalin nga "deri në 1 ditë" deri në "mbi 1 vit dhe deri në 2 vjet".

Prova kryhet për monedhat Lek, Euro dhe USD dhe mbështetet në kushtin që tepricat e likuiditetit në një monedhë nuk mund të përdoren për të plotësuar mungesën e likuiditetit në monedhat e tjera, për shkak të probabilitetit të zhvlerësimit të shpejtë të kursit të këmbimit gjatë krizave të likuiditetit. Për llogaritjen e hendekut të likuiditetit përdoren koeficientë të përcaktuar për tërheqjet e burimeve të financimit (të depozitave) dhe për riinvestimin e aktiveve (kredive, vendosjeve), sipas të

lehtë të flukseve hyrëse në monedhën Euro.

Pavarësisht pritjeve për thellim të hendekut të thjeshtë të likuiditetit për shkak të pakësimit të hyrjeve dhe rritjes së daljeve të parasë, rezistenca individuale e bankave vijon të mbetet e mirë, për shkak të nivelit të përshtatshëm të aktiveve likuide që bankat mund të përdorin për të gjeneruar likuiditet në kushte stresi.

gjitha shportave të maturimit. Për burimet e financimit, koeficienti tregon vetëm atë pjesë të shumës së detyrimeve që maturohet në shportën përkatëse, e cila do të tërhiqet dhe nuk do të riinvestohet nga klienti. Për hyrjet e parasë, koeficientët e riinvestimit nënkuptojnë atë pjesë të shumës së të drejtave që maturohen në shportën përkatëse, e cila do të konvertohet në fluks hyrës parash dhe nuk do të riinvestohet nga banka. Një bankë konsiderohet se dështon në ushtrimin e provës së rezistencës vetëm nëse aktivet likuide të zgjeruara, që shiten me marzhe reduktuese të përcaktuara nga ushtrimi, bien deri në nivelin ku ka nevojë për likuiditet shtesë nga Banka e Shqipërisë, në formën e “kredisë për mbështetje me likuiditet”.

Megjithëse, mbi bazën e zhvillimeve të vitit të fundit dhe supozimeve përkatëse vërehet rritje e hendeqeve, si rezultat i rënies së flukseve hyrëse dhe rritjes së flukseve dalëse, rezultatet e ushtrimit tregojnë që rezistenca e sektorit bankar ndaj goditjeve të mundshme të likuiditetit mbetet e mirë në sajë të pranisë së bollshme (dhe përdorimit eventual) të kapaciteteve kundërpeshuese. Më konkretisht, mbështetur në të dhënat e muajit nëntor 2024, dhe duke i ndërtuar supozimet për horizontin kohor 2025-2026, vërehet se flukset e pritura hyrëse dhe dalëse të parasë gjatë dy vjetëve të ardhshme llogariten përkatësisht 2% më pak dhe 9% më shumë sesa vlerat e pritura një vit më parë. Përkeqësimi i pritshëm si në kahun e hyrjeve, ashtu edhe në kahun e daljeve, mund të rezultojë në një thellim të diferencës hyrje-dalje prej rreth 25% në krahasim me vlerën e një viti më parë.

Hendeqet negative për Lekun dhe Euron rezultojnë përkatësisht 28% dhe 23% më të larta në krahasim me një vit më parë. Rritja në totalin e flukseve dalëse vërehet në të dyja monedhat kryesore, Lek dhe Euro, por rritja për monedhën vendase (12%) shfaqet disi më e lartë në krahasim me atë për monedhën Euro (7%). Hyrjet e pritura të parasë në monedhën Euro paraqiten rreth 6% më pak, ndërsa hyrjet e pritura nga kreditë dhe investimet e bankave në monedhën Lek paraqiten të krahasueshme me ato të një viti më parë.

Në krahasim me vitin e kaluar, hendeku i thjeshtë i likuiditetit³⁹ paraqitet pothuajse i pandryshuar për të tri monedhat sipas të dyja dimensioneve të krahasimit, që janë numri i bankave dhe madhësia e hendekut në raport me aktivet në atë monedhë. Situata e likuiditetit përpara përdorimit të *cash*-it dhe kapaciteteve kundërpeshuese, matur nga hendeku i thjeshtë i likuiditetit, paraqitet më e dobët për monedhën Lek, si për nga numri maksimal i bankave me hendek të thjeshtë të likuiditetit (HTL) negativ (11 nga 11 për shportën e dytë), ashtu edhe për nga madhësia maksimale e hendekut (7% e aktiveve në Lek në krahasim me 1-2% të aktiveve në Euro dhe USD).

Pas përdorimit të kapaciteteve kundërpeshuese (tituj që mund të likuidohen për të mbyllur hendekun më sipër), situata e bankave të sektorit përmirësohet ndjeshëm, duke qenë se numri i bankave që vijnë në të kenë hendek negativ për të paktën një shportë, bie në 1 bankë (nga përkatësisht 11 dhe 7 banka), për monedhat Lek dhe USD, dhe në 2 (nga 8) banka për shportën e parë në monedhën Euro. Për monedhën

³⁹ Hendeku i thjeshtë i likuiditetit llogaritet si diferenca midis flukseve të pritura hyrëse dhe dalëse të shumëzuara me koeficientët e tërheqjes (për burimet e financimit/depozitat) dhe të riinvestimit (për aktivet/kreditë) për çdo shportë të maturitetit të mbetur për secilën nga monedhat.

Lek, bankat kanë përgjithësisht një hendek më të madh negativ midis hyrjeve dhe daljeve, në krahasim me monedhën Euro, veçanërisht për shportat me maturitet deri në 2 muaj, por aktivet likuide që bankat mund të përdorin për të mbuluar hendekun e likuiditetit në monedhën në Lek janë disi më të larta, në krahasim me ato në Euro. Rezultatet tregojnë një situatë dukshëm të përmirësuar edhe për banka që në vitet e kaluara kanë shfaqur dobësi në mbylljen e hendekut të likuiditetit në një ose më shumë monedha, ndërkohë që për bankat që nuk e kalojnë provën, madhësia e hendekut të mbetur është mesatarisht sa 2% e aktiveve të saj në monedhën përkatëse.

5.1.3.3 Perceptimi i sektorit bankar mbi rrezikun sistematik

Vrojtimi i sektorit bankar lidhur me perceptimin e rreziqeve sistemike në vend gjatë periudhës, tregon një rritje të ndjeshmërisë lidhur me rreziqet sistemike me natyrë makroekonomike, nxitur nga faktorë të jashtëm dhe të brendshëm, dhe zbutje të perceptimit mbi rreziqet e tregut dhe të infrastrukturës.

Bankat kanë vlerësuar "rrezikun e goditjeve nga jashtë", rrezikun e goditjeve kibernetike, dhe rrezikun prej ekspozimeve në tregun e pasurive të paluajtshme, si rreziqet kryesore sistemike për periudhën.

Mundësia e materializimit të një/ose disa prej rreziqeve të rëndësishme sistemike në të ardhmen afatshkurtër vlerësohet nën nivelin mesatar dhe në rënie, si për periudhën afatshkurtër, ashtu edhe në një horizont më të gjatë kohor.

Impakti i materializimit të këtyre rreziqeve zbutet, për shkak të rezervave të bollshme financiare të sektorit bankar. Për këtë arsye, besimi i bankave në qëndrueshmërinë e sistemit financiar në të ardhmen mbetet mbi nivelin mesatar dhe në rritje.


Rezultatet e vrotimit mbi perceptimin e rreziqeve sistemike në vend nga industria bankare tregojnë një renditje dhe vlerësim të ndryshuar të këtyre rreziqeve gjatë periudhës, ku vihet një prioritet në rritje e rreziqeve makroekonomike, ndërkohë që vlerësimi për rreziqet e kredisë, të tregut dhe infrastrukturës financiare, ka qenë në zbutje.

Gjatë periudhës, sektori bankar ka vijuar të klasifikojë "rrezikun e goditjeve nga jashtë" si rrezikun kryesor sistematik, por me një vlerësim më të lartë. Pavarësisht zhvillimeve përgjithësisht pozitive globale lidhur me inflacionin dhe kushtet e financimit në tregje, faktorë të tjerë si vijimi i tensioneve gjeopolitike (veçanërisht konflikti në Rripin e Gazës dhe mundësia e përshkallëzimit të tij në rajon, si dhe vazhdimi i luftës në Ukrainë), zgjedhjet presidenciale në SHBA dhe pasiguria lidhur me qëndrimet dhe politikat e administratës së re, duket se kanë mbajtur të lartë shqetësimin e bankave në vend mbi rrezikun e transferimit të goditjeve të mundshme negative nga jashtë, duke e klasifikuar atë si rrezikun sistematik më të rëndësishëm të periudhës.

"Rreziku nga sulmet kibernetike" ka vijuar të renditet i dyti në listën e rreziqeve më të rëndësishme gjatë periudhës, por vlerësimi për të është zbutur lehtë. Rritja e digjitalizimit të aktivitetit bankar në vend ka rritur njëkohësisht dhe rrezikun nga sulmet kibernetike, episodet e të cilave kane qenë të pranishme në vitet e fundit, duke dëmtuar herë pas here vijimin normal të aktivitetit. Kjo ka bërë që fokusi i bankave mbi këtë rrezik të mbetet i lartë dhe një pjesë e mirë e tyre deklarojnë se kanë ndërmarrë tashmë masa konkrete për përmirësimin e sistemeve përkatëse të mbrojtjes.

Një tjetër rrezik sistematik që duket se po merr gjithmonë e më shumë vëmendje së fundi është "rreziku lidhur me luhatjen e vlerës së pasurive të paluajtshme", i cili është renditur si rreziku i tretë më i rëndësishëm sistematik. Dinamikat e kohëve të fundit në tregun e pasurive të paluajtshme dhe rritja e shpejtë e çmimeve, duket se kanë rritur shqetësimin e bankave lidhur me ecurinë e ardhme të tyre, në kushtet kur një pjesë e konsiderueshme e portofoleve të tyre të kredisë është e ekspozuar me aktivitetin e këtij tregu. Kjo është reflektuar dhe në rritjen e shpejtë të vlerësimit të këtij rreziku gjatë periudhës.

Grafik 83. Vlerësimi i bankave mbi rreziqet kryesore sistemike



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ndryshe nga dy vërtetimet e kaluara, vlerësimi i bankave mbi "rrezikun e përkeqësimit të ekonomisë së brendshme" ka qenë në rritje gjatë periudhës, duke e ripërshirë në grupin e rreziqeve kryesore sistemike. Rritja e rrezikut të goditjeve të jashtme mbi zhvillimet e brendshme ekonomike, duket se është reflektuar dhe në rritjen e perceptimit të bankave lidhur me mundësinë e përkeqësimit të ekonomisë në vend. Së fundi, zhvillimet politike në vend dhe afrimi i zgjedhjeve parlamentare, duket se kanë ndryshuar perceptimin e bankave mbi rëndësinë e "rrezikut politik", vlerësimi për të cilin është rritur ndjeshëm krahasuar me periudhat e kaluara, duke u përfshirë në grupin e rreziqeve kryesore sistemike. Veç të tjerave, bankat e shohin këtë rrezik veçanërisht të lidhur me aftësinë paguese të klientëve të përfshirë në kontrata publike.

Në terma të përgjithshëm, bankat perceptojnë se mundësia e materializimit të një (ose disa) prej rreziqeve të lartpërmendura në të ardhmen afatshkurtër (deri në një vit) dhe atë afatmesme (1-3 vjet), momentalisht është nën nivelin mesatar dhe në rënie. Pavarësisht sfidave të momentit, situata e mirë e kapitalizimit dhe likuiditetit të sektorit ka bërë që besimi i bankave në qëndrueshmërinë e sistemit financiar në të ardhmen të mbetet mbi nivelin mesatar dhe në rritje.

4.2 Sektori jobankar

4.2.1 Ecuria e sektorit jobankar

Gjatë gjysmës së dytë të vitit, segmentet e tjera të sistemit financiar kanë regjistruar zgjerim të aktivitetit.

Të gjitha segmentet e sistemit financiar të ndryshme nga bankat kanë regjistruar rritje të aktivitetit gjatë gjysmës së dytë të vitit⁴⁰. Kontributin kryesor e kanë dhënë zgjerimi i aktivitetit të institucioneve financiare jobanka, fondeve të investimit dhe të pensionit. Sektori jobankar ka ruajtur të pandryshuar peshën ndaj totalit të aktiveve të


⁴⁰ Baza e të dhënave të subjekteve të sektorit jobankar i përket tremujorit të katërt të vitit 2024, me përjashtim të bilancit të shoqërive të sigurimit që i përket tremujorit të tretë të vitit 2024.

Institucionet financiare të ndryshme nga bankat vijojnë të mbeten të mirëkapitalizuara dhe me një cilësi të mirë të portofolit të kredisë për institucionet kredituese.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar mbetet i ulët, por ka shënuar një rritje të lehtë në terma vjetorë, ndërsa ndjeshmëria e sektorit jobankar ndaj veprimitarisë së sektorit bankar mbetet e lartë dhe në rritje.

sistemit financiar në nivelin 10% dhe peshën prej 9% ndaj PBB-së së vendit. Struktura e sektorit jobankar vijon të dominohet nga institucionet financiare jobanka që mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë, të ndjekura nga fondet e investimit dhe shoqëritë e sigurimit që licencohen dhe mbikëqyren nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF).

Grafik 84. Struktura e sektorit jobankar



Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Aktualisht, në tregun financiar operojnë 40 IFJB, nga të cilat: 25 subjekte janë institucione të kredisë, mikrokredisë, faktoringut, qirasë financiare, blerjes së kredive me probleme etj.; 5 subjekte janë institucione pagesash; dhe 10 janë institucione të parasë elektronike. Aktiviteti kryesor i IFJB-ve është ai kreditues (26%), ndjekur nga shërbimet për ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve (17%), si dhe pagesa dhe transferata dhe shërbime të këmbimit valutor (me 16%). Në sistemin financiar operojnë gjithashtu 16 SHKK dhe një Union, 13 shoqëri sigurimi, 14 fonde investimi dhe 6 fonde pensioni. Peshën kryesore në veprimtarinë e sektorit jobankar e zë aktiviteti i institucioneve financiare jobanka, ndjekur nga fondet e investimit.

Institucionet financiare jobanka që ushtrojnë veprimtarinë e kreditimit⁴¹ raportuan zgjerim të aktivitetit, performancë të mirë financiare dhe nivel të mirë të kapitalizimit. Totali i aktiveve të tyre u shtua me rreth 6 miliardë lekë, duke u ngjitur në nivelin 75 miliardë lekë. Sipas sektorëve të ekonomisë, sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë dhe i aktiviteteve të tjera të shërbimit, janë sektorët më të financuar prej tyre (me nga rreth 17% dhe 13% të totalit të stokut për bizneset), ndjekur nga ndërtimi (12%). Kredia dhënë individëve zë 51% të totalit të kredisë dhe pjesa tjetër u takon bizneseve. Cilësia e kredisë shënoi një rënie të lehtë gjatë periudhës, dhe RKP-ja u ngjiti në nivelin 12.2%, nga 11.7% në pjesën e parë të vitit 2024. IFJB-të e mbyllën vitin me një rezultat financiar pozitiv (5.5 miliardë lekë) dhe më të lartë se ai i një viti më parë (4.8 miliardë lekë). Kapitalizimi i veprimtarisë së këtyre subjekteve vijon të mbetet i lartë. Rreth 79% e kapitalit të paguar të institucioneve jobanka që ushtrojnë veprimtarinë e kreditimit është kapital vendas.

Veprimtaria e institucioneve të pagesave dhe parasë elektronike (IPE) u tkurr me 4 miliardë lekë përgjatë vitit, në nivelin 32 miliardë lekë. Aktualisht, numërohen 5 subjekte që ushtrojnë veprimtarinë e pagesave dhe 10 subjekte që ushtrojnë aktivitetin e parasë elektronike. Aktivitetet e IPE-ve zënë rreth 30% të totalit të aktiveve të IFJB-ve, ndërsa pjesa tjetër i përket institucioneve që ushtrojnë veprimtarinë e kreditimit. Peshën kryesore në aktivitetin e tyre e zënë investimet në banka, në formën e llogarive rrjedhëse dhe garancie (36%), ndjekur nga shërbimet e pagesave me klientët (34%) dhe investimet në letrat me vlerë në


⁴¹ Të gjitha format e kredidhënies, mikrokredi, qira financiare, faktoring, blerje kredi me probleme.

formën e aksioneve (15%). Performanca financiare e IPE-ve ishte pozitive, duke raportuar një fitim financiar prej 2 miliardë lekësh.

Shoqëritë e kursim-kreditit shënuan rritje të vëllimit të aktiveve. Ky segment ka shënuar rënie të lehtë në cilësinë e portofolit të kredisë krahasuar me fundin e një viti më parë, me RKP që rezultoi në nivelin 4.8% në fund të periudhës, nga 4.7% gjashtë muaj më parë. Në portofolin e investimeve të SHKK-ve, peshën kryesore e zënë investimet në kredi (78%) dhe investimet në banka, në formën e llogarive rrjedhëse (15%). Sektori që ka tërhequr pjesën më të madhe të financimit është sektori i bujqësisë (23%), i ndjekur nga sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë (15%). SHKK-të e mbyllën periudhën me një fitim neto pozitiv.


Shoqëritë e sigurimit, fondet e investimit dhe pensionit zgjeruan aktivitetin e tyre, si rrjedhojë e rritjes së primeve të shkruara bruto dhe investimeve në letrat me vlerë të borxhit të qeverisë.

Grafik 85. Pozicioni neto i sektorit jobankar, sipas subjekteve në vite



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 86. Shpërndarja e mjeteve, detyrimeve dhe pozicionit neto, sipas subjekteve të sektorit jobankar (shtator 2024)



Sektori jobankar vijon të mbajë një pozicion të balancuar të aktiveve dhe detyrimeve financiare⁴².

Aktivitet kryesor janë kreditë dhe letrat me vlerë të borxhit, ndërsa detyrimet përfaqësohen nga kapitali dhe aksionet në fondet e investimit dhe huatë e marra. Sektori jobankar ka zgjeruar pozicionin neto kreditor në raport me fundin e një viti më parë, ndikuar nga shtimi i mjeteve të ndërmjetësve të tjerë financiarë (fond investimi, institucion financiar jobankë) në formën e investimeve në letrat e borxhit të qeverisë dhe huave. Brenda sektorit jobankar, fondet e investimit dhe shoqëritë e sigurimit me fondet e pensionit kanë një pozicion neto negativ (debitor), ndërsa ndërmjetësit e tjerë financiarë (jobankat dhe SHKK-të) kanë një pozicion neto pozitiv (kreditor). Për nënsektorët e fondeve të investimit dhe shoqërive të sigurimit me fondet e pensionit, pozicioni debitor në fund të tremujorit të tretë të vitit 2024 ishte sa 5% e totalit të aktiveve të sektorit jobankar.


Kredia dhe letrat me vlerë të borxhit vijojnë të zënë peshën kryesore në aktivet e subjekteve financiare të ndryshme nga bankat. Ato zënë 28% të aktiveve të sektorit jobankar, ndjekur nga investimet në tituj të borxhit që zënë 27% të aktiveve financiare të sektorit jobankar dhe monedhat e depozitat që zënë 20%.

Megjithatë, këto raporte janë të ndryshme për subjektet e këtij sektori. Për fondet e investimit, letrat me vlerë të borxhit përfaqësojnë rreth 87% të aktiveve të tyre, ndërkohë që për ndërmjetësit e tjerë financiarë peshën më të madhe e zënë huatë me rreth 51%. Shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit të marra së bashku, kanë shpërndarjen më heterogjene të aktiveve, të cilat janë të vendosura në monedha dhe depozita

⁴² Analiza për aktivet dhe detyrimet e sektorit jobankar është mbështetur në të dhënat e llogarive financiare për tremujorit të tretë të vitit 2024.


(35%), letra me vlerë të borxhit (26%), sigurime dhe skema pensionesh (14%), si dhe në kapital dhe aksione në fonde investimi (14%). Sipas instrumenteve, sektori jobankar ka një pozicion neto debitor për kapitalin dhe aksionet në fondet e investimit, në sigurime dhe skema pensionesh, dhe një pozicion neto kreditor për letrat me vlerë të borxhit, huatë dhe monedha e depozita.

Grafik 87. Pozicioni neto i sektorit jobankar, sipas instrumenteve në vite



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 88. Ndërlidhja e sektorit jobankar me sektorin bankar, shtator 2024



4.2.1 Rreziqet dhe ekspozimet midis sektorit bankar dhe jobankar

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar mbetet i ulët, por ka shënuar një rritje të lehtë në terma vjetorë. Në krahun e aktivitet të bankave, ekspozimi ndaj sektorit jobankar përfaqësohet kryesisht nga huatë akorduar institucioneve financiare jobankare. Ndërmjetësit financiarë (jobankat dhe ShKK-të) janë segmentet më të financuara nga sektori bankar, me një stok kredie prej 23 miliardë lekësh, ndjekur nga kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensionit me kredi në vlera mjaft të ulëta. Stoku total i financuar nga sektori bankar është rreth 23 miliardë lekë dhe zë 1.1% të vlerës së bilancit të sektorit bankar, nga 0.92% një vit më parë.

Ndjeshmëria e sektorit jobankar ndaj veprimtarisë së sektorit bankar mbetet e lartë dhe në rritje.

Pretendimet e sektorit jobankar ndaj bankave janë në formën e vendosjeve (llogari rrjedhëse, depozita me apo pa afat). Stoku i fondeve të vendosura pranë bankave deri në fund të tremujorit të tretë ishte rreth 61 miliardë lekë, ose sa 28% e aktiveve të sektorit jobankar. Vendosjet më të mëdha pranë sektorit bankar, ose 61% të totalit, i kanë ndërmjetësit e tjerë financiarë (jobanka, ShKK), dhe ato janë rritur krahasuar me fundin e një viti më parë. Në raport me aktivet e tyre, shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit kanë ekspozimin më të madh ndaj sektorit bankar, pasi vendosjet e tyre në banka përbëjnë rreth 35% të aktiveve të tyre. Sektori jobankar ka zgjeruar pozicionin e tij kreditor neto me bankat në nivelin 38 miliardë lekë, nga 34 miliardë lekë në fund të qershor 2024. Zgjerimi i pozicionit neto rrit ndjeshmërinë e sektorit jobankar ndaj ecurisë së aktivitetit të sektorit bankar. Pozicionin neto kreditor më të lartë e kanë shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit, duke qenë se kanë më shumë pretendime në sektorin bankar krahasuar me detyrimet, ndjekur nga ndërmjetësit e tjerë financiarë. Ekspozimi i sektorit jobankar ndaj sektorit bankar monitorohet rregullisht nga Banka e Shqipërisë, në kuadrin e vlerësimit periodik të rreziqeve sistemike dhe monitorimit të përmbushjes së objektivave të ndërmjetëm të politikës makroprudenciale.

Rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës ndaj rrezikut të përhapjes tregojnë që segmente dhe subjekte të veçanta të sektorit jobankar janë të rrezikuara në rastin e goditjeve nga sektori bankar dhe nga banka të veçanta. Ushtrimi tregon që, në tërësi, sektori bankar është i mbrojtur nga goditjet që mund të vijnë nga sektori jobankar, në rast të dështimit ushtrimor të një apo të të gjitha subjekteve të një

segmenti të marra së bashku. Madhësia e kufizuar e ekspozimeve të ndërsjellta midis bankave dhe jobankave, si dhe niveli i mirë i tepricës së kapitalit të bankave, zbusin shkallën e përhapjes së rrezikut për shkak të ndërlidhjes. Nga ana tjetër, institucionet financiare jobanka dhe ShKK-të shfaqin ndjeshmëri relativisht të lartë ndaj sektorit bankar, pasi goditje ekstreme nga sektori bankar, kanë potencialin që të shkaktojnë dështim të disa subjekteve dhe vështirësi financiare nga këndvështrimi i uljes së aftësisë paguese të tyre. Për shoqëritë e sigurimit, asnjë goditje me origjinë nga sektori bankar nuk shkakton dështim ushtrimor në shoqëritë e sigurimit, duke qenë se këto të fundit kanë pozicione të mira të kapitalit në krahasim me shkallën e ekspozimit të tyre. Industria e fondeve dhe e shoqërive administruese të fondeve të investimit nuk paraqet rrezik për shëndetin e bankave. Nga ana tjetër, asnjë goditje e ardhur nga sektori bankar nuk rezulton në dështimin e ndonjë subjekti nga segmenti i fondeve të investimit, ndërkohë që shoqëritë administruese të fondeve paraqiten më të ekspozuara nga dështimi ushtrimor i bankave. Asnjë goditje me origjinë nga sektori bankar nuk shkakton falimentim në asnjë subjekt të sektorit të pensioneve dhe shoqërive administruese dhe anasjelltas. Ky rezultat shpjegohet me faktin që, pavarësisht se ekspozimet e këtyre segmenteve ndaj bankave janë të larta në raport me aktivet e veta, kapitali i tyre është në nivele të mjaftueshme për të përthithur humbjet e shkaktuara nga goditjet e përcjella.

5 Politika makroprudenciale dhe rreziqet sistemike


Parandalimi dhe zbutja e përhapjes së rreziqeve sistemike përbëjnë objektivin kryesor të politikave makroprudenciale dhe janë thelbësore për ruajtjen e stabilitetit financiar. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë si autoritet makroprudencial, angazhohet për identifikimin e këtyre rreziqeve, vlerësimin e intensitetit të tyre dhe analizimin e mënyrave të mundshme të përhapjes. Në këtë kuadër, Harta Makroprudenciale e Rreziqeve Sistemike, analizat mujore të treguesve të shëndetit financiar dhe vlerësimet tremujore të qëndrueshmërisë së sektorit bankar, së bashku me ushtrimet e provave të rezistencës, shërbejnë si bazë për diskutimet dhe vendimmarrjen në fushën makroprudenciale. Përveç ndihmës në hartimin e politikave efektive, materialet e publikuara si, Raporti i Stabilitetit Financiar dhe analizat e vrojtimeve, forcojnë transparencën e Bankës së Shqipërisë ndaj publikut dhe sistemit financiar, duke kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit mbi rreziqet dhe në forcimin e besimit të publikut në sektorin financiar.

Harta e nxehtësisë së rreziqeve sistemike ofron një analizë të detajuar të një sërë treguesish të ndarë sipas objektivave të ndërmjetëm të politikës makroprudenciale. Sipas të dhënave të analizuara deri në fund të periudhës, treguesit që i kanë tejkaluar ose iu janë afruar niveleve kritike të përcaktuara si mesatare historike ose në bazë të gjykimit ekspert, lidhen me objektivin e parë, të dytë dhe të tretë të ndërmjetëm të politikës makroprudenciale. Përkatësisht, treguesit që përfshihen në analizën e objektivit të parë sinjalizojnë rritje të shpejtë të indeksit të çmimit të banesave dhe pritje për rritje të mëtejshme të tyre, si edhe rritje të kredisë së bizneseve për pasuri të paluajtshme.


Disa tregues që monitorohen në kuadër të objektivit të dytë tregojnë hendek të lartë midis aktiveve të pasiveve për maturitetet afatshkurtra, rënie në volumin e këmbimeve ndërbankare ndaj pasiveve në valutë dhe rritje të luhatshmërisë në interesin ditor dhe javor ndërbankar. Gjithashtu, vërehet një rritje përtej mesatares historike e treguesit që mat pozicionin e hapur neto ndaj kapitalit rregullator ose ekspozimin e përgjithshëm të bankës ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, pavarësisht se treguesi mbetet brenda kufijve rregullatorë të lejueshëm sipas rregullores 48/2010 të Bankës së Shqipërisë "Për administrimin e rrezikut nga pozicionet e hapura valutore". Disa tregues që pasqyrojnë shkallën e përqendrimit të ekspozimeve, të cilët monitorohen brenda objektivit të tretë, shfaqin vlera të larta dhe në rritje për përqendrimin e kredisë për prona të paluajtshme ndaj totalit të kredisë, si edhe në kredinë e pambrojtur nga ndryshimet e kursit të këmbimit. Një pjesë e mirë e këtyre ekspozimeve dhe treguesve, janë subjekt i kontrolleve dhe kufijve

rregullatorë të Bankës së Shqipërisë dhe si të tillë, përgjithësisht paraqesin vlera nën kufijtë e lejuar nga rregulloret përkatëse. Megjithatë, politika makroprudenciale mbetet e fokusuar në parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve, duke synuar gjithashtu kufizimin e përhapjes së tyre nga një segment në tjetrin brenda sistemit financiar.

Grafik 89. Raporti i kredive në valutë të pambrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit ndaj totalit të kredive në valutë, për sektorin bankar



Grafik 90. Raporti i depozitave mbi një vit në Lek ndaj totalit të depozitave në Lek, për sistemin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Treguesit e lidhur me rrezikun e përqendrimit valutor dhe me ecurinë e agregatëve valutorë në përgjithësi, së bashku me analizën e efektit të masave të deritanishme, monitorohen dhe raportohen rregullisht edhe si pjesë e analizës gjashtëmujore në "Raportin mbi ecurinë e treguesve që monitoron Banka e Shqipërisë, në kuadër të procesit të uljes së euroizimit"⁴³. Raporti i publikuar gjatë tremujorit të parë të vitit 2025 thekson se gjatë periudhave të fundit është regjistruar një rënie e vlerës dhe e peshës relative të kredive të ekspozuara ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Kjo tendencë ndikon në zbutjen e ndikimit negativ të lëvizjeve të pafavorshme të kursit në rrezikun e kredisë. Në të njëjtën kohë vërehet rënie e peshës së aktiveve likuide në valutë ndaj detyrimeve afatshkurtra në valutë, çka mund të ndikojë në rritjen e rrezikut të likuiditetit nga veprimtaria valutore, rritje e peshës së depozitave në Lek mbi një vit ndaj totalit të depozitave në Lek, që tregon ulje të masës së euroizimit të depozitave afatgjata, dhe rritje të qëndrueshmërisë së bazës së financimit të bankave në monedhën vendase. Dy nga objektivat kryesorë që lidhen me mbinxehjen e kredisë në raport me rritjen ekonomike dhe me rreziqet e lidhura me institucionet me rëndësi sistemike, adresohen në mënyrë të rregullt nga ana e Bankës së Shqipërisë, nëpërmjet vlerësimit dhe shpalljes së shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC) dhe shtesës së kapitalit për bankat me rëndësi sistemike (SIST).

Tabelë 6. Treguesit e hartës makroprudenciale të rreziqeve sistemike që sinjalizojnë rrezik më të lartë ose të shtuar, sipas objektivave të ndërmjetëm të politikës makroprudenciale

Objektivi i ndërmjetëm i politikës makroprudenciale	Tregues që sinjalizojnë rrezik më të lartë/të shtuar
Objektivi 1: Zbutja dhe parandalimi i rritjes së tepruar të kreditimit dhe raporti i levës financiare	Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimit të banesave
	Balanca neto e pritjeve për çmimet e banesave

⁴³ Ky raport publikohet në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit mes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, "Për zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin financiar dhe në ekonominë shqiptare", nënshkruar më 18.4.2017 dhe publikuar këtu: https://www.bankofalbania.org/web/pub/memorandumi_gksf_9384_1.pdf


	Ndryshimi vjetor i kredisë për bizneset për pasuri të paluajtshme komerciale
Objektivi 2: Zbutja dhe parandalimi i mospërputhjes së tepruar në maturitet dhe mungesës së likuiditetit në treg	Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve në Lek
	Pozicioni i hapur ndaj kapitalit rregullator
	Hendeku kumulativ deri në 7 ditë
	Volumi i këmbimeve ndërbankare ndaj pasiveve në valutë
	Luhatshmëria e interesit ditor dhe javor ndërbankar
Objektivi 3: Kufizimi i përqendrimeve të ekspozimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë	Kredia për prona të paluajtshme ndaj totalit
	Detyrimet e sektorit bankar ndaj SHKK-ve dhe IFJB-ve si përqindje e kapitalit rregullator
	HHI për kredinë e pambrojtur sipas monedhave (EUR, USD)

Burimi: Banka e Shqipërisë.


Gjatë periudhës, Banka e Shqipërisë ka vijuar të zbatojë kërkesat e parashikuara në rregulloren “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit”⁴⁴ (Rregullorja 41/2019), dhe të ndjekë raportimet tremujore të bankave mbi masën e përmbushjes së këtyre kërkesave. Gjatë vitit 2024, të gjitha bankat vendase ishin subjekt i plotësimit të kërkesës për shtesën konservuese të kapitalit (KONS) në nivelin maksimal të saj prej 2.5%, dhe bankat sistemike ishin subjekt i plotësimit të shtesës së kapitalit për bankat me rëndësi sistemike (SIST) që shpallet një herë në vit, në fund të muajit mars dhe që varion midis nivelit 0.5% dhe 1.5%. Në fund të qershorit 2024, Banka e Shqipërisë shpalli për herë të parë një normë pozitive prej 0.25% për shtesën kundërciklike të kapitalit për Shqipërinë (KUNC), dhe në fund të dhjetorit kjo normë u rrit përsëri me 25 pikë bazë në nivelin 0.5%. Vendimmarrja për këtë shtesë mbi kapitalin, e cila përdoret për të zbutur ose ngadalësuar rritjen e tepërt të kredisë dhe për të rritur rezistencën e bankave gjatë periudhave të mbinxehjes së tregut të kredisë, u mbështet në tregues të posaçëm, si ai i Hendekut të Raportit të Kredisë ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) që konsiderohet si tregues parësor, dhe Treguesi i Paralajmërimit të Hershëm Plotësues (TPHP). Edhe pse treguesi parësor mbeti nën nivelet që do kërkojë një normë pozitive të KUNC-së për të frenuar mbinxehjen e kredisë, ecuria e TPHP-së sugjeron rritje të shpejtë të kreditimit në segmente të veçanta (në kredinë për pasuri të paluajtshme) dhe rritje të dukshme të treguesve të lidhur me çmimet dhe qiratë në tregun e pasurive të paluajtshme. Zbatimi i shtesës kundërciklike të kapitalit synon të zbusë ciklin financiar, duke parandaluar përhapjen e pakontrolluar të rreziqeve sistemike që shoqërojnë rritjen e shpejtë të kredisë, dhe duke krijuar kushte për rritjen e kapacitetit kreditues të bankave gjatë fazave rënëse të ciklit financiar. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka punuar për të konceptuar disa masa për të kontrolluar ekspozimin e sektorit bankar ndaj tregut të pasurive të paluajtshme rezidenciale dhe për të ruajtur aftësinë paguese të kredimarrësve për blerjen e pasurive të paluajtshme.

⁴⁴ Shtesat që zbatohen aktualisht janë shtesa konservuese e kapitalit (KONS), shtesa kundërciklike e kapitalit (KUNC) dhe shtesa e kapitalit për bankat me rëndësi sistemike (SIST). Për më shumë informacion mund të drejtoheni në adresën: https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Politika_makroprudenciale/Instrumentet_e_politikës_makroprudenciale/Instrumentet_dhe_Vendimet/

Grafik 91. Hendeku i raportit kredi për ekonominë / PBB



Grafik 92. Ecuria e treguesit të paralajmërimit të hershëm plotësues



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në kuadër të zbatimit të politikës makroprudenciale, Banka e Shqipërisë vijon punën për të përsosur teknikat në drejtim të identifikimit të rreziqeve sistemike dhe konceptimit të instrumenteve të nevojshme makroprudenciale për parandalimin dhe zbutjen e tyre.

Aneks: Treguesit e shëndetit financiar

në përqindje	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	06/2024
Treguesit me bazë kapitalin																		
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të peshuara me rrezik	17.1	17.2	16.2	15.4	15.6	16.2	18.0	16.8	15.7	16.0	17.0	18.7	18.5	18.7	18.5	18.8	19.9	19.3
Kapitali nivelit të parë ndaj aktiveve të peshuara me rrezik	16.0	16.3	15.3	14.5	14.3	14.6	14.9	13.8	13.5	14.1	15.5	17.4	17.3	17.6	17.4	17.5	18.2	17.7
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve	7.6	8.6	9.6	9.4	8.7	8.6	8.4	8.6	9.5	9.7	10.2	10.1	10.5	10.4	9.9	9.8	9.9	10.3
Cilësia e aktiveve																		
Huate me probleme neto ndaj kapitalit rregullator	10.1	21.7	28.2	35.9	52.0	55.6	40.2	38.3	24.3	23.1	15.7	15.5	13.6	11.3	7.1	7.3	5.5	6.3
Huate me probleme (bruto) ndaj huave totale	3.4	6.6	10.5	14.0	18.8	22.5	23.5	22.8	18.2	18.3	13.2	11.1	8.4	8.1	5.6	5.0	4.7	4.7
Përfitueshmëria																		
Kthimi nga kapitali (ROE) (bazë vjetore)	20.7	11.4	4.6	7.6	0.8	3.8	6.4	10.5	13.2	7.2	15.7	13.0	13.5	10.7	12.9	12.3	17.3	18.5
Kthimi nga aktivet (ROA) (bazë vjetore)	1.6	0.9	0.4	0.7	0.1	0.3	0.5	0.9	1.2	0.7	1.5	1.3	1.4	1.1	1.3	1.2	1.7	1.9
Pozicioni i hapur neto në valute të huaj ndaj kapitalit																		
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit rregullator	1.7	4.3	3.9	5.0	3.9	4.0	4.1	8.5	7.7	7.0	6.7	7.8	7.4	8.4	9.2	5.0	6.1	4.6
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit të nivelit të	1.8	4.5	4.1	5.3	4.3	4.4	4.9	10.4	9.0	8.0	7.3	8.4	8.0	9.0	9.8	5.4	6.7	5.0
Treguesit me bazë aktivet																		
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve	49.8	42.8	27.6	25.9	26.5	29.4	27.6	31.9	32.3	31.3	30.2	34.2	35.7	34.8	33.3	29.6	30.8	28.4
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit)	74.0	64.9	32.6	30.6	33.1	36.7	34.7	40.4	41.4	40.6	40.8	46.2	49.4	47.4	45.4	41.1	43.4	41.2
Depozita të klienteve ndaj totalit të huave	215.5	162.6	154.3	166.4	163.2	171.6	180.8	180.2	187.8	192.8	194.0	203.2	207.2	211.3	213.6	212.4	217.1	203.5